Adem (Fejzallari) Avdia

FEJZALLARËT

Në vështrimin tim

ADEM AVDIA

"FEJZALLARËT" NË VËSHTRIMIN TIM

Kukës, 2018

Titulli i librit:

"Fejzallarët" në vështrimin tim"

Autor: ***Adem Avdia***
Punoi në kompjuter: ***Adem Avdia***
Redaktoi: ***Besiana Dunga (Avdia)***
Ballina: ***Besnik Hallaçi***

Fotografitë: ***Albumi familjar Shkëlzen Avdia***
Albumi familjar Yllka Spahiu
Albumi familjar Spartak Fejzallari
Albumi familjar Afrim Fejzallari
Albumi familjar Mond Fejzallari

Gjithë të drejtat i takojnë autorit

Formati : 160 x 230mm.
Tirazhi: 100 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Shtypur në shtypshkronjën"

Këto shënime ua dedikoj :

Të gjithë të parëve tanë, të gjithë atyre që na lanë këtë pasuri morale e shpirtërore, gjithë këtë nder e dinjitet e gjithë këtë krenari. Në sajë të tyre ne jemi këta që jemi. Në sajë të tyre ne na hapet rruga. Në sajë të tyre ne kemi ecur e çarë përpara. Ata i kemi pasur dhe do t'i kemi kurdoherë busull.

DY FJALË PËR FSHATIN E "FEJZALLARËVE" ***BICAJ***

Tiparet natyrore të Njësisë Administrative Bicaj



Harta e Njësisë Administrative Bicaj – punuar nga Dr.Blerta Avdia

Njësia Administrative Bicaj bën pjesë në Krahinën Malore Qendrore, në kontaktin e përplasjes së zonave tektonike të Mirditës e Alpeve dhe mes thyerjeve tektonike të Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Mbizotëron relievi kodrinorë - malorë, të përfshira nga lëvizjet diferencuese. Bën pjesë në zonën mesdhetare malore, të lartësive të maleve dhe është pjesë e pellgut ujëmbledhës Drini i Zi; shtrihet në brezin e tokave të kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore; në katin e dushqeve, ahut e halorëve dhe kullotave alpine.

Ky pozicion gjeografik i Njësisë Administrative Bicaj ka përcaktuar shumë veçori natyrore të saj, ndër të cilat theksojmë gërshetimin e tipareve mesdhetare me ndikim kontinental në të gjithë komponentët e peizazhit gjeografik. Ky gërshetim ka theksuar larminë e ekosistemeve në drejtim horizontal, por sidomos në drejtim vertikal, duke e bërë natyrën e saj interesante dhe me ofertë shumë më të pasur për zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik e turistik.

Ndërtimi gjeologjik i Njësisë Administrative Bicaj përfaqësohet nga shkëmbinjtë konglemerate, ranor, zhavorr, argjile, gëlqerorë, dolomitë etj. Ndërtimi gjeologjik kushtëzon shumëllojshmëri të peizazheve dhe formave të relievit, ofron pasuri natyrore me rëndësi ekonomike, ndikon në zhvillimin social ekonomik, ofron lëndë të parë për ndërtimin (rëra e bardhë) e mundësi për zhvillimin e turizmit.

Relievi është malor - kodrinor dhe dallohet për karakterin tepër kompleks. Majat e thepisura, të ndara nga lugina që formojnë gryka, që marrin format e kanioneve. Njësit përbërëse të relievit të Njësisë Administrative Bicaj janë: Kanioni i Bicajve, Gjallicë - Kolesjan, Gropa e Kukësit e tarracat lumore të Drinit të Zi.[1]

Gjallica - shtrihet më në jugperëndim dhe ngrihet menjëherë deri në lartësi 2489 m. Kreshta bie thikë mbi Grykën e Vanave në verilindje dhe mbi Kanionin e Bicajve në jugperëndim. Shpati veriperëndimor përbën një rrëpirë tektonike madhështore që bie në pellgun e Kukësit me një lartësi relative 2000 m, kurse shpati juglindor bie butë mbi depresionet e kontaktit të Topojanit dhe Tërshenës dhe lidhet gradualisht me pllajën e Shishtavecit.

Kolesjani - shtrihet në jug të Gjallicës dhe ndahet prej tij nëpërmjet kanionit të Bicajve. Pjesa kulmore është shumë e butë, shpatet janë të mprehta sa krijon rrëpira tektonike në gëlqerorë.

Lugina e Drinit të Zi. Kjo luginë fillon e ngushtohet duke marrë formën e një kanioni. Dallohet Skavica me thellësi mbi 200 m e gjerësi 6-8 m dhe e

[1] Akademia e Shkencave, *Gjeografi Fizike e Shqipërisë.* vëllimi i parë, Tiranë, 1990 f. 111-114.

formuar në gëlqerorët e mesozoi që dalin nën molasat pliocenike. Që nga përroi i Domajve lugina ngushtohet duke formuar grykën interesante të Gabricës.

Njësia administrative Bicaj dallohet për kontrastin hipsometrik të madh, me amplitudë hipsometrike prej 2138 m, nga 351 m (pellgu i Kukësit) deri në 2489 metra (Mali i Gjallicës). Kjo amplitudë ka ndikuar në ndryshimin e dukshëm vertikal dhe horizontal të faktorëve të modelimit të relievit, klimës, dukurive ambientale, që në tërësi bëjnë më komplekse dhe interesante format e relievit duke e shndërruar këtë të fundit në një potencial turistik të rëndësishëm.

Klima. Njësia Administrative Bicaj ka klimë mesdhetare malore me ndikim kontinental. Zonë mjaft e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve social - ekonomike e turistike.

Temperatura mesatare vjetore është 11.8^{0}C, ndërsa amplituda mesatare vjetore e krahinës lëviz nga 21.5^{0}C.[2]

Tab.1. Vlerat e temperaturave të matura në stacionin e Kukësit

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Vlerat e Temperaturave (Kukës)	1	3	6	11	16	20	22	22	18	12	8	2.8

Burimi: Akademia e Shkencave, *Gjeografi Fizike e Shqipërisë*. vëllimi i parë,Tiranë,1990



Njohja e vlerave ekstreme të temperaturës ka rëndësi për të gjitha aktivitetet ekonomike të njeriut si: në bujqësi, industri, e në zhvillimin e turizmit, sidomos atij malor, për të parandaluar katastrofat natyrore (ortekët).

[2] Akademia e Shkencave, *Gjeografi Fizike e Shqipërisë*. vëllimi i parë,Tiranë,1990

Figura nr .1. Grafiku i Temperaturave

Reshjet : Sasia shumëvjeçare e reshjeve lëviz nga 946 mm në Kukës në zonat më të ulëta, deri 1370 mm në zonat më të larta. Reshjet janë të përqendruar në stinën e dimrit, vjeshtës dhe pranverës. Reshjet e borës fillojnë në tetor - prill, ndërsa trashësia e borës shkon nga 80 - 100 cm, kurse në zonat me lartësi mbi1000 m mbi nivelin e detit trashësia e borës shkon 1.5 - 2 m. Në zonat e ulëta regjistrohen mesatarisht 60 ditë me borë, ndërsa në zonat e larta 120 ditë brenda një viti.

Tab. 2. Vlerat e reshjeve të shpërndara sipas muajve për stacionin e Kukësit

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Sasia e reshjeve (Kukës)	91.9	81.1	77.7	78.9	77.1	48	49	46.3	78.8	95	118	109

Burimi: Akademia e Shkencave, *Gjeografi Fizike e Shqipërisë*. vëllimi i parë,Tiranë,1990



Figura nr .2. Grafiku i reshjeve

Hidrografia. Rezervat ujore janë të mëdha. Ato përfaqësohen nga ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat janë të shumtë. Ujërat që lagin territorin e kësaj Njësie Administrative janë liqeni i Fierzës (Lumi Drin i Zi), Përroi i Shejës, Gurra e Kolesjanit dhe Rropniqja. Nga Gurra e Kolesjanit është bërë furnizimi me ujë të pijshëm i ujësjellësit të qytetit Kukësit, i cili furnizon Bashkinë Kukës dhe fshatrat Bicaj dhe Shtiqën (rreth 40 mijë banorë). Përroi i Rrepniqës (që del poshtë fshatit Bushat dhe derdhet në liqenin e Fierzës) është një pasuri kolosale e rezervave ujore të ujit të pijshëm, e cila deri tani nuk është shfrytëzuar për mungesë

projektesh dhe fondesh. Burimet zënë një vend të rëndësishëm. Burimet kryesore janë: Kroi i Bardhë, Kinzës,Tanzotave, Kishëz, etj.

Tokat. Në njësinë administrative Bicaj shtrihen *tokat* të formuara mbi depozitime lumore në zonën e vërshimit të lumenjve në afërsi të shtratit të lumit etj. *Toka* ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e bujqësisë, përcakton llojshmërinë e produkteve bujqësore dhe qëndrueshmëria e saj ndikon në mënyrën e ndërtimeve të ndërtesave për aktivitete të ndryshme.

Flora *përfaqësohet nga*: brezi i shkurreve, brezi i dushkut, brezi i ahut dhe halorëve dhe brezi i kullotave Alpine. Larmishmëria e florës ndikon në zhvillimin ekonomik të Njësisë Administrative, pasi një pjesë e tyre ka dhe vlera ekonomike siç janë: drurët frutorë, bimët mjekësore etj.

Fauna. Këtu gjenden llojet të ndryshme të gjallesave. *Nga gjitarët* dallojmë: ujkun, dhelprën, rrëqebullin, macen e egër, kunadhen, zardafin, vjedullën, qelbësin, derrin e egër. Ndër shpendët grabitqarë shumë të përhapur janë sorrat, laraskat, harabeli, gala, të cilat bëjnë dëme të mëdha në kulturat bujqësore. Kanë përhapje të gjerë kukuvajka, bufi dhe huti. Në shkëmbinjtë e lartë janë të përhapur. shqiponja, skifteri, laroshi e fajkoi. Fauna e ujërave - bën pjesë lundërza ose vidra, që gjenden në ujërat dhe lumenjtë e Drinit të Zi e lumit të Lumës.

Bimësia mund të përdoret si lëndë e parë në ekonominë e prodhimit dhe përpunimit të drurit, në ndërtim, dhe njëkohësisht bimët mjekësore mund të përdoren si lëndë e parë për prodhime farmaceutike e aromatike. Fauna dhe flora janë dy elementë të cilët kohët e fundit kanë marrë një rëndësi të veçantë për shkak se nga veprimtaria e pakontrolluar e njeriut sot gjenden të rrezikuara. Në kushte të tilla flora dhe fauna kanë marrë statusin e mbrotjes. Ato paraqesin rëndësi shkencore, ekologjike, didaktike e turistike.

Fshati Bicaj dhe roli i tij në rrjedhën e historisë.

Fshati Bicaj, si pjesë e krahinës së Lumës, në rrjedhën e historisë, përfshihej në këto njësi politiko-administrative:

- në antikitet krahina e Lumës përfshihej në Mbretërinë e Dardanëve.
- në mesjetë, përfshihej në principatën e Balshajve (shek. XIV).
- gjatë gjithë pushtimit osman, krahina Lumë ishte pjesë e rëndësishme e Sanxhakut të Prizrenit,
- nga fillimi i funksionimit normal të shtetit shqiptar nga vitet 1920 e në vazhdim krahina Lumë ka qenë pjesë e prefekturës së Kukësit.
- Para çlirimit ka qenë qendër Nën/Prefekture, Rrethi, Lokaliteti dhe më vonë Kooperativë e Bashkuar dhe Komunë. Sot Njësi Administrative.

Me emrin e Njësisë Administrative Bicaj lidhen shumë ngjarje historike, patriotike e kulturore të Bashkisë Kukës si:

- Komiteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Lumën, nga më aktivët, e ka pasur qendrën në Bicaj.
- Në vitin 1884 është lidhur me linjë telefonike me Prizrenin, për shkak të të cilës është zhvilluar dhe “Lufta e Telit”.
- Në Bicaj zhvillohej dhe “Mbledhja e Dheut” me krerët e krahinës së Lumës e më gjerë.
- Në vitin 1903 këtu është hartuar dokumenti i njohur i ‘’Masbates së Lumës”, me anë të cilës kjo krahinë nuk njihte asnjë autoritet përveç përfaqësuesve të saj.
- Në vitin 1911 në fshatin Kolesjan u hap shkolla e parë shqipe, e para për gjithë rrethin dhe Qarkun e Kukësit.
- Ne vitin 1912 në këtë territor është bërë lufta dhe qëndresa më e madhe e popullit shqiptar ndaj pushtuesve Serb, luftë e cila pati mijëra të vrarë e të humbur.
- Në vitin 1914 në fshatin Bicaj u hap shkolla shqipe, pas asaj të Kolesjanit.

- Ne vitin 1943 po në Bicaj u krijua çeta e parë partizane e Lumës.
- Ne vitin 1944 në Bicaj u krijua Brigada 24 sulmuese me 556 partizanë. Vetëm nga fshati Bicaj janë inkuadruar në formacionet partizane 136 banorë, e konkretisht në Br24S – 91, në Br5S – 13, në Br18S – 14, në Br27S – 3. Nga këta 15 luftëtarë dhanë jetën duke u bërë dëshmorë të Atdheut.
- Ne vitin 1956 u krijua Kooperativa e parë bujqësore në fshatin Nangë.

Territori i Njësisë Administrative Bicaj në vetvete përfaqëson dhe një *rajon etno-kulturor*. Në këtë rajon evidentohen shprehja e ndjenjave njerëzore dhe përcaktimin i identitetit lokal përmes: *gjuhës së banorëve, trashëgimisë historike, folklorit, mendësisë shoqërore, mënyrës së jetesës e të drejtës së pashkruar kanunore.*

Ajo ka në përdorim një nga gjuhët më të vjetra dhe më specifiket e gjuhëve të trungut indoevropian. Nga pikëpamja gjuhësore e gjithë kjo hapësirë gjeografike bën pjesë në nëndialektin e Gegërishtes verilindore, duke u dalluar qartë nga të folmet e gegërishtes (shkodranishtja).

Identiteti apo ndërgjegjja krahinore dhe rajonale e kultivuar mes shekujsh prezantohet qartë nga trashëgimia.

Nga pikëpamja etnografike përfaqëson një larmishmëri të kulturës popullore, e cila shfaqet: *në mënyrën e organizmit të jetës, në doke e zakone. Pra trashëgimia kulturore*, të paktën ajo *gojore*, është pjesa më e qëndrueshme e paraqitjes së rrjedhave historike.

E drejta e pashkruar. Për krahinën Lumë ka mbizotëruar Kanuni i Lekë Dukagjinit. Popullsia e krahinës karakterizohet me rregullimin e jetës sociale-ekonomike përmes Kanunit dhe vetëm në vitet 1945 filloi të zbatohet ligji me përpikmëri, pavarësisht se edhe më përpara ekzistonte. Ka qenë përherë zakoni i martesave në djep, por nuk ishte divorci, pavarësisht martesave të vështira që kanë realizuar.

E drejta e pronës jo vetëm që ka qenë e zbatuar duke u bazuar në kanun, por pavarësisht ekzistencës së ligjeve dhe vendosjes së institucioneve ligjore, në heshtje akoma vazhdon të zbatohet.

Gjurmët e para të popullimit të fshatit Bicaj i gjejmë të dokumentuar që në mesjetë me vendbanimin "Shalë" më pas në vitin 1571[3], si pjesë e krahinës së Lumës në rregjistrat kadastral të Perandorisë Osmane, sipas rrëfimeve të udhëtarëve që kanë vizituar krahinën si: Ivan Jastrebov, Kurt Hasert, Edith Durham etj.

I.Jastrebov në shek XIX evidentoi se Bajraku i Rrafshës (Bicaj) kishte 800 shtëpi.[4]

Të dhënat e mëvonëshme vijnë nga bisedat me më të moshuarit, të cilët tregojnë se fshati Bicaj përbëhej nga 120 shtëpi e kjo mbahet nga rendi i ujit për vaditje sipas fiseve:

- 60 Shtëpi HASA

Fisi HASA përbëhet nga : Bogdanët, Kërxhalijtë, Bilalët, Fejzallarët, Nuhiallarët, Sinamatët dhe Hoxhallarët

- 60 Shtëpi MEHMETI

Fisi MEHMETAJ përbëhet nga :Halilët, Brahajt, Sokolët, Gjanajt dhe Mehmetët

Bazuar në regjistrimin e popullsisë nga Zyra e Gjendjes Civile Bicaj në vitin 2012 popullsia ka qenë si më poshtë:

- Bushat 661 banorë
- Osmanaj 659 -"-
- Bicaj 1357 -"-
- Mhole 161 -"-
- Mustafaj 488 -"-
- Kolesian 908 -"-
- Nangë 1557 -"-
- Domaj 69 -"-
- Gabricë 324 -"-
- Tërshenë 347 -"-

Njësia Administrative BICAJ gjithsej **6531** banorë.

Me një densësi 66.48 b/km^2, krahasuar kjo me vitin 2001 vihet re që kemi një rënie të numrit të popullsisë me 1391 banorë. Kjo rënie popullsisë

[3] Robert Elsie "Fiset Shqiptare" Artini, Prishtinë 2017, fq. 413

[4] Robert Elsie "Fiset Shqiptare" Artini, Prishtinë 2017, fq. 415

është e lidhur ngushtë më nivelin e lartë të varfërisë që ka rajoni ku bën pjesë Njësia Administrative. Ky nivel varfërie është rreth 21.9%[5]. Rreth 53% e popullsisë trajtohen me ndihmë ekonomike, tregues i nivelit të ulët të jetesës. Mungesa e investimeve ka bërë që popullsia të jetë e detyruar të largohet në kërkim të një jete më të mirë.

Numri i popullsisë është ruajtur në nivele të tilla në saj të shtesës natyrore perj 1.5 %[6] dhe jo të lëvizjes mekanike. Kjo vërehet te numri i lartë i lindjeve, rreth 165 lindje në vit dhe nga ana tjetër niveli i vdekshmërisë zero[7]. Ulja e numrit të lindjeve ka ardhur si rezultat i largimit të popullsisë. Megjithatë duhet të theksojmë së në njësisë administrative pavarësisht largimeve mbizotëron moshe e re e aftë për punë rreth 64%, një tregues i mirë për zhvillimin e komunitetit.

Njësia Administrative Bicaj, pavarësisht faktit që është një ndër njësitë më të mëdha të Bashkisë Kukës, nuk i plotëson dot nevojat e popullsisë së saj për një jetesë normale. Kjo ka ardhur jo për shkak të mungesës së potencialeve natyrore, por mungesës së menaxhimit e të shfrytëzimit të burimeve natyrore si dhe investimeve të ulta. Kjo ka detyruar popullsinë drejt lëvizjeve migrative. Në Bicaj janë të pranishme emigracioni në drejtim të shteteve si Angli, Itali, Greqi, Gjermani dhe imigrimi në drejtim të qendrave kryesore të vendit, të cilat ofrojnë mundësi më të mira jetese, si: Tirana, Durrësi, Fieri etj. Tashmë emigracioni është shndërruar në një instrument kyç për nxjerrjen nga varfëria të popullsinë së krahinës në këto 25 vitet e fundit.

Tabela. 2.2. Struktura moshore e Njësisë Administrative Bicaj

Struktura moshore	Viti 2001	%	Viti 2011	%
0-14 vjeç	2502	35.6	1595	28
15-64 vjeç	4108	58.5	3613	64
65^+	412	5	423	7

Burimi: INSTAT "censusi 2001 & 2011"

[5] Këshilli i qarkut Kukës "Strategji e zhvillimit të qarkut Kukës 2012-2016" Kukës, 2012 fq. 20

[6] RASP, Komuna Bicaj, QIZHDK "Plani i zhvillimit i komunës Bicaj" Tetor, 2012 fq.25

[7] RASP, Komuna Bicaj, QIZHDK "Plani i zhvillimit i komunës Bicaj" Tetor, 2012 fq.25



Nga tabela vërejmë që mbizotëron grupmosha e re, rreth 64% e aftë për punë. Kjo grupmoshë tregon që perspektiva është e mirë, mjafton që të gjenden mënyrat efikase për shfrytëzimin e potencialit që zotëron ajo. Megjithatë duhet të theksojmë faktin që nga viti 2001 në 2011 kemi një rënie të popullsisë në moshë të re. Ky fakt është i lidhur ngushtë me rënien e numrit të lindjeve, pasi siç e dimë, para viteve 1990 ka mbizotëruar politika pronataliste, ndërsa në ditët e sotme janë aplikuar metodat të planifikimit familjar. Por krahasuar me vendet e tjera të rajonit krahina mbetet me lindje të larta. Vështirsitë e jetesës dhe emigracioni i cili përfshin pikërisht këtë moshë, ka ndikuar në uljen e numrit të tyre në krahinë.

Struktura e punësimit: Njësia Administrative Bicaj nuk përbën ndonjë dallim me Bashkinë Kukës, ku bën pjesë. Ajo karakterizohet nga një shkallë e lartë e papunësisë. Rreth 53% trajtohet me ndihmë ekonomike dhe vetëm një përqindje e vogël është e punësuar. Sektorët e punësimit të popullsisë së Njësisë janë: bujqësi, arsim, shëndetësi, ndërtim, transport, administratë shtetërore. Krahas të punësuarëve të përhershëm kemi dhe të punësuarit sezonal, kryesisht në bujqësi, ku numri i tyre shkon rreth 300 persona. Ndaj si mundësi punësimi popullsia e Njësisë Administrative ka gjetur migrimin si jashtë shtetit ashtu dhe lëvizjet migruese ditore për arsye punësimi në anën tjetër të kufirit (Kosovë). Më poshtë po pasqyrojmë numrin e të punësuarvë sipas sektorëve.

Tabela nr.2.5. Struktura e punësimit në njësinë administrative Bicaj sipas sektorëve

Sektorët	Bujqësi	Arsimi	Shëndetësor	Ndërtimi	Transport	Administrate
Nr i të punësuarëve	1013	100	24	36	47	55

Burimi: RASP, Komuna Bicaj, QIZHDK "Plani i zhvillimit i komunës Bicaj

Arsimi : Popullsia e Njësisë Administrative Bicaj është arsimdashëse. Gjurmë të kësaj është hapja e shkollës së parë shqipe më 11 tetor 1911. Aktualisht Komuna Bicaj ka 6 kopshte, 7 shkolla 9-të vjeçare dhe një shkollë të mesme të përgjithshme.



Nga tabela vërehet se kemi një rënie të numrit të nxënsëve që janë analfabet dhe njëherazi është rritur numri i nxënësve që vazhdojnë arsimin parashkollor dhe fillor. Vihet re fenomeni i braktisjes së shkollës, i cili evidentohet tek ulja e numrit të nxënëseve që ndjekin arsimin bazë. Arsimi i mesëm ruan të njëjtin numër nxënësish. Është rritur numri i nxënësve që vazhdojnë arsimin e lartë.

Shkolla e mesme Bicaj mbetet një ndër shkollat më të rëndësishme të rrethit. Ka filluar aktivitetin e vet në fillimet e saj si shkollë Bujqësore,

profil të cilin e ka mbajtur gjatë viteve 1972-1992[8]. Pas këtij viti kjo shkollë ka ndryshuar profilin e vet duke kaluar në shkollë të mesme të përgjithshme. Nga ana e zhvillimit të procesit arsimor, kjo shkolle ka fituar përvojën e vet dhe personeli mësimdhënës i saj përbëhet nga arsimtarë me përvojë dhe të kualifikuar. Gjate kohës nga kjo zonë kanë mbaruar shkollën e lartë mbi 600 intelektualë, një pjesë e të cilëve kanë dhënë dhe japin kontribut të çmuar në sektorë të rëndësishëm të vendit.

Në strukturen ekonomike të Njësisë Administrative Bicaj, që shtrihet në një sipërfaqe prej 5821 ha, mbizotëron blegtoria e bujqësia. 62 % të të ardhurave i siguron nga blegtoria dhe 38 % nga bujqësia[9]. Komuna Bicaj ka 1067 ha tokë bujqësore, nga kjo sipërfaqe vetëm 358 ha janë pronë private (familjet bujqësore), ndërsa 707 ha kanë mbetur tokë komunale. Nga toka komunale 273 ha janë tokë introproduktive, ndërsa 434 janë tokë bujqësore të pa ujitur[10].

Ndërtimi gjeologjik krijon mundësi që të zhvillohet industria nxjerrëse dhe përpunuese. Rëra e bardhë e pranishme në fshatrat Bicaj, Osmanaj, Mustafaj shërben si burim kryesor për sigurimin e lëndës së parë për industrinë e ndërtimit.
Industria tekstile - është një mundësi për krjimin e punësimit dhe ringjalljen e një tradite egzistuese.
Turizmi është një alternative e re për shfrytëzimin e potencialit natyror dhe human në funksion të krijimit dhe forcimit të identitetit krahinor, rajonal dhe kombëtar të popullsisë së Njësisë Administrative.

[8] RASP, Komuna Bicaj, QIZHDK "Plani i zhvillimit i komunës Bicaj" Teror, 2012 fq.17
[9] Po aty, fq. 22
[10] Po aty, fq. 22

Foto e lagjes **Canaj, Bicaj** - **Njësi Administrative** (marrë në google)

NË VËND TË HYRJES !

Në lagjen "Canaj" të katundit Bicaj është vendosur, ka jetuar e gjallëruar fisi Fejzallar. Nga vetë mbiemri duket se i pari ynë ka qenë Fejza, por nuk jemi të sigurtë se kur fillon ky mbiemër që trashëgojmë. Po ashtu nuk jemi të sigurte se me cilin fis jemi më të afërt dhe na bashkojnë lidhjet e gjakut.

Fisi ynë mbahet mend si i vogël numerikisht, e për këtë arsye jemi më të afruar më fisin Bilal. Me këtë fis jemi edhe kufitar me troje e me shtëpi dhe kemi pasur gjithmonë hyrje dalje dhe marrje dhënie për nevoja të momentit. Bilalët na janë gjendur gjithmonë. Në të mira e në fatkeqësi pranë familjes sonë në Bicaj mbaj mend se kanë qenë gjithmonë prezent Rehani, Brahimi, Fetahi, Enveri, Hyseni, Gafurri, Haziri, Shabani, Hasa e shumë të tjerë nga ky fis, së bashku me gratë e tyre, për shërbim e për

çdo problem të momentit. Ndaj tyre, pa përjashtim, ne jemi mirënjohës përjetë e mot.
Skemën e mëposhtme të gjenezës së fisit e kam të trashëguar nga babai Kamberi dhe ai nga xhaxhai i tij Zyber Bajrami. Unë i kam kërkuar të vazhdoj më tepër, kush ishte para Fejzës, por ai nuk pranoi. Pohonte pasigurinë dhe nuk shkruante asgjë për të cilën nuk ishte i bindur.
Fisi ynë nuk është dalluar ndonjëherë për pasuri. "Ne asnjëherë - tregonte baba Kamber - nuk kemi pasur shumë pasuri. Kemi plotësuar vetë nevojat tona". "Kur më vdiq baba – shënon diku – na ka lënë 15 dynym tokë mbi vadë e nën vadë, 20 krerë dele, 2 lopë, 1 ka, 1 gomar, për të cilat kujdesej axha Zyber dhe asnjë ngatërresë".
Nga fisi "Fejzallar" kanë pas dalë dhe ka ende sot gra e burra të mençur, të urtë, të ndershëm, punëtorë, trima dhe që rrinin e rrinë në hesap të vet. Nuk janë përzier në punë të të tjerëve, kanë administruar shtëpinë e tyre dhe kanë dhënë përgjigje kur janë pyetur për probleme të ndryshme të jetës e të katundit. Fejzallarët megjithëse thuhet se janë njerëz të qetë e nuk kanë qenë të bezdisur në fshat, kjo nuk do të thotë që kanë qenë indiferent në situatën politiko – ushtarake e ekonomike të krahinës e më gjerë. Që në reformat e Tanzimatit njihet lufta e përpjekja e Zyber Fejzës kundër masave e reprezaljeve të pushtuesit turk e reformave që priteshin të ndërmerreshin, kundërshtimi me luftë, deri sa dha edhe jetën së bashku me Zyber Temën. Më vonë Zyberi tjetër, pikërisht Zyber Bajrami, përqafoi me idetë e tij luftën për çlirimin e tokave arbërore nga pushtuesi turk dhe u inkuadrua me forcat e Islam Spahiut në Luftën e Kaçanikut, si këshilltar personal i tij. Ardhjen e pushtuesit italian e gjerman Fejzallarët nuk e pritën mirë, por me armë në dorë. Bajram Avdia, Rushit e Ibish Milaimi ishin tre Fejzallarë, që morën armët dhe ju bashkuan çetës së Lumës, batalionit partizan e Br24S. Ibishi ra dëshmor i rrethuar nga forcat kuislinge, por në vend të tij u rreshtua babai i tij Milaimi. Bajrami ndërpreu studimet në Normalen e Elbasanit dhe mori armët e doli partizan në male deri në çlirimin e plotë të vendit. Asllani me pushtimin e Shqipërisë nga fashistët italianë, hodhi poshtë armatimin dhe uniformën e xhandarmërisë dhe nuk pranoi të shërbente nën armë me pushtuesin, duke u bërë

familjarisht baza dhe mbështetja e lëvizjes çlirimtare në Lumë. Po ashtu dhe i vëllai Isufi, i cili nuk iu nda asnjëherë në aspiratën çlirimtare.
Edhe pas çlirimit e deri më sot Fejzallarët kanë punuar e milituar me sakrificë e devotshmëri në sektorët ku janë ngarkuar. Ata janë bërë shembull për korrektesën e devotshmërinë e tyre. Kanë qenë e vazhdojnë të jenë të ndershëm, të thjeshtë e komunikues në pozicionet e punës që kanë mbuluar e mbulojnë. Nuk di nga t'ia filloj, por përmendim disa si: Rushitin, Asllanin, Bajramin, Lenkën, Kamberin, Isufin, Rrahimin, Shpresën, Bashkimin, Yllkën, Fuatin, Florën, Luanin, Afrimin, Qefseren, Spartakun, Mirën, Shkëlqimin, Xhulin, Gencin, Benardin, Blertën, Armandin, Mondin, Ermalin e të gjithë Fejzallarët pa mbarim.
Në këto shënime do shkruajmë gjerësisht për të gjithë ata anëtarë të fisit "Fejzallar" që kanë spikatur dhe kanë bërë histori, janë përmendur jo vetëm në familje e në fis por me veprimtarinë e tyre kanë ndikuar edhe në jetën e fshatit, krahinës e më gjerë, kudo ku ata kanë lënë gjurmë e kanë zhvilluar aktivitetin e tyre.

Do të përmendim ndër të tjerë:

- **Zyber Fejzën**, luftëtarin e paharruar të krahinës së Lumës, qëndrestarin kundër reformave të Tanzimatit dhe kundërshtarin e mobilizimit të djemve lumjanë si nizamë, atë që u përjetësua në këngë për aktin sublim të luftës kundër pushtuesve turq, që me gjakun e tij ndezi flakën e qëndresës dhe të patriotizmit në krahinë.
- **Zyber Bajramin**, analfabetin me zgjuarsi natyrale, njeriun paqësor që gjithë jetën edhe pa qenë plak "ndante pleqni", atë që zinte miqësi me mësuesit dhe u jepte për zgjidhje probleme matematike, këshilltarin pa pushkë të Islam Spahisë në Luftën e Kaçanikut, njeriun që bënte një jetesë të lakmueshme edhe për kohën e sotme, "sakatin" që ecte vetëm në këmbë dhe që pati një vdekje patetike.
- **Nebi** e **Avdi Bajrami,** familjarët shembullorë e njerëzit e ndershëm të fisit. Me punën dhe jetën e tyre të thjeshtë edukuan, rritën dhe shkolluan që në atë kohë fëmijët, duke lënë prapa një

brez jo vetëm të aftë për jetën, por edhe kontribues për shoqërinë e kohës së tyre.

- **Asllan** e **Isuf Nebia**, ndër njerëzit më të respektuar në Bicaj, intelektualë dhe kontribues në punët administrative, nëpunës që në kohën e Mbretërisë dhe të arsimuar si nxënës të parë të shkollës shqipe në Bicaj. Asllanin si drejtues i organizatave shoqërore dhe këshillave të fshatit dhe Isufin si punëtor i pandalur deri sa dha jetën aksidentalisht në krye të detyrës.
- **Kamber Avdia,** ndër shpërndarësit e telegrafistët e parë të postës në Kukës dhe nëpunësi i Komunës Bicaj e Bashkisë Prizren para çlirimit, avokat i thjeshtë e modest e nëpunësi i administratave të shumta edhe pas çlirimit. Ai që gjithë jetën e tij si ngarkesë me peshë më të madhe kishte lëvizjen e makinës së shkrimit nga një tavolinë në tjetrën. Atij që na la aq shumë shënime sa në të kundërt nuk do guxoja të shkruaja dhe nuk do ta njihja fisin tim si e njoh sot.
- **Bajram Avdia,** nxënësin me zgjuarsi natyrale, që mbaroi filloren vetëm 10 vjeç e fitoj bursën në Normale të Elbasanit Atë që merrte vetëm "shkëlqyeshëm". Që doli partizan ndër të parët me Çetën e Lumës, Batalionin partizanë të Lumës e Br24S deri në çlirim të plotë. Atë që u arsimua në Leningrad për "Filozofi" e mori titullin shkencor "Profesor" në filozofi. Intelektualin që punoi me korrektesë e ndershmëri deri në frymën e fundit. Atë që fshatin e tij Bicaj e kishte idhull. Emrin e tij e mban sot Shkolla e Mesme e Përgjithshme e vendlindjes.
- **Milaim Rushiti,** babai që rriti dhe edukoi 3 djem trima e besnikë, më shumë pa nënë dhe në varfëri. Atij që djemtë i përqafuan nga të parët idealet komuniste dhe morën armët e dolën në mal për çlirimin e vendit. Atë që kur djali Ibish ra me armë në dorë në përpjekje me forcat kuislinge, mori armën dhe zuri radhët e Çetës së Lumës në vend të tij.
- **Ibish Milaimi,** djali që përqafoi i mitur lëvizjen çlirimtare, korrieri që luftoi në rrethim me kuislingët deri në pikën e fundit të gjakut duke qenë i bindur në fitoren e kauzës për të cilën kishte marrë

mitralozin e tij të shtrenjtë. Ai që ka qenë e mbetet krenaria e fisit Fejzallar.

- **Rushit dhe Rrahim Milaimi,** njerëz të respektuar dhe të nderuar në krahinën e Lumës. Rushiti ndër të parët që u rreshtua në Çetën e Lumës e formacionet partizane. Ata që asnjëherë nuk përfituan nga gjaku martir i vëllait, Ibishit. Nëpunës të ndershëm dhe korrekt në detyrat e ngarkuara. Rushiti si nëpunës i lartë i administratës shtetërore dhe Rrahimi si ushtarak i lartë i Forcave të Armatosura.
- **Fuat Fejzallari,** arsimdashës dhe edukator model i brezit të ri. I papërtuar dhe i palodhur në aktivitetin e misionin e ngarkuar. Ai që përmendet në gjithë brezat për korrektesë e kontribut të shkëlqyer në përgatitjen dhe pajisjen me dije të nxënësve, që i kaloi nëpër dorë. Familjar dhe shok shembullor.
- **Bashkim Avdia (Fejzallari),** intelektual i zoti, specialist i spikatur në fushën e tij si inxhinjer ndërtimi, i ndershëm e gjithmonë i palodhur në zbatimin e detyrave. "Shpirti fukarasë" dhe njeriu që përpiqej të ndihmonte atë që nuk kishte. Jeta e shkurtër nuk e la të shijonte familjen dhe shoqërinë, që i donte aq shumë.

Do mundohem t'i prek të gjithë nga pak, por këtu sigurisht që do të ketë edhe diferenca të theksuara në përshkrim, diçka që unë dhe askush tjetër nuk do e dëshironte. Dikush do theksohet më shumë e dikush më pak. Jo se dikush ka qenë apo vazhdon të jetë burrë më i mirë, por kjo do të vij nga mungesa e materialit bazë që do të përdoret për përshkrimin e jetës dhe aktivitetit të tyre.

"Njeriu është fajtor për të gjitha të mirat që nuk ka bërë". Unë këtë shkrim për fisin Fejzallar e quaj një të mirë e sinqerisht do të ndihesha fajtor nëse nuk do ta kisha bërë.

Materiali bazë ku do të mbështetem janë shënimet periodike të babës Kamber. Ai ka jetuar në vitet 1912 – 1990. Ka pasur një veprimtari të shtrirë në Lumë e Prizren. Ka kryer shumë detyra shtetërore duke mundësuar kontakte të shumta me shtresa të ndryshme të popullsisë, por më kryesorja ka mbajtur shënime të vazhdueshme dhe ka hedhur

përshtypje të momentit. Nuk mund të them se këto janë të përsosura, se janë jashtë ndikimeve personale dhe nuk kanë subjektivizëm, nuk i kanë shpëtuar vlerësimeve të momentit, por prapë ato kanë vlerën kur pasqyrohen në dritën e fakteve dhe të dokumenteve të tjera familjare.
Në një bllok shënimesh, me merakun që nuk po arrinte t'i sistemonte shkrimet e tij të shpërndara në blloqe e copa letrash, nisur nga mosha dhe gjendja shëndetësore shkruan : "Besoj se djali im Ademi do të mund t'i marrë dhe t'i sistemojë këto shënime duke u dhënë sadopak vlerë njohëse për pasardhësit tanë". Edhe ky shkrim i imi është pjesë e këtij amaneti.
Burim tjetër është dhe arkiva modeste e familjes së Bajram Avdiut nga ku janë marrë foto, dëftesa shkollore, tituj shkencor, dekorata dhe shënime të tija për aktivitetin politik dhe administrativ.
Kam qenë i interesuar dhe kam marrë shënime, kujtime e fotografi edhe nga të afërm të fisit tonë si Xhuli, Spartaku, Mondi, Afrimi, Shkëlqimi, Izet Duraku e Aqif Hoxha, të cilët në mënyrën e tyre janë përpjekur për të më ndihmuar që materiali të dalë sa më i plotë dhe të fitohet një përfytyrim e tablo e fisit "Fejzallar".

Shtëpia e "Fejzallarëve", Bicaj. foto - tetor 2017

Burim plotësues është vetë fshati ynë Bicaj. Megjithëse nuk kam jetuar aty, kur afrohem te Ura e Shejës dhe marr të përpjetën, më duket se futem në një botë timen, sikur fryma mban një ritëm relaksues. Kur shkeli në tokë më duket më e butë, bari më i lëmuar dhe pemët më të këndshme. E vetmja gjë për të cilën ndjej dhimbje janë "plagët" e hapura në shfrytëzimin e rërës së bardhë. Sa herë që kaloj dhe i shoh gropat e gërryera më duken si shpina e asaj maces që është sëmurë dhe i ka rënë lëkura vende – vende. Fitimi që shkatërron natyrën dhe prish biodiversitetin në atë mënyrë nuk duhet, është haram. E pakta që mund të bëjmë është të mos e ndryshojmë ambientin kur nuk e zbukurojmë, të paktën ta lëmë si e gjetëm nga të parët tanë.

Në Bicaj, kur shoh apo takoj njerëz, më vjen shumë mirë që jam bashkëfshatar i tyre dhe më duket vetja krenar që kam diçka të përbashkët me këta njerëz dinjitozë. Thonë se në Bicaj "nuk të lënë brenda", bicjanët "janë me lugë në brez", etj.

Unë e kam pyetur babain, Kamberin, mbi këto dhe më ka sqaruar se Bicaj ka qenë gjithmonë qendër administrative, zyra, magazina drithi, gjendja civile etj, e për këtë ka pasur shumë dyndje. Të gjithë ata që vinin, mbaronin apo s'mbaronin punë, u duhej ushqim (ndoshta e zgjidhnin pjesërisht vetë) e strehim, shtuar edhe kafshët e ngarkesës. Kurrë nuk ka mbetur njeri jashtë dhe kurrë nuk kemi pasur han për bujtje. Tregojnë se njëri nga zonat e lartësisë kishte shitur në Bicaj mecën (femrën e qenit). Sa herë që vinte në Bicaj për punët e veta, kthente nga ajo familje dhe interesohej për mecën. Me këtë rast futej brenda e pinte, hante e ndoshta edhe kalonte natën. Kjo u përsërit disa herë. Një ditë kur erdhi dhe pyeti për mecën, i zoti shtëpisë e ndolli mecën, mori pushkën dhe e vrau. Nga ajo ditë nuk e bezdisi më miku i pagrishur.

Atëherë ...kurse për "lugën në brez" tregojnë se në kuvend në Bicaj po ndaheshin festat, një mënyrë që të takoheshin njerëzit. Tërthorja mori "të Qethmet", Tejdrina "të Dunmet", Rrafshja "Gjallicën", Mali zi "Rrunat", etj. Në fund të takimit bicjani pyet: - Po unë kur e kam festën? – Ti nuk ke festë – i thanë – gjithmonë do të marrësh pjesë në festat tona dhe do të jesh në krye të vendit.

Bicjanët kanë qenë të zgjuar, arsimdashës dhe kulturshpërndarës. Je krenar dhe dinjitoz kur thua "jam nga Bicaj", sepse e di se do të nderohesh e respektohesh, pavarësisht ngacmimeve si "agallarë". Tregojnë se në një vaki një bicjanë ishte në dhomë dhe trajtohej në respekt e muhabet si të tjerët, por shpejt ai ra në sy për komunikim e zgjuarsi.

- Prej nga je? – e pyeti një nga të pranishmit në dhomë.
- Nga Bicajt – u përgjigj ai.
- Ngrihu e dil në rreth të oxhakut ku është kryet e vendit.
- Nuk është kryet e vendit ku ka ndërtu i zoti i shtëpisë oxhakun, por aty ku jam unë – përgjigjet bicjani.

Duke qenë në qendër të vëmendjes, aty ishte dhe përqendrimi i gjithë bisedës, e aty ishte ideja se ishte dhe "kryet e vendit".

Një rast i treguar për zgjuarsinë e njerëzve të thjeshtë: Një nga Shëmria kishte vrarë një në Sërriçe. Ata i kishin kërkuar besë dhe ai i kishin dhënë deri ditën e Bajramit. Ditën e Bajramit i shkon te shtëpia, hip mbi një pemë dhe posa del jashtë vrasësi, personi i familjes së dëmtuar e vret. Mblidhet familja e të vrarit dhe diskuton. A na preu në besë apo jo? Ne e kishim me besë deri ditën e Bajramit e ky na vrau ditën e Bajramit! – Mire – thotë njëri - në Bicaj po zhvillohet "Mbledhja e dheut". Unë mendoj të shkojmë e t'i pyesim e bëjmë si të thonë ata. Shkojnë në Bicaj. Në pushim të takimit, kërkojnë leje dhe paraqesin problemin. Akoma pa mbaruar mirë fjalën, një person aty nga fundi, pa shumë peshë në kuvend foli :
– Ka marrë gjakun e vet! Të tjerët heshtën e të ardhurit u larguan të sqaruar. Sa dolën ata jashtë Paria ju kthye : – Pse fole? Kush të autorizoi pa bërë kuvend. Bicjani edhe pse i papeshë por i mençur u tha: - Ata të keqen e kishin vetë në mend. Duke dëgjuar diskutimet dhe hezitimin tuaj kurrë nuk do ta largonin. Më mirë kështu dhe ndalojmë gjakun përgjithmonë në këtë familje. Pra, edhe pa peshë dhe i mençur – ky është bicjani.

Vetë titulli materialit “Fejzallarët në vështrimin tim” jep të kuptohet se ky është vetëm vështrimi e vlerësimi im për Fejzallarët, është një përshkrim personal për këta njerëz për të cilët kam dëgjuar, kam jetuar e vëllazëruar, kam ndarë të mirat e të këqijat, kam ngrënë “me një lugë”. Vështrimi im mund të çalojë në ndonjë aspekt apo rrethanë të përshkruar, por kjo mund të ndodh nga mungesa e përvojës në të shkruar apo materiali i marrë si referim, por pa ndonjë paragjykim. Unë i kam dhe do t’i kem përgjithmonë të gjithë njëlloj, të gjithë të afërm, të gjithë të dashur, të gjithë “Fejzallar”.

Mirënjohje të gjithë të parëve tanë, të gjithë atyre që na lanë këtë pasuri morale e shpirtërore, gjithë këtë nder e dinjitet e gjithë këtë krenari. Në sajë të tyre ne jemi këta që jemi. Në sajë të tyre ne na hapet rruga. Në sajë të tyre ne kemi ecur e çarë përpara. Ata i kemi pasur dhe do t’i kemi kurdoherë busull.



F I L L I M I

Kam menduar që shënimet për fisin "Fejzallar" t'i paraqes përmes individëve, duke filluar që nga mosha më e hershme, që mbahen mend e deri te prindërit tanë. Mendova që brezin që pason prindërit, si brezin tim, të mos e marr në përshkrim, pasi pjesa më e madhe jetojmë e duket sikur krenohemi për njëri tjetrin. Jemi "modest" të pandreqshëm. Jemi aq të mirë sa po shkruajtëm nuk mund të rrimë pa ia thënë njëri tjetrit të mirën në sy. Shkodrani thotë : "Kur do me ia thy qafën dikujt, rriti mendjen", e ne jemi mirë kështu, pa i "thyer qafën" njëri tjetrit. Besoj se fëmijët tanë do të jenë të aftë të shkruajnë për ne, ashtu si besojmë se edhe ne do të lëmë mbresa të mira ku ata do të bazohen për shkrimet e tyre.

Megjithëse të parët tanë do të përshkruhen individualisht, mbresat që ata do të sjellin para nesh do të jenë të gërshetuara dhe të lidhura me jetën e të gjithë anëtarëve të fisit me të cilët kanë jetuar dhe bashkëpunuar. Në jetën e secilit prej tyre hidhet dritë e merret informacion edhe për të tjerët e këtu del edhe lidhja e bashkëveprimi e koordinimi i gjithhershëm mes fisit tonë Fejzallar.
Duke qenë të paktë dhe të pazhvilluar numerikisht në vite kemi qëndruar gjithmonë të bashkuar. Nga vështrimi i "pemës" së zhvillimit të fisit vërehet shumë mirë se ne jemi tre barqe që rrjedhim nga Fejza: të Ibishit, të Zyberit dhe të Dinit. Nga barku i Dinit janë "shkrirë" që me ndarjen nga jeta të Sulltanes, nënës së Dullës, e cila vdiq në shtëpinë e Kamber Avdisë në Prizren më 3 gusht 1946. Nga të Ibishit gjallërojnë vetëm pasardhësit e Rushitit dhe Rrahimit, e nga barku Zyberit të tjerët, pak më shumë të zhvilluar numerikisht se dy barqet e para.
Meqë pasardhësit e Zyberit janë më të shumtë në numër dhe materialet për ata janë më të bollshme, mendova të filloj shënimet këtu.

***

Për Fezën nuk kam asnjë informacion, përjashtuar atë që kishte tre djem; Ibishin, Zyberin dhe Dinin. Edhe për radhën e lindjes së djemve nuk ka informacion, ashtu si nuk jemi në dijeni nëse kishte vajza të lindura në këtë familje.

ZYBER FEJZA

Zyberi jetoj në fshatin Bicaj në një kohë të vështirë për krahinën e Lumës dhe mbarë vendin. Ishte koha kur administrata turke e Prefekturës së Prizrenit filloi të vinte në zbatim reformat e Tanzimatit, të cilat detyruan vendasit të kalonin në protesta e kryengritje. Kryengritjet kundër Tanzimatit ishin kryengritje antiosmane gjatë periudhës së reformave burokratike centralizuese. Reformat kishin për qëllim forcimin e Perandorisë Osmane e të sundimit të saj mbi popujt e shtypur. Pakënaqësia e popujve të robëruar u shndërrua, sidomos në Shqipëri, në kryengritje masive të armatosura që vazhduan në disa dhjetëra vjet në krahina të ndryshme të vendit, që nga Kosova e Rrafshi i Dukagjinit dhe nga Shqipëria e Veriut deri në Myzeqe e Prevezë. Ato drejtoheshin kundër shtypjes kombëtare e shoqërore: administratës osmane, rëndimit fiskal, shërbimit të rregullt e të gjatë ushtarak. Nga kryengritje, në fillim lokale, ato u shndërruan dora - dorës në kryengritje të gjëra e ndërkrahinore. Më të shënuarat ishin: kryengritja e Beratit (1834), e Shkodrës (1835), e Myzeqesë (1835), e Dibrës (1844), e Kosovës (1844) etj. Administrata turke me forca të mëdha ushtarake filloi të ushtronte terror për mbledhjen e taksës të së dhjetës, regjistrimin e popullsisë dhe të djemve nizamë. Të ndodhur në këto kushte malësorët e Lumës, krahas rezistencës që u bënin nëpunësve turq për dhënien e taksave dhe regjistrimin e popullsisë, kundërshtonin dhe vendimet e Portës së Lartë që bënte përpjekje e vijonte zbatimin e reformave centralizuese të filluara shumë vite më parë, që ishin ndërprerë përkohësisht nga qëndresa e pandalur e tyre. Malësorët lumjanë ngulnin këmbë që të ruanin privilegjet që gëzonin, pavarësisht këmbënguljes qeveritare. Këto kërkesa të tyre nuk u morën parasysh nga Porta e Lartë e lumjanët i dërguan një kërkesë tjetër Mytesarifit të Prizrenit dhe nëpërmjet tij edhe Portës së Lartë, që të mos paguanin taksa të reja dhe të mos shkonin ushtarë.

Në këto kushte u përfshi në lëvizje dhe Zyber Fejza e Zyber Tema me shumë lumjanë të tjerë, e kjo lëvizje mori emrin "Lëvizja kundër reformave të Tanzimatit". Është quajtur kështu, se njihet në traditën popullore lëvizja antiosmane e malësorëve të Lumës kundër regjistrimit

të popullsisë, shtimit të taksave, çarmatimit, si dhe për lirimin e të burgosurve dhe të internuarve.

Në një polemikë spontane me një poet e shkrimtar të nderuar, ndër të tjera më shkruante duke më nxitur :
"Adem, këngët tona heroike janë kënduar për heronjtë e gjallë, janë kënduar si shpërblim, si servilizëm i rapsodëve ndaj heronjve të gjallë, që edhe janë koritë ma vonë. Për heronjtë e vdekur rrallë gjenden këngë të kënduara vetëm për shkak të meritave të pakundërshtueshme, e ky rast i rrallë është edhe për dy Zyberat, njërin prej të cilëve ti e ke gjysh apo stërgjysh, Zyber Fejzën".
Ai së bashku me porosinë më dërgoi edhe vargjet e mëposhtme :

Tobe n'tobe po shkojnë te ka (duke qarë)
Dy Zyberat na janë vra
Dy Zyberat si dy biblila
Zyber Tema e Zyber Fejza
Mo t'i veshim petkat e zeza…

Nisur nga kjo këshillë miqësore e tij, hapa arkivën familjare, ku janë të sistemuara shumë shkrime të babait, Kamber Avdi Fejzallari (1912 – 1990) mbi këto ngjarje.
Zyberi është babai i gjyshit të Kamberit. Për kujtesën time ndoshta është e largët, por për kujtesën e babait tim Kamberit, njeri që gjithë jetën i është kushtuar letrave, kujtimet për atë dhe kujtesa gojore, kanë qenë shumë më afër.
Ai shkruan : "U martua me një grua nga fisi Vishaj te Kolesjanit me emrin Hava. Në këtë martesë i lindi djali me emrin Bajram. Por pasi i lindi djali, Zyberi u vra ne vendin e quajtur "Kryqet e Nangve" ne Krenzë".
Ai e përshkruan Zyberin si një djalë trim dhe guximtar, një njeri shumë aktiv dhe pjesëmarrës në të gjitha protestat dhe kundërshtitë me armë kundër administratës turke dhe në rastet e cenimit të interesave të popullit të Lumës.
Kjo situatë luftarake në të cilën u përfshinë dy Zyberat përcillet me vargjet popullore, të cilat këndohen edhe sot për këtë ngjarje :

Xhit (çfarë) kane kodrat që bubllojnë
Dy Zyberat po luftojnë
Zyber Fejza e Zyber Tema
Thonë nuk veshim kule të zeza
Kule të zeza e dallama.

Në kulmin e betejës dy Zyberat ranë trimërisht për të mos u harruar kurrë e për t'u përjetësuar në histori.
Kjo rënie heroike u pasqyrua ne vargjet e këngës, ku thuhet :

Erdhi turku në Kolesjan
- Ori Shalë epna nizam!
- Une nizamin kurrë s'ta jap,
Po do të hash turk krejet tand.
Luftë e madhe bahet në Shalë…
Dy Ziberat po lanë namë.
Ziber Tema e Ziber Fejza
nuk i veshin petkat e zeza.
Sule Sinani trim i rrallë
s'i erdhe keq për asnjanin gjalë (djalë).
More turk, turk i dhunës
çe, kjo qe grika e Lumës.

Marre nga libri
"Kukesi i ri, vepër e Partisë" Këngë Popullore
Mbledhur nga Naim Mani
Botim i vitit 1980

Po si e përshkruan këtë ngjarje Prof.Dr. Shefqet Hoxha në librin e tij "Luma në luftërat për liri":
"Në pranverën e vitit 1843, në Shënkoll, dërgohet nga Dibra në Lumë një oficer turk, Rexhep Mat Tusha, me origjinë nga Mëhalla e Epërme e Ujmishtit, për të regjistruar e mbledhur nizamë. Ai shkon, së pari në katundin e tij e pastaj në Lusën e Kolesjan për të kryer detyrën që i qe

ngarkuar. Merret vesh nga malësorët puna që po bënte Pashai, prandaj mblidhet "Dheu i Lumës" në kuvend e vendos njëzëri. Më parë të vishet qefini i bardhë se sa të hyj arbneshi në petkat e zeza. Pra, Luma vendos të mos jap nizamë. E jehonën e zërit të atij kuvendi e sjell deri në ditët tona kënga popullore : "Ziber Tema e Ziber Feza, mo t'i veshin petkat e zeza".

Pas kuvendit të Dheut të Lumës, u tubuan dhe malësorët e Bicajve te Kepi i Kovaçit, ku u vunë re ndasi mendimesh midis parisë e vegjëlisë, por ata u fashitën dhe u miratua vendimi që kish marrë Dheu : të mos jepeshin ushtarë. Mendimet e vegjëlisë i përçuan në kuvend Abaz Myftar aga, Ramë Selmani, Dervish Muslia, Ibrahim Sokoli, Lul Sinani, Ziber Tema, Ziber Fejza (Canaj), etj. Menjëherë pas kuvendit nisën përgatitjet për qëndresë të armatosur dhe u dërguan lajmës edhe në Shtiqën e Gostil për të bërë të njëjtën gjë. Ndërkohë në Lusën e Kolesjan kishte plasur sherri me shpurën e Rexh Matës. Lusnjanët e kolesjanësit, të armatosur me topanxha e jataganë i thanë prerasi përfaqësuesit të dovletit : Nga sytë, këmbët**.**

Si dëshmon dhe kënga popullore, nga Kolesjani pashai u çoi fjalë krerëve të Bicajve (emri i vjetër Shalë) që të bënin gati nizamët e mbretit, por këta iu përgjigjën: U' nizamin s'un ta jap, por do të lash, Rexhë, kriet tat. Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Kur pashai i përcjelur nga një shpurë ushtarësh prej 50-60 vetash ra në Bicaj i kërkoi besë e strehë mulla Jeminit, hoxhës së katundit. Pas darke, Abaz Aga, në emër të të gjithë bicjanëve, hyri i armatosur në odën e hoxhës dhe i foli egër mikut të pagrishur : Zotni, akshami të ka gjete këtu, sabahi mos të gjejë, ndryshe i kemi do llafe të idhta nesër.

Tërë natën nuk i mbyllën sytë, as miqtë e as malësorët e armatosur të Bicajt; të parët për të gjetur një shteg për të dal gjallë; të dytët, duke lëvritur për të zënë shtigjet e për t'i prerë rrugën pashës"murtat" dhe shpurës së tij. Me të zbardhur drita, pashaj niset për rrugë në drejtim të katundit Nangë, i përcjellur nga dy krisma koburesh që njoftonin trimat se ai ishte ndarë keqas me krerët e vendit, prandaj po shkonte në Prizren "pa e çue në vend iraden e mbretit". Në të hyrë të katundit Nangë, në vendin e quajtur Zites, malësorët e armatosur me jataganë e sulmojnë

bylykun turk. Nizamët e mbretit u grinë të gjithë., por aty mbetën edhe disa malësorë. Rexha mundi të shpëtoj dhe i lypi besë Bajram Gashit të Gjërnezhas (lagje e Nanges) dhe shehit të katundit, i cili për tu ndal hovin bicjanëve të tërmegjur, u vuri përpara tagjën e tij (kësulën), por balli i trimave i përbërë nga vëllezërit Dervish e Ibrahim Muslia, duke shkelur mbi të, ranë përpara e rrethuan shtëpinë e Gashit, djemtë e të cilit "<u>për të mos i lanë marre vocit</u>" si besëprerë u detyruan të qëndrojnë si burrat e të vdesin në pragun e kullës. Me ta mbetën të vrarë edhe dy çobanët e shtëpisë që kishin lënë berret në mal e kishin ardhur në ndihmë të të vetëve. Prej shtëpisë së Gjërnezhit (Gashit) thuhet se shpëtuan vetëm dy gra me barrë, të cilat lindën dy djem që përtërinë fisin.
Gjatë luftimeve me mbrojtësit e pashës mbetën të vrarë midis të tjerëve edhe dy djemtë e Lul Sinapit, trimit të çartur bicjanë, si dhe Ziber Tema e Ziber Feza (i pari i shtëpisë së Fasli Minës, i dyti i barkut të Fejzallarëve). Kjo ngjarje i përket vitit 1843.
Më poshtë po citojmë disa vargje të mbledhura nga Qamil Hoxha, Prof.Dr. Shefqet Hoxha dhe Rifat Spahiu:

1. Rexha i Matës n'Kolosjan
Or i Shal" a po ep nizam
- U'nizamin s'un ta ap
Por do t'lash Rexh', kriet tat"
- Xhit kan' kodrat si po xhëmojnë
- Di Ziberat po luftojnë
Ziber Tema e Ziber Feza
"mo ti veshin petkat e zeza"
.....

2. Krisi pushka u bë poterja
Di Ziberat u vranë te dera
Xhit ka than' ki Ziber Feza
"s'vesh shqiptari petka t'zeza
Xhit kan' kodrat si gjëmojnë

Di Ziberat po luftojnë
Bajram Gashin po rrethojnë.
.....

Kur lexoj këta studiues të ndritur të trevës së Kukësit, këta lumjanë që kanë studiuar e shkruar aq shumë për Lumën e lumjanët, pa dashur të ndikoj në zbehjen e trashëgimisë gojore ndër fisin Fejzallar mund të them me bindje se : "kjo ngjarje dhe shkrimet e këtyre personave konkret t'i mbeten historianëve si pikënisje në trajtimin e historisë së lavdishme të trevës së Lumës. Unë nuk kam gjetur dokumenta të shkruara për dy Zyberat. Ata mbeten vetëm në fondin e kujtesës gojore familjare e popullore, mbeten në këngë, në vargje e tregime, e kjo nuk do të thotë se vepra e tyre nuk ekziston. Ata kanë qenë, janë e do të mbeten bijtë e Lumës se lavdishmë, bijtë e asaj Lume që luftoi për pavarësi në trojet e saj, bijtë që sakrifikuan gjënë më sublime, jetën e tyre për liri e sovranitet".
Babai Kamberi shkruan në shënimet e tij: "Në "Kryqet e Nangëve" në fshatin Krenzë, aty ku u vranë dy Zyberat, Paria e Lumës në kompensim të jetës së tyre i dha familjes sonë një sasi tokë buke. Deri vonë ne shkonim dhe merrnim bar të thatë nga kjo tokë. Ngaqë e kishim larg shtëpisë nuk e punonim, por e linim livadh". Reforma e kolektivizimit të bujqësisë, ashtu si rrafshoi tokën, "rrafshoi" dhe kujtesën tonë si familje për vendndodhjen e saj sot.

<u>Karakteristika te veçanta ;</u>
Ka qenë guximtar, trim dhe i besës. Këtë e tregon dhe rënia e tij pas përpjekjes me ushtarët turq. Pasuria e tij ishte e kufizuar në pak tokë buke dhe bagëti sa për të jetuar me nder, sepse dhe vendi ku ishte vendosur në Canaj, Bicaj, ishte pa perspektivë zgjerimi dhe pa mal për ruajtjen e bagëtive. Ka qenë i respektueshëm në shoqëri dhe ishte i gatshëm t'u shërbente të gjithëve. Kishte influencë në "Kuvend të Burrave".

BAJRAM ZYBER FEJZALLARI

Bajrami ishte djali i vetëm i Zyberit. U martua me një grua nga fshati Shtiqën të quajtur Zare, të bijën e Ram Hajdarit, në atë kohë familje me zë e pasuri. Sot nga kjo familje jetojnë në fshatin Shtiqën 3 vëllezërit, Xhemaliu, Muharremi dhe Neki Hajdari me vajzat e djemtë e tyre. Unë dhe familja jonë mbajmë lidhje e marrëdhënie të mira me ata. Është shumë e rëndësishme që njihemi e komunikojmë pas kaq shumë kohe. Unë kam qenë dhe jam që të afërmit, miqtë dhe të afërmit e miqve ne duhet t'i njohim dhe të mbajmë lidhje të drejtpërdrejtë. Ne nuk duhet të jemi kurrë shkaktarë me dashje për shkëputje e ndarje. Rrethanat nganjëherë janë imponuese.
Bajrami pati 3 djem Zyberin, Nebinë dhe Avdinë.
Karakteristika të veçanta :
Pas vrasjes së babës së tij Zyber Fejzës, ai fitoi influencë e afrim në shoqëri. Nga natyra ishte i zgjuar. Sipas tregimit të djalit te tij Zyberit, Bajram Zyber Fejzallari kishte shumë rëndësi në pleqëri e kuvend, saqë Paria e Vendit kur zhvillonin mbledhje me Krahina e Bajraqe (Mbledhja e Dheut), shumë herë nuk jepnin mendim përfundimtar, pa marrë mendimin paraprak të Bajram Zyberit. Djali i tij Zyberi tregonte se në një rast i ka thënë babës : "Ore babe, me qenë se Paria nuk po bëjnë gjëra të rëndësishme pa të pyet ty, pse nuk shkon vetë në Kuvend me dhanë mendim dhe me e thanë fjalën tande direkt?" Baba Bajram i është përgjigjur: "Unë nuk dua të uli yllin e Parisë e në anën tjetër nuk dua me marrë përsipër punë që ndoshta nesër nuk mundem me i krye".
Bajram Zyberi ka qenë pa shkolle, por ekonomist i mirë në kryerjen e llogarive në fshat e familje. Ka ushtruar profesionin "asqi" (kuzhinier) në dasma e mort nëpër katund. Djali i tij Zyberi tregon se ai ka qenë aq i përpiktë në llogaritjen e shpenzimeve, sa që në një dasmë me 300 miq e të tjerë, të mbeteshin të gjithë të kënaqur e të mos i shkonte asgjë dëm.
Pasuria e tij ka qenë 1 shtëpi me 2 kate e 4 dhoma, 20 dynym tokë mbi vade e nën vade, 50 krerë bagëti, 1 lopë, 1 pendë qe, të cilat i administronte me njerëzit e shtëpisë pa hysmeqar.

Në vitet e fundit të jetës, për tiparet e tij të sinqerta e njerëzore, u shfrytëzua dhe u afrua nga tarikati "Shejlerë", të cilët ishin vendosur në Canaj, Bicaj. Origjina e tyre ishte e hershme nga fisi "Bogdan" i Shkodrës. Fjala "Bogdan" vjen nga gjuha sllave që do të thotë "Dita e Zotit"(Божији дан). Gjatë sundimit turk u muslimanizuan dhe u transformuan në klerikë "shejlerë". Me anë të fesë shfrytëzuan shumë njerëz nga populli, në mes tyre rekrutuan si "tarik për dervish" edhe Bajram Zyberin, i cili në vitet e fundit të pleqërisë i la krejt interesat e familjes së tij dhe gjithë punën e mundin ia kushtoi Teqes. Djali i tij Zyberi tregonte se Bajrami shkonte me kecat e shehit për t'i kullotë, e në një rast i ka thënë : "Or babë, me qenë se ti po shkon me kullotë kecat e Shehit, merri edhe tanët me vete se kanë mbete të mbyllur në vathë". Bajrami shumë serioz i është përgjigjur : "Qysh me i përzi kecat tonë me të shehit!" Pra këtë veprim e konsideronte haram.
Bajrami ka jetuar rreth 90 vjet. Vdekja i ka ardhur nga pleqëria e nuk ka lënë prapa asnjë ngatërresë.

ZYBER BAJRAM FEJZALLARI

Ka lindur në verën e vitit 1850 në Canaj, Bicaj. Fatkeqësisht lindi sakat në këmbë e në dorë, por nuk pengohej në të ecur.
Kishte zgjuarsi natyrale, sa dallohej shumë nga shokët e tij bashkëmoshatarë, por edhe më të moshuarit në shumë raste e pyesnin dhe kërkonin mendimin e tij, e dëgjonin dhe ecnin pas fjalës së tij.
Ka bashkëjetuar me vëllezërit Nebi e Avdi, të cilët patën fatin e u zhvilluan me djem e vajza, kurse Zyberi nuk la trashëgimtar direkt prapa.
Si e ka kaluar jetën e tij "Çollaku" i Bajram Zyberit? Kështu quhej Zyberi në fshat e më gjerë.
Sakatllëqet e tij ishin: Tre gishta të dorës së djathtë ishin të bashkuar e më të shkurtër; gishtat e këmbës së djathtë i kishte të ngjitur dhe njëri mbi tjetrin. Këto i kishte që në lindje, por nuk pengohej në ecje. Me dorë lidhte cingaren e në këmbë vishte opinga si gjithë të tjerët. Gjatë jetës së tij të vështirë iu shtua edhe një sakatllëk tjetër : Në vitin 1915, në kohën e okupimit të Lumës nga ushtria Austro - Hungareze, u përhap në masë sëmundja e "lisë". Zyberi, për fat të keq, u prek rëndë nga kjo sëmundje dhe gjatë periudhës së shërimit mbeti qorr në një sy, megjithëse shërimin e tij e patën marrë përsipër mjekët austriakë. Ata u dorëzuan kur syri i tij filloi të shterojë. Me gjithë këto sakatllëqe ai ecte në këmbë në Canaj e katund më katund, ndër miq e ndër shokë ku e kërkonte puna e nevoja e njerëzve. Shumë herë e ka bërë në këmbë rrugën Bicaj - Prizren, që i zgjaste gati një ditë.
Megjthëse ishte djali me i madh i Bajramit, për shkak të defekteve fizike, Nebiu ka qenë martuar më përpara. Vete Zyberit i qëlloi të martohet 2 herë. Njëra e ka qenë bija e Ahmet Micit nga Surroj, me të cilën lindi një vajzë, që vdiq brenda vitit të lindjes. Pas saj i vdiq edhe gruaja. Tjetrën e ka pas nga fisi "Oruçi" i Kolesjanit, ku dhe kjo pa lënë fëmijë vdiq në vitin 1915 nga sëmundja e kolerës. Për këtë rast vdekje baba Kamber shkruan: “Axha Zyber kishte një grua nga fisi "Oruç" i Kolesjanit. Kjo në verën e vitit 1915 kishte shkuar tek prindërit e saj në Kolesjan, ku kishin rënë 2 sëmundje shumë të rrezikshme: kolera dhe lija, të sjella në vendin tonë nga ushtarët austro - hungarezë gjatë Luftës së Parë Botërore. Këtë

grua të infektuar nga të 2 sëmundjet e sollën në bjeshkë. Unë, si fëmijë, duke qëndruar me atë ma ngjiti sëmundjen e lisë, po ashtu dhe Axhës Zyber, kushëririt tim Asllanit e të tjerëve. Me rëndë e kanë pasë Oruçja dhe Kadirja, nëna e Asllanit, të cilat vdiqën. Unë, Asllani e axha Zyber vuajtëm afro 1 vit dhe pastaj u shëruam, duke na mbetur shenja në trup e në fytyrë. Axha Zyber mbeti qorr në një sy".
Me vdekjen e Oruçes, Zyberi nuk pranoi të martohej më.

Karakteristika të veçanta :
Ka mbetur pa shkollë për fajin se jetoi në një regjim të rreptë fetar të nxitur nga pushtimi turk. Pak pas Lidhjes së Prizrenit xhonturqit edhe në Lumë futën metodën e mashtrimit, gjoja për të hapur shkollë, e me këtë rast dërguan në Bicaj një hoxhë, mulla Hafizi, i cili filloi të mësonte nxënësit në xhami të Halil Agës, pa dallim moshe, por vetëm në gjuhën arabe. Në këtë shkollë hyri dhe "Çollaku" Zyber. Ky duke qenë shumë i zgjuar filloi të kapte menjëherë mësimet dhe të lexonte Kuranin e të shkruante arabisht. Hoxha e dalloi që Zyberi shkruante me dorë të majtë, e kjo e acaroi së tepërmi, duke e kërcënuar, por edhe duke e përzënë përfundimisht nga shkolla. Përdorimi i dorës së majtë për besimin islam është haram, sepse sipas saj vetëm shkijet (sllavët) shkruajnë me dorë të majtë. Megjithëse u largua nga shkolla, asnjëherë nuk e la prapa mësimin e arabishtes dhe Kuranit. Ai nga këto mësime në shumë raste, në moshë madhore, ka zëvendësuar Imamin në xhami.
E vriste mendjen shumë për gjëra që i hynin në punë shoqërisë dhe për ato që interesoheshin të tjerët.
Nga natyra kishte lindur matematikan, megjithëse si theksuam nuk kishte asnjë klasë shkollë. Llogariste përmendësh në katër veprimet aritmetike (+ - x :) deri në shumën 500 mijë.
Tregojnë se që në moshë të vogël jepte shenja zgjuarsie në krahasim me moshatarët e tjerë. Njëherë ai kalonte para Komunës me dhen, që po i dërgonte në kullotë. Kryetari i Komunës po qëndronte para Komunës dhe i thonë se ai djali me dhen është shumë i mençur. - Ma thërrisni pak këtu – u thotë ai. Zyberi afrohet dhe pasi fillojnë bisedën, ai e pyet ndër të tjera? – Si jeni me bylmet?

– Tamël (qumësht) sa ka falë Zoti e dhallë sa i duhet nënës – i përgjigjet Zyberi. Kryetari, duke mos qenë vendali nuk e kuptoj përgjigjen dhe ata që e shoqëronin i shpjeguan se “qumësht sa japin delet e dhallës i hedh ujë në sasi sa t’i duhet nënës për të ushqyer pjesëtarët e familjes”.
Ishte agronom nga natyra dhe njihte procedurën e punës që duhej të ndiqej për të gjitha kulturat që mbilleshin në Lumë. Pyetej për kohën optimale të mbjelljeve.
Ishte në punën e tij dhe gjeometër i shkëlqyer. I bënte të barabarta të gjitha parcelat e tokave, në çfarëdo forme a mase qofshin. Këtë e zbatonte kur ndante pleqëri apo në ndarje vëllazërish, e për këtë fliste me shumë kompetencë.
Kishte drejtësi e ndërgjegje të pastër, prandaj kërkohej nga njerëzit për rregullim të ngatërresave në familje a shoqëri.
E vriste mendjen edhe për gjëra të rëndomta dhe thellohej shumë në disa raste. P.sh. mundohej me ditë sa kokrra gruri ka një shekë grurë. Ai peshonte një okë grurë, e numëronte e pastaj e shumëzonte për 33, që ishte sasia e okëve në një shekë. Krijonte shumë probleme matematike dhe shkonte ju a jepte për zgjidhje arsimtarëve në shkollë. Arsimtarët e viteve 1922 - 1930 në Bicaj nuk kanë qenë shumë profesionistë e kompetentë, por ato kalonin mirë me Zyberin dhe e mbanin shumë afër.
Ja një problem që e mban mend edhe baba Kamber, të thënë nga axha Zyber :
Po fluturonin për në shtegtim disa pata në qiell. Një patok i çalë, që nuk fluturonte dot, u drejtohet patave:
- Udhë e mbarë o 100 pata !
- Nuk jemi 100 pata. Merr 2 fishin tonë, shto dhe aq sa jemi, shto gjysmën tonë, shto çerekun tonë e po të marrim edhe ty me vete, bëhemi 100.
Sa pata ishin?

Si vepronte në raste ndarjesh (vllazërish apo ngatërresash)?
Kërkonte të mos linte prapa probleme a ngatërresa edhe për gjërat më të vogla. Vlerësonte me kompetencë e me shumë seriozitet të gjitha materialet që kishte në shtëpi dhe që i viheshin në dispozicion. Bënte krahasim në vlerë të një materiali me një tjetër, sikur të ishte një ekonomist shumë i mirë.
Ndërhynte me vetëdije për shkatërrim borxhesh e shamatë dhe pajtonte ngatërresat deri gjaqet në raste vrasjesh, me qëllim që ato të mos vazhdojnë në hakmarrje.
Vlerësonte punën e gjithsecilit (të krahut e të mendjes). Kur bënte ndarje në familje, që përveç tokës e shtëpisë kishin dhe bagëti, kur shkonte tek vatha e bagëtive, atë më të mirën ia linte çobanit. Pas kësaj pyeste: A kishte të fejuar e duhej të martoheshin (linte mënjanë bagëti për përballim të shpenzimeve të dasmës); pyeste për borxhet dhe bënte llogari sa bagëti nevojiten; diferencën tjetër e ndante në sa pjesë duhej për rastin konkret. Në të gjitha ndarjet nuk përzihej vetëm në arkat e nuseve që ishin në dhoma të veçanta; në takëmet e kafes dhe në cergën e shtruar në dhomën e miqve, që ia linte të zotit të shtëpisë; në magjen e bukës që ishte në shtëpinë e zjarrit me saç e çerep, që ia linte të zonjës së shtëpisë, që atëherë quhej magjatore.
Ai i shërbente gjithkujt e me gjithë zemër.

Rregullat në jetesë e në të ngrënë !
Nuk lakmonte shumë dhe nuk zgjidhte në ushqime, por ajo që është karakteristikë e veçantë, se regjimi i gjumit ishte absolut. Kur i vinte ora e gjumit, dimër apo verë, pa marrë parasysh asnjë rrethanë ku ndodhej, do të binte në gjumë, por nuk flinte shumë.
Nuk hante kurrë brenda ditës të njëjtën gjë dy herë. Kjo më shumë në raste festash etj, ku gatuhej në sasi më të madhe dhe ushqimi që tepronte mund të vendosej atë ditë përsëri në sofër.
Nuk fillonte bukë në sofër, verë apo dimër, pa pasur përpara një zarzavate të njomë apo të thatë : presh, qepë, hudhër, spec, domate, lakër etj.

Nuk hante ushqim të nxehtë e në raste miqësie apo raste me mysafir, nuk i vinte zor të priste deri sa të ftohej ushqimi e pastaj të fillonte për të ngrënë. Ka jetuar me dhëmbët e tij, të paprishur dhe të pa mjekuar te dentisti deri në ndarjen nga jeta në moshën 93 vjeç.
Nuk ka përdorur asnjë lloj pije me përjashtim të dhallës.
Kafen gjithmonë e pinte pa sheqer (sade) dhe pasi të ftohej pak.
Nuk pinte shumë duhan, por pinte vetëm duhanin e kopshtit vet, të cilin ia prodhonin pjesëtarët e familjes, vëllai Avdi dhe plaka e kushëririt të tij, Sulltania (nëna e Dullës). Dridhte në mëngjes 20 copë cigare. Nuk pinte duhanin që ia jepnin për ndërresë kur takohej me miq e shokë. Duhanin e fituar në ndërrim cigareje ia jepte dikujt tjetër.

Si i erdhi fundi i jetës !
Zyberi në kohën që u nda me vëllezërit ishte i vetëm dhe kur erdhi ndarja e vëllezërve, u nda nga Nebiu dhe shkoi të jetonte me vëllain tjetër Avdi. Arsyeja ishte se në atë kohë Avdiu kishte fëmijë të vegjël dhe e kishte më vështirë për t'i rrit fëmijët me atë pasuri që do ti takonte nga ndarja. Zyberi duke qenë i dhimbshëm nga natyra, pasi e ndanë pasurinë në tre pjesë, pjesën e tij e bashkojë me të vëllait Avdi. Ndarja e vëllezërve ka ndodhur në vitin 1916. Pas vdekjes së Avdisë, Zyberi pyetej si përgjegjës në familje dhe e drejtonte atë shumë mirë dhe pa hile. Baba Kamber tregonte se kur ishte Zyberi zot shtëpie pas vdekjes së babës Avdi, unë punoja në Komunën Bicaj si sekretar. Rreth moshës 27 vjeç fillova të pij duhan, por më vinte turp ta pija para mixhës Zyber. Ai e kishte kuptuar nga kolla që më zinte natën. Unë flija në katin e tretë të kullës, ai në katin e dytë. Një ditë sapo u gdhi dëgjoj goditje me shkop nga poshtë dyshemesë. E kuptova që po më thërriste mixha Zyber. U vesha dhe u ula poshtë. Ai ma kishte përgatitur një kafe dhe në rrëzë të filxhanit kafes kishte mbështetur një cigare. Ulu bir – më tha dhe më zgjati zjarrin me mashë për të ndez cingaren e dredhur.
– Nuk e pi mixhë – i thashë. – Jo, pije! Tani je i madh, zot shtëpie e nëpunës shteti. Dikush do ta pijë duhanin në familje. E që nga ajo ditë unë e ndeza duhanin para tij pa droje.

Nga viti 1941 - 1946 Kamber Avdia, djali i Avdisë, që ishte bashkë me Zyberin, ka qenë me punë e me banim në Prizren. Atje jetonte edhe nëna e Dullës, Sulltania dhe gruaja e Kamberit Nuria. Zyberi në të shumtën e kohës qëndronte në Bicaj.

"Kur rashë në burg në Prizren, në prill – maj të vitit 1942, - tregonte baba Kamber - axha Zyber erdhi në këmbë, megjithë të metat fizike, nga Bicaj në Prizren për të më takuar. Me vete kishte mbështjellë në një shami të lidhur në brez një sasi të konsiderueshme të holla, monedha të llojeve të ndryshme, si i kishin qëlluar dhe më tha se kujt duhej të ia jepte për të më liruar. Unë i shpjegova se po t'i jepte ato të holla, unë me të vërtetë lirohesha, por sa t'i mbaronin më arrestonin përsëri se kërkonin të tjera, kështu që duhet të lirohem pa të holla, e kështu u lirova".

Ditët e fundit të jetës Zyberit iu mbush mendja për të bërë vizita e të takonte të gjithë miqtë e të afërmit, që fillonin nga : Halil Murati, Morin (Halla Nure ishte martuar me Rexhep Halilin); Idriz Laçi, Bardhoc (Halla Zare ishte e martuar me Idriz Laçin); Rexhep Seidia e Demir Imeri, Ademaj, Bardhoc (?); Ali Xhahu, Gjegjan (?); Imer Hallaçi (Rahimja, nëna e babait Kamberit ishte nga kjo familje), Pobreg; Maliq Hajdari (gjyshja e babait, Kamberit, ishte nga kjo familje), Shtiqën; Sejdi e Shaqir Plaka (Doçi), (?) Nangë; familjen e vëllaut, Bicaj; miqtë e gruas së Kamberit, Dan Sinani, Kolesjan; Vehap e Ali Korbi, (?) Kolesjan; Sherif Dull Visha, (Hava e Zyber Fejzës ishte nga kjo familje), Kolesjan; Isuf Caka, (nëna e Dullës ishte nga kjo familje), Ujmisht. Të gjithë këta i ka pasur miq shtëpie që rridhnin direkt nga ai ose nga nipat e mbesat e familjes. Për këtë rast baba Kamber e përgatiti me rroba të reja e ndërresa dhe kështu është nisur për rrugë. Nuk hipte kurrë në mjete transporti dhe nuk mbante shumë lek me vete. Këto vizita i përfundoi me datën 3 qershor 1943.

Ka qenë për tu adhuruar si i shenjtë. Kur ka shkuar në mbrëmje në shtëpi të vet e ka vënë re se ajo ishte e mbyllur, pasi siç kemi theksuar nipi i tij Kamberi jetonte familjarisht në Prizren. Ka kaluar nga shtëpia e djalit të vëllait, Isufit, është përshëndetur me nusen e tij dhe e ka porositur : "Sonte dërgoi fjalë Isufit të mos vonohet në klub. Llambën e vajgurit laje mirë e mbushe plot me gaz (vajguri). Dhomën pastroje mirë". Nusja e

Isufit i është përgjigjur : "Isufin po e lajmëroj me ardhë, por llambën ne e lajmë përditë dhe jo vetëm sonte". Mirëpo Zyberi vazhdoj: "Sonte është më ndryshe e kemi punë të tjera". Në këto fjalë ka ardhur Isufi e ngadalë të gjithë pjesëtarët e familjes janë mbledhur në shtëpi. Në fshat zakonisht darka shtrohet më herët, e sa ka filluar të errësohet kanë kthyer sofrën. Zyberi ka kërkuar t'i sjellin një presh nga kopshti. Ndërkohë që nusja e Isufit ka marrë preshin nga kopshti dhe po e pastronte në këmbë brenda në dhomë, Zyberi siç ka qenë këmbëkryq, menjëherë është mbështetë në krah dhe pa dhënë asnjë përgjigje i ka pushuar zemra. Sipas telegramit që i ka dërguar Isufi Nebia, Kamber Avdisë nga Bicaj në Prizren, Zyberi ka vdekur në ora 20.00 të datës 3 qershor 1943.
Te nesërmen herët Kamber Avdia ka shkuar në Bicaj së bashku me gruan Nurien dhe i kanë bërë të gjitha nderimet e përcjelljes për në banesën e fundit, sipas zakonit të atëhershëm.

Zyberi gjatë të gjithë jetës së tij nuk ka punuar në punë fizike për arsye të defekteve të lindura, por megjithatë punëtorëve dhe pjesëtarëve të familjes u qëndronte gjithmonë afër. Vëllezërit Avdi dhe Nebi vdiqën para tij e kështu i mbeti barra e kujdesi familjar, pra edhe lodhja mendore. Pozitive ishte se kishte memorie të fortë, pra mbante mend shumë.
Zyberi ka kaluar shumë dallgë vuajtjesh e luftërash. Ka marrë pjesë në Luftën e Kaçanikut të drejtuar nga Isa Boletini, dhe tregonte se po te mos ishte tradhtia e bejlerëve të Gjakovës dhe të Pejës, kufiri i Shqipërisë do të ishte tek "Guri i Shpumë", përtej Kaçanikut. Në këtë luftë e ka marrë me vete pa pushkë, si kështilltarë, Islam Spahiu nga Kolesjani e Ramadan Zaskoci nga Mamëzi.
Kamber Avdia shkruan diku në shënime të tijat : "Në bisedë me mixhën Zyber i thashë se po lodhem shumë me punë zyre e ai u përgjigj: – Për burrin punë të rënda janë; me përkund fëmijë në djep, me ecë para qeve në lavër dhe me hedhë kokrra në hulli të arës".
Edhe Zyberi, në kohën e tij, ka qenë afruar me klerin "shehlerë", por ishte më i zgjuar se babai i tij dhe nuk futej në shërbim të tyre, bile ai mundohej t'i shfrytëzonte shumë herë njerëzit e klerit.

Zyberi, përfundimisht mbetet një njeri me veti të mira. Nuk tallte askënd. Nuk i binte asnjë vegle muzikore e as nuk këndonte, por vetëm dëgjonte e blinte.

Këshilla te Axhës Zyber thënë Kamber Avdisë ditën që i vdiq baba Avdi. "Porsa jemi kthyer në shtëpi nga varrimi i babës – shkruan Kamberi – ndërkohë që unë isha ushtar me leje, kemi përcjellë shokët që na kishin nderuar në varrim, jemi ulë afër njëri tjetrit. Unë në atë kohë kisha 10 vjet nëpunës. E kuptoja dhe e dëgjoja mixhën me vëmendje. E ka filluar bisedën me fjalët :

- Mos u mërzit bir! Duke përcjelle njëri tjetrin, përcjellim veten.
- Askujt të mos i mbetet lakmi, përveç qefinit.

Porosi të Zyberit :

- Bëju urë për ata që nuk kanë sy me kalue.
- Mos shfrytëzo forcën tënde kundër atij që është i lidhur.
- Ndihmo me kafshatë atë që nuk ka dhe nuk ka mundësi.
- Shkallmoje atë që mburret pa qenë i autorizuar ose i ngarkuar nga Qeveria.
- Idhnohu kur është nevoja.
- Duro kur paraqitet rasti i ngatërresave, prit ti zgjidhi mileti (populli).
- Mos ndërhy kur je i pa armatosur.
- Kallzo hasmit e vatanit (tradhëtarët) e kërko largimin e tyre prej vendit.
- N.q.se të kërkohet ndihmë për paqësim ngatërresash, jep mendim jo anësor.
- Për gjithçka, ngule thikën vetes e vepro.
- Burrnia në ndarje ka rëndësi.
- Paraja e bardhë, për ditë të zezë. Po lakmove shumë paranë, ose përfundon me varje në publik, ose nuk të dihet vorri.

NEBI BAJRAM FEJZALLARI

Nebi Bajram Fejzallari ka lindur në Canaj, Bicaj në vitin 1865.
Nebiu është djali i dytë i Bajramit dhe ka qenë i martuar me Kadire Ram Pepën nga fshati Nangë, fis i njohur në atë kohë dhe i pasur, por i marrë më shumë me bujqësi.
Me Kadiren kanë lindur e rritur djemtë Isufin, Asllanin, Vehapin dhe vajzën Xhemile.
Vehapi dhe Xhemilja kanë vdekur në moshë të re. Xhemilja në vitin 1915 nga kolera dhe Vehapi në vitin 1928 nga TBC kockash, me plagë në këmbë e duar. Po në vitin 1915 i ka vdekur në stan në bjeshkë nga sëmundja e lisë dhe e shoqja Kadirja.
Djemtë e tyre, Isufi dhe Asllani u rritën, u zhvilluan dhe krijuan familjet e tyre.
Nebiu si profesion kryesor ka pasur bujqësinë e ishte punëtor e bujk i mirë. Ishte njeri me karakter të vendosur. Nuk merrej me tregti e kuvende në fshat, por shikonte vetëm punën e tij. Ai nuk duronte të merrej nëpër goje, as për të mirë e as për të keq. Këtë e vërteton fakti se në një rast S.I. nga Canaj i paska thanë një fjalë si me shaka e ky e ka konsideruar tallje. S. ishte më i moshuar e njeri me zë, por Nebiu pa marrë parasysh asnjë pasojë të mëvonshme të veprimit të tij, ka marrë një gur të madh dhe në mes të rrugës i ka ra në kokë dhe e ka lënë të vdekur. Vëllezërit e tij, për këtë veprim kanë paguar 33 napolona ari (vlera e gjakut të S. I.).
Nebia ka jetuar 75 vjeç dhe ka vdekur në vitin 1940 në Bicaj nga sëmundja e sifilizit. Si pasuri ka pasur pak tokë dhe punonte tokat e huaja si argat. Nga fundi i jetës iu rritën djemtë, filluan punë shtetërore e me këto të ardhura blenë edhe tokë. Për bagëti nuk kanë qenë të preokupuar, për faktin se nuk kishte kush të kujdesej për ato, pasi si theksuam me sipër djemtë ishin të punësuar në punë shtetërore.

ISUF NEBI FEJZALLARI

Ka lindur në Canaj, Bicaj në vitin 1900.
Isufi ka qenë tip i zgjuar, megjithëse kishte 3 klasë shkollë fillore të ndjekura pa shkëputje nga puna, të fituara në vitin 1920, kur është hapur shkolla e parë shqipe me mësues të parë Kol Vilën. Kola fillimisht ka ardhur si marangoz në Bicaj, më vonë u punësua si mësues, dhe ishte mësues shumë i mirë. Po ashtu punoj si mësues edhe Kol Shala, i cili erdhi në Bicaj e merrej fillimisht me vizatim e bojatisje. Të dy këta me ardhjen në Bicaj, fituan shumë në karrierën e mëtejshme si mësimdhënës.
Isufi nga viti 1926 - shtator 1944 ka qenë i punësuar në Forcat e Xhandarmërisë Shqiptare. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, me qenë se nuk ishte përlyer me padrejtësi ndaj popullit gjatë luftës, arriti të sistemohej në punë shtetërore dhe të përfitonte pension pleqërie.
Në shoqëri kishte njëfarë influence, por më tepër tek disa persona që ishin të varfër dhe u mungonte iniciativa e veprimit. Ata e kërkonin për ndihmë me emrin "Baba Isuf"dhe ai i ndihmonte pa u kursyer. Mundohej të vërtetonte se është nipi i Zyber Bajramit, e ndonjëherë gjente momentin e kryente ndonjë veprim apo shprehej si mixha Zyber.
Ai ka punuar në ndërmarrjen Tregtare të Shitblerjes Kukës, me profesion banakier në lokalin e fshatit Bicaj. Këtë punë e ka kryer me shumë përkushtim.
Ka punuar edhe në Ndërmarrjen Bujqësore Kukës si normist.
Isufi me vëllain e tij Asllanin dhe disa bicjanë të tjerë e bënin në këmbë gjithë rrugën nga Bicaj në fermë e anasjelltas, për çdo ditë, pasi ishin vitet ’60 dhe nuk kishte makina për lëvizje. Çdo darkë sillnin tek shtëpia nga dy bukë gruri për familjen.
Isufi ka qenë i martuar me Shine Dragjoshin nga fshati Vilë, Kukës, dhe me atë pati dy fëmijë, Hakiun dhe Samiun.

Haki Isuf Fejzallari ka lindur më 15 maj 1933 në Canaj, Bicaj. Ai si fëmijë lindi dhe filloj të rritet normal dhe i tillë ka qenë deri në moshën 7 vjeç. Në këtë moshë ai është sëmurë në një festë Bajrami. Në këtë festë, Hakiu, si i pashëm që ishte, u ka shërbyer njerëzve që vinin për urim duke u ndezur cigaret dhe duke i qerasur. Atë ditë, mesa duket e kanë marrë mësysh, është sëmurë dhe ka mbetur me probleme deri në fund të jetës së tij. Nuk arriti të ushqehej e të vishej vetë si duhet, pasi nuk ishte i përqendruar në ekuilibër.
Pjesën e fundit të jetës shkonte me bagëti të fshatit. Ka qenë shumë i kujdesshëm dhe i ruante aq mirë sikur të ishin bagëtitë e veta. I njihte dhitë dhe ishte në gjendje të dinte e kujt ishte çdonjëra, në një tufë që kalonte të 100 krerët. Periudha që ka punuar si çoban i është njohur si vjetërsi pune.
Nga viti 1978 deri në vitin 1993 ka punuar si punëtor në Drejtorinë e Mirëmbajtje Rruga Kukës, ku ka dalë në pension pleqërie, të cilin e ka gëzuar deri ditën që është ndarë nga jeta, 28 mars 2006.
Hakiu ka qenë shumë i kujdesshëm dhe nuk ka lejuar që brenda avllisë së shtëpisë së tij të preket asgjë. Kështu mund të përmendim një rast kur disa hajdutë të fshatit Canaj kanë tentuar të vidhnin bagëtitë e Asllan Nebisë, që strehoheshin në shtëpinë e Kamber Avdisë. Haku i ka dëgjuar hajdutët dhe ka njoftuar djemtë e Asllanit, të cilët i kanë ndaluar bagëtitë në rrugë, ndërsa hajdutët janë larguar.

Vdekja e nënës së tij ishte jo vetëm ndarje fizike, por edhe vdekja e tij shpirtërore. Gjithmonë nëna e tij, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore dhe fizike të Hakiut, pamundësinë e tij për t'i shërbyer vetes së vet, shprehte merakun e saj për të ardhmen e Hakiut pas ndarjes së saj nga jeta.
Shqetësimi i saj ishte i drejtë, por edhe Hakiu pas largimit të saj ishte në kujdes të vazhdueshëm gjatë gjithë kohës sa jetoi.

Për atë është kujdesur familjarisht kushëriri i tij Luani, djali i Asllanit. Shota, gruaja e Luanit, i gatuante dhe e lante. Ajo kujdesej shumë për Hakiun, megjithëse shërbimi ndaj tij ka qenë tepër i vështirë. Jetonte në


3) 50 vjeç, punon me
M.M. Drenga punëtor, por nuk
dini sa para mban dhe
si bëroboro veçgjithë.
I bëra ky procesverbal per
firmën dhe e veriu
original:
MAHMI

një dhomë të shtëpisë që i kishte lënë baba. Duke mos qenë të kujdesshëm ne nuk disponojmë asnjë fotografi të Hakiut, në asnjë periudhë të jetës së tij. Babai, Kamberi, më 2 shtator 1979, me rastin e ndarjes së djemve të Asllanit ka bërë një vizitë tek shtëpia e tyre në Bicaj. Aty ka qëndruar e ka bërë një bisedë me Hakiun e ndërkohë i ka marrë një nënshkrim origjinal nga dora e tij. Letra ruhet në arkivin e familjes.

Sami Isuf Fejzallari ishte djali i dytë i Isufit dhe Shines. Ai lindi më 6 gusht 1936.

Pasi ka kryer shkollën 7 - vjeçare, ka mbaruar dhe shkollën 2 vjeçare për teknik miniere në Memaliaj të Tepelenës. Pas shkollës ka punuar në minierën e kromit të Kamit në Tropojë.

Ka kryer kurs për këpucar dhe e ka ushtruar zanatin në Ndërmarrjen e Riparim Shërbimeve Kukës

Duke qenë djalë i ri, i shkathët dhe punëtor ndërmarrja e zgjodhi si sekretar të Komitetit të Rinisë.

Ka mbaruar edhe kursin për autokinema dhe ka punuar me këtë profesion duke shfaqur filma në çdo fshat të rrethit Kukës.

Më vonë u shoqërua me shokë jo të mirë, mori vesin e pijes dhe filloi të shpërdoronte pa masë, duke u bërë i keqi i vetes.

Familja e tij nuk ka pasur të mira nga ai, deri sa vdiq me 3 qershor 1987 në moshën 47 vjeç.

Isufi megjithëse kishte dalë në pension pleqërie, dilte në punë në kooperativën bujqësore "Partizani" Bicaj.

Ai ka qenë shumë i zgjuar dhe ndjeje krenari kur ai ishte në shtëpi e rrinte në krye të vendit duke bërë muhabet.

Është ndarë nga jeta në një aksident automobilistik në vendin e quajtur "Nërshaklla" afër katundit Nangë, Bicaj, më 11 shtator 1972. Po kontribuonte vullnetarisht në kooperativë për kultivimin e vjeljen e prodhimeve në vreshta. Akti dhe vullnetarizmi i tij nuk u vlerësua, por ai mbetet një person i nderuar për fshatin Bicaj, krahinën e Lumës e më gjerë.

ASLLAN NEBI FEJZALLARI

Ka lindur në Canaj, Bicaj më 10 Nëntor 1907, nga martesa e Nebiut me Kadiren.
Asllani u martua me Hyrie Garip Avdylin nga fshati Turaj, Topojan, e datëlindjes 15 shkurt 1914. Ajo rridhte nga një familje fshatare e mesme, me tokë e pasuri dhe plotësonin të gjitha nevojat e tyre jetike. Pas çlirimit anëtarët e familjes kanë punuar në kooperativë e një pjesë në ndërmarrje shtetërore.

Asllani me Hyrien kanë rritur 3 djem (Fuatin, Luanin, Shkëlqimin), të mbarë e me kulturë. Të gjithë kanë përfunduar shkolla dhe janë marrë me punë shtetërore, duke qenë punëtorë dhe të qetë në punën e tyre. Gjithashtu ata kanë rritur edhe 4 vajza : Remzie, Kadire, Shpresa e Qefsere, të martuara e me fëmijë.

Mbas Kongresit të Lushnjës në Bicaj u hap shkolla e parë shqipe, me mësues Kol Vilën dhe Kol Shalën, të dy nga Shkodra. Këta bënin shkolle natë. Në këtë shkollë morën pjesë vëllezërit Isufi dhe Asllani, të cilën e vazhduan për 2 vjet. Pas kësaj kohe Asllani shkoi ushtar në Përmet dhe Isufi u regjistrua për xhandar.
Karakteristikë është se Asllani ka shkruar letër pas një viti, e pikërisht në dimër 1923, e në letër tregonte se ka bërë një muaj rrugë në këmbë deri sa arriti në Përmet. Komandant aksioni e mobilizimi ishte Ismail Haki Tatzoti dhe Azis Çami. Letra që kishte dërguar Asllani ishte me bojë të kuqe. Baba Nebi e kishte marrë dhe nuk e kishte hapur fare, e kur shkon Kamber Avdia , kushëri i Asllanit, te xhaxhai i tij Nebiu, e përshkruan kështu situatën në kujtimet e tij : "Unë e gjeta me lot në sy. Kur e pyeta më tha: - Ka ardhë letër nga Asllani e paska vdekë, se letra kur shkruhet

me të kuqe, ashtu ashtë! Unë isha në klasë të dytë dhe kisha pas kuptue se letra me bojë të kuqe mund të shkruhen edhe për mirë. Këtë nga raste të tjera. E sigurova, se mua më besonte e më donte shumë. E hapa letrën dhe e lexova me zë të lartë. Tregonte se ishte mirë. Kishte me ngrëne e me veshë në rregull, pyeste për të gjithë dhe tregonte se do të lirohej nga fundi i vitit 1924. Në fakt ashtu u bë, se me fillimin e Revolucionit të Qershorit, ushtria u caktua në afat 2 vjeçar, e ata që kishin plotësuar periudhën u liruan".

Asllani, duke qenë në shërbim të xhandarmërisë, ka arritur karrierë deri në gradën Kapter, dhe si tip i zgjuar i kapte gjithmonë problemet në detaje.

Ka kryer shkollën e Xhandarmërisë duke e përfunduar atë me rezultate të shkëlqyera me të gjitha notat 1 (nota 1 ishte vlerësimi më i lartë në shkollat e asaj kohe). Në Shkollën e Xhandarmërisë ka pasur si pedagog dhe drejtues emra shumë të njohur për aftësitë e tyre profesionale, si Siri Çarçani, Tasim Bishqemi, Ali Erebara, etj. Duke qenë i shkolluar dhe i pajisur me dokumentet përkatëse të shkollimit është emëruar nga nomenklatura Komandant Poste Xhandarmërie në Himarë, dhe ka shërbyer në gjithë Bregun e saj, ku përshihen zonat Vuno, Qeparo e deri

në Piqeras të Sarandës. Ka qëndruar në shërbim të xhandarmërisë nga viti 1928 - 1939, dhe me pushtimin e Shqipërisë nga Italia i është kërkuar të punoj në shërbim të pushtuesve fashistë, por një gjë e tillë është refuzuar në

mënyrë kategorike nga Asllani dhe nuk ka pranuar më punë shtetërore, por ka shërbyer gjatë luftës në shtëpi të vet duke u marrë me punë bujqësore e blegtorale.
Asllani me familjen e tij kanë kontribuar e ndihmuar pa rezerva lëvizjen nacionalçlirimtare. Shtëpia e tij u bë një nga bazat më të fuqishme të luftës në gjithë zonën e Lumës.
Në kujtimet e tij për luftën veterani i nderuar Rasim Guri , në mes të tjerash, përmërmend me nderim e respekt të madh edhe 30 bazat e luftës në zonën e Lumës, ku në numrin 20 të këtyre bazave përmend shtëpinë e Asllan Nebi Fejzallarit.
Akoma pa u çliruar Shqipëria, me krijimin e Këshillave Nacionalçlirimtare, Asllan Nebia u zgjodh kryetar i parë i këshillit nacionalçlirimtar në Bicaj, duke kontribuar maksimalisht me detyrën e tij në fitoren përfundimtare mbi pushtuesin. Detyrën e Kryetarit të Këshillit e ka ushtruar edhe pas çlirimit të vendit, deri në vitin 1954, pra për 10 vite me radhë.
Pas çlirimit të vendit ka qenë i zgjedhur edhe si ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Qarkut Kukës, duke punuar me shumë përkushtim, korrektesë, ndershmëri dhe profesionalizëm.
Asllani ka qenë ndër të parët që ka përqafuar e mbështetur pa rezerva reformat e rëndësishme që ka ndërmarrë shteti shqiptar, sidomos përsa i përket nismave për bujqësinë e fshatin.
Asllani ka pasur një shkrim aq të bukur sa e kishin zili edhe punonjësit më të lartë të administratës shtetërore. Për shkak të shkrimit të bukur e nivelit intelektual të lakmueshëm Drejtoria e N.B.Lokale Kukës i ofroi Asllanit punë si nëpunës (normist), por këtë detyrë ai nuk e pranoi dhe në vend të tij kërkoi të sistemohej vëllai i tij, Isufi Nebia, e kështu u bë.
Por duke parë që nuk po i përballonte vështirësitë ekonomike, pasi familja e tij përbëhej nga 9 persona, mori leje nga Kooperativa Bicaj dhe filloj punë në N.B.Lokale, Kukës. Aty punoi deri në vitin 1972, kohë në të cilën doli në pension pleqërie.



Hyrie Garip Fejzallari

Në këmbë, Hyria - shoqja Asllanit, Qefserja, Shinia – shoqja Isufit, Qefserja dhe ulur Shpresa. Fëmijët e Fuatit

Edhe pasi doli në pension Asllani vazhdoj të merrej me punët e bujqësisë e blegtorisë, për të ndihmuar sa të ishte e mundur familjen e tij.
Asllani kishte një dashuri të madhe për librat e kryesisht ato artistik, të cilat jo vetëm i lexonte me etje të madhe, por dhe mbante mend me detaje subjektin e çdo romani, novele apo tregimi që lexonte.
Nuk ka disponuar asnjëherë ndonjë pasuri të madhe. Shtëpinë, pak bagëti, pak dynym arë dhe një kopsht.
Asllani është ndarë nga jeta më 21 qershor 1987 në Canaj, Bicaj në moshën 80 vjeç.

Në vitin 1995 u miratua statusi i veteranit të luftës dhe Asllani e ka fituar këtë status (pas vdekjes), në sajë të kontributit të dhënë kryesisht si bazë lufte dhe Kryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar. Si pasardhës i veteranit Asllan Nebi Fejzallari njihet djali i tij i fundit Shkëlqimi.

Nga familja e Asllan Nebi Fejzallarit janë zhvilluar dhe krijuan familje këta pasardhës :

Remzije Asllan Fejzallari (Axhami), e datëlindjes 18 Nëntor 1936. Ka kryer arsimim bazë. Është martuar me Xhezahir Ibrahim Axhamin dhe kanë këta fëmijë : Safetin, Burbuqen, Sadeten, Arbenin, Astritin, Zamirin dhe Ibrahimin. Remzija ka punuar në kooperativë bujqësore.

Kadire Asllan Fejzallari (Karanxha), e datëlindjes 5 prill 1940. Ka kryer arsimim bazë. Është martuar me Daut Ali Karanxhën dhe kanë këta fëmijë: Bajramin, Naxhijen, Besimen dhe Agimin. Edhe Kadirja ka punuar në kooperativë bujqësore.

Shpresa Asllan Fejzallari, e datëlindjes 13 Qershor 1942. Ka qenë e martuar me Selim Shemë Cenën nga fshati Gostil. Ai u nda nga jeta shumë i ri dhe lanë pas vetes vetëm vajzën Kujtime për të cilën u kujdes Shpresa. Pas ndarjes nga jeta të Selimit ajo u zhvendos përkohësisht pranë familjes së saj në Bicaj. Ka mbaruar shkollën e mesme si n/mjeke në Shkodër, ka punuar në spital Kukës, instruktore në Komitetin e Partisë Kukës dhe shefe kuadri në spital Kukës, deri sa doli në pension pleqërie.

Fuat Asllan Fejzallari, i datëlindjes 9 Gusht 1945. Ka kryer arsimin e mesëm profesional (pedagogjik) në shkollën "Shenjaze Juka" Shkodër në vitet 1959 – 1963 dhe ka punuar si arsimtar pranë shkollës 9 vjeçare "Vebi Shehu" Bicaj. Është martuar me Selë Shahin Palushi nga Osmanaj, Bicaj me profesion arsimtare. Kanë punuar e kontribuar së bashku në të njëjtën shkollë. Fuati është përmendur gjithmonë për aftësi shumë të mira profesionale, kërkues dhe korrekt në edukimin e brezit të ri. Është aktivizuar me aktivitete sportive dhe ka qenë një sportist i mirë me skuadrën e volejbollit. Rritën dhe edukuan së bashku fëmijët Admirimin, Majlindën, Afrimin dhe Ardin.

Fuati u nda nga jeta më 20 shtator 2006.

Qefsere Asllan Fejzallari (Dokle), e datëlindjes 3 prill 1948. Ka kryer arsimin e mesëm pedagogjik. Ka punuar një periudhë si arsimtare dhe pastaj si drejtoreshë e konviktit të femrave të fakultetit të mjekësisë Tiranë, deri sa doli në pension pleqërie. Është martuar me Namik Hamza Doklen, i cili pasi mbaroi arsimimin e lartë për gazetari ka punuar në Gazetën "Puna" si gazetar dhe k/redaktor, në Bashkimet Profesionale, k/redaktor te gazeta "Zëri i Popullit" dhe pas vitit 1991 si politikan karriere, deputet në parlamentin e Shqipërisë deri në legjislaturën VII, 2009 – 2013. Ata kanë rritur, edukuar dhe shkolluar fëmijët Anikën, Manjolën dhe Bleron.

Luan Asllan Fejzallari, i datëlindjes 4 Gusht 1951. Ka kryer arsimin e mesëm bujqësor për agronomi në Peshkopi. Ka ushtruar për një periudhë të shkurtër këtë profesion dhe pastaj ka punuar si gazetar në radion lokale Kukës, nga ku në vitin 2017 doli në pension pleqërie. Luani në vitet 1981 – 1984 ka vazhduar Shkollën e Partisë "Vladimir Lenin", Tiranë, me sistem pa shkëputje nga puna, por nuk ka qenë asnjëherë i organizuar në PPSH. Punon si gazetar i jashtëm pranë kësaj radio dhe mbulon emisionin për fshatin. Është martuar me Shote Halit Morinën nga Kruma me profesion nd/mjeke. Shota ka punuar pranë qendrës shëndetësore të Komunës Bicaj deri sa doli në pension. Së bashku kanë rritur dhe edukuar fëmijët Irena, Benard dhe Erandën.

Shkëlqim Asllan Fejzallari,

i datëlindjes 9 Maj 1954. Ka kryer arsimin ekonomik në Tiranë dhe ka punuar gjithë periudhën në profesionin e tij. Fillimisht në Parkun e Mallrave Kukës e prej një periudhe të gjatë pranë Sigurimeve Shoqërore Kukës. Dallohet dhe përmendet për korrektesën e tij dhe përpikërinë në zbatimin e detyrave. Është martuar me Nimete Qazim Cenën nga fshati Gostil, e cila ka mbaruar shkollën mekanike dhe ka punuar në Ndërmarrjen e Ndërtimit si axhustatore. Ata rritën dhe edukuan fëmijët e tyre Armandin, Ervinin dhe Pamelën.

AVDI BAJRAM FEJZALLARI

Avdia ishte djali i vogël i Bajramit.
Ka lindur në vitin 1880 në Bicaj. Këtij që në vogli iu ngarkua detyra e çobanit.
Ka qenë i martuar me Rrahime Imer Hallaçin nga fshati Pobreg, Kukës në vitin 1905. Ajo rridhte nga një fis i njohur për trimëri, burrëri dhe pasuri. Me këtë grua ka lindur e ka rritur këta fëmijë : Kamberin, 1912; Nurien, 1915; Zaren, 1918 e Bajramin, 1928.

Kamberi

Nurija

Zarja

Bajrami

Në vitin 1905 ka qenë në Selanik, ku ka shërbyer si bari tek Selim Dervish Aga, i cili ishte me origjinë nga Vasija e Ploshtanit. Ai ishte "Qehaj" me një pasuri prej 12.000 krerë dele, etj. Atje ka qëndruar deri në vjeshtën e vitit 1912. Për shkak të Luftës Ballkanike Qehasë ia morën dhentë palët ndërluftuese dhe ai me djalin e vëllait Isufin, me shumë mundime u kthye në bjeshkët e Bicajve së bashku me ato pak dele të veta që i ruante së bashku me ato të pronarit, gjithsej 70 krerë. Rregulloi stanin dhe u gëzua shumë që vëllezërit dhe gruaja kishin shpëtuar gjallë nga lufta. Edhe familja u gëzua shumë se nuk kishin dijeni që Avdia jeton dhe konsiderohej i humbur ose i vdekur në luftë.
Pas kthimit filloi një jetë normale me familjen në Bicaj së bashku me gruan e tij të jetës, Rahimen, me të cilën lindën e rritën dhe tre fëmijë të tjerë.

Dy fjalë për Rahimen dhe jetën e saj të ndërthurur :

Ka lindur në katundin Pobreg me 1891, nga martesa e Sejdi dhe Lihe Hallaçi.

Është martuar me Avdi Bajramin nga Canajt, Bicaj, në bazë të zakonit, por fati e solli që të dy bashkëshortët të kenë karakter të fortë e të pastër, pasi të dy rridhnin nga familje e fise të mira.

Ishte grua e shëndoshë dhe me trup të drejtë e të pashëm. Fytyra e saj ishte e imët dhe ngaqë ishte e urtë dhe i vinte turp të shikonte njerëzit, fytyra e saj merrte një hijeshi të jashtëzakonshme. Ishte e pa fjalë. Nuk përzihej shumë me shoqe dhe as që merrte pjesë në dasma e ahenxhe, me përjashtim tek prindërit e saj.

Punonte barazi me burrat në prashitje misri, korrje, transport bari etj. Ngrinte pesha shumë të rënda në kurriz, sa që tregohet se kur shkonte të bluante drithë në mulli, pesha më e vogël ishte 60 kg, djalin Kamberin kaliçuk në qafë dhe ndërkohë bënte çorape ose triko. Brijën (bucelën) e ujit, që minimumi ishte 30 kg, kurrë nuk e ngarkonte në shpinë, por e mbante nën sqetull, se i dukej e lehtë. Ngarkonte bar nga Kolejat e Bushatit, që është më larg se 1 orë rrugë deri në 80 okë, ndërkohë qe barra e kalit ishte 100 okë.

Rahimja nga viti i martesës 1905 - 1910 ka jetuar e vetme pa burrin, sepse Avdia punonte në Selanik si bari me dhen e kjo jetonte me pjesëtarët e familjes së burrit. Më 13 mars 1912 i lindi djali i parë Kamberi, me të cilin përkëdhelej. Duke qenë se ishte shumë punëtore dhe e dëgjueshme, të gjithë njerëzit e familjes e donin si ta kishin motër.

Rahimja nga fisi i saj ka qenë shtëpi me zë. Ka pasur burra trima e të urtë, gra të mira e të ndershme. Ka pasur pasuri tokë e bagëti, por i konsumonin se kishte shumë lëvizje e miqësi.

Në momentin e martesës familja e saj ka pasur 33 frymë, por në vitin 1913, kur serbi erdhi për herë të dytë për të masakruar popullin e Lumës, megjithëse u prit me pushkë e rezistencë, befasia në të cilën u gjet populli i Pobregut, e shumëfishoi masakrën. Janë therë me bajoneta e vrarë pa dallim moshe e seksi, mjafton që të ndodheshe përpara kësaj ushtrie mizore.

Nga familja prej 33 frymë e Rahimes, kanë shpëtuar 2 kushërinj të saj : Imeri 7 vjeç dhe Ahmeti 5 vjeç, të cilët nga frika janë hedhë nga ballkoni i kullës dy katëshe në arën e misrit, ku kanë qëndruar dy ditë pa ngrënë e pa pirë.
Vëllai i Rahimes, Hajdar Sejdi Hallaçi, është ndodhur në bjeshkë ku ka qëndruar i fshehur. Ai ishte 20 vjeç. Kjo familje deshi shumë kohë të përtërihej me rritjen e jetimeve, për të cilët është kujdesur daja i tyre Kamber Daut Halilaj nga Canaj, Bicaj.
Rahimes në prill 1916 i vdes vëllai i vetëm Hajdari së bashku me gruan e tij, sëmurë nga kolera, që përfshiu krahinën e Lumës. Ata nuk lanë fëmijë prapa.
Këtë fatkeqësi shumë të madhe që i ra e shtypte nën vete, se në një anë ishte nuse në një familje të madhe e në anën tjetër malësoret e kishin traditë të qëndronin si burrnesha.
Prej fisit të largët të Rahimes sot jetojnë pasardhësit direkt të Imer dhe Ahmet Sali Hallaçit, nga Imeri : djemtë Bajrami, Salihi, Agniu dhe Argjetani, kurse nga Ahmeti: djemtë Haziri, Hajredini, Rama, Tasimin, Iliri, Fatriu dhe vajza Satbere.
Në fisin e tyre ka pasur njerëz të mirë e përparimtarë si : Xhemali Hallaçi, Liman Veseli, Ali Mehmeti etj.
Për Rahimen vdekja e burrit në moshën 55 vjeç ka qenë shumë e rëndë. Ai i la prapa barrë të mëdha. La Zyberin sakat, nënën e Dullës të vjetër, vajzat që duheshin përgatitur për martesë, djalin Kamberin që punonte, por që nuk merrte vesh fare nga punët e bujqësisë dhe të shtëpisë, djalin Bajram që ishte në shkollë, e më kryesorja duhej mbajtur dera hapur për të ruajtur zakonet e karakterin e shtëpisë. Duhej punuar toka, duhej ushqyer gjëja e gjallë, duhej të gatuante e të arnonte njerëzit e shtëpisë. Në këto rrethana ajo punoi e vetme dhe u lodh shumë. Nga puna e rëndë mori një ftohje në mushkëri dhe në nëntor 1938 vdiq, tre vjet pasi i vdiq burri Avdi.

... dhe pak për jetën e Avdi Bajramit.
Duke punuar shumë kohë me blegtori u aftësua si veteriner praktik dhe u shërbente me shumë kujdes bagëtive të veta, por i kërkohej ndihmë edhe nga të tjerët, pasi në atë kohë shërbimi veteriner i specializuar nuk funksiononte.
Çfarë dinte ai si veteriner i paarsimuar !
- Me të parë njihte moshën e çdo kafshë e veçanërisht të deleve.
- Gjente dhe ishte shumë i saktë në diagnostimin e sëmundjeve në kafshë e merrte përsipër shërimin e tyre me barëra, që i mblidhte në mal, me operacione në vesh e ndërhyrje të tjera, si me larje etj.
- Orientonte ushqimin më të mirë për bagëtitë gjatë 4 stinëve të vitit.
- Dinte me saktësi momentin e pjelljes së secilës bagëti dhe u rrinte afër.
- Ne kohën e pjelljes kur lopa ose delja e kishin mbrapsht, ky ndërhynte dhe e kthente mbarë pa asnjë dëm.
- Kur tufa e deleve ishte në vathë jashtë shtëpisë e dëgjonte blegërimat e tyre, e kuptonte cila dele ishte dhe se ajo donte të bënte qingjin. Gruaja kur shkonte për të parë tek vatha, pikërisht ajo dele ose kishte pjellë në moment ose ishte në ato minuta.
Përveçse ka qenë bari i mirë, i urtë e kompetent, ka qenë dhe kosar i mirë. Ishte i fuqishëm e me trup të shëndoshë. Hante mirë, por i bënte naze ushqimit. Si çoban, që e kishte kaluar më shumë kohën me gjënë e gjallë, hante me qejf mish dhe bylmet.
Në vjeshtën e vitit 1916 u nda familjarisht nga vëllai tjetër Nebi, por me vete mori vëllain më të madh Zyberin. Zyberi nuk ishte i zoti për asnjë punë fizike, pasi ishte sakat, por duke qenë i mençur i hynte në punë Avdisë për kujdesin dhe administrimin e familjes. Punët e fushës i bënte Avdia me gruan Rahime.
Avdia dhe Zyberi duheshin shumë, e kështu Zyberi e ndihmoi shumë Avdinë, bile edhe pas vdekjes ia rriti fëmijët jo me fuqi krahu, por me mend e organizim të punëve.
Pas ndarjes Avdia u mor edhe me bujqësi, por duke mos ia ditë kësaj pune, lodhej shumë deri në stërmundim. Nga lodhja e tepërt në punë, duke ujitur natën e ditën, mori dopio pneumoni, u sëmur e vdiq. Ai jetoi 55 vjet dhe ndërroi jetë më 5 mars 1935.

Ka qenë i urte e me karakter të qëndrueshëm moral. Nuk merrej me tregti. Nuk merrej me llafe e nuk shkonte në kuvende, me përjashtim të rasteve si : hapje kanale vaditje; caktim orari vaditje; caktim afati të kullotave në fusha etj. Punët e tregut e te kuvendit i kryente i vëllai Zyberi, i cili ishte shumë kompetent në këto fusha.
Nuk duronte ngacmime, bile ne vitin 1915 -1916, në kohën e Austrisë, një fshatar i Canajve, Jashar Baftjar Kerxhaliu e kishte rënduar me një fjalë, duke qenë Jashari i armatosur. Në këto kushte i thotë Avdisë : "Po të kishe pushkë me vete do të të kisha vra, por mbasi nuk ke pushkë po të fal". Avdia ka shkuar në shtëpi të vet, i është lutur vëllait të tij Zyber që t'i gjente një armë dhe Zyberi ia blen 4 napolona ari. Jashar Kërxhaliu kur e mori vesh këtë veprim i dërgoi fjalë duke i thënë se unë nuk kam asnjë gjë me ty dhe i kërkoj falje e pajtim.
Avdia punonte pa hile në ndihmë të shokëve, në kohën e fushatave në bujqësi etj.
10 vjet para se të vdiste filloj të merrej me profesion "asqi" (kuzhinier në dasma e mort). Kësaj pune i hyri me insistimin e kërkesën e fshatrave në Bicaj e përreth (Nangë e Kolesjan), sepse ky ishte shumë i drejtë dhe njerëzit kishin besim të madh tek ai. Kishte moral shumë të shëndoshë. I besohej të punonte me gra e vajza të çfarëdo moshe e karakteri qofshin. Morali ishte numri një si asqi, sepse më parë kishe të bëje me gra e vajza se me dasmorët e tjerë. I thonë fjalës që në dasmë e mort "Asqia e magjatorja duhet të rrinë gju më gju". Kjo vihej re shumë se në këto raste kanë ndodhur edhe vrasje për shkelje të moralit, ose ndarje familje, duke e përzënë gruan me shenja dalluese në trup.
Avdisë i besohej çfarëdo udhëtimi me gra e vajza, puna në fushë, kullotja e bagëtive në mal, shkuarja për dru, udhëtime për në bjeshkë (stan), pa as më të voglin dyshim.
Mbas vdekjes nuk ka lënë asnjë ngatërresë për trashëgimtarët e tij. La një pasuri të kufizuar : 15 dynym tokë mbi vadë e nën vadë, 20 krerë dele, 2 lopë, 1 ka, 1 gomar. Për administrimin e mirë të tyre është kujdesur vëllai tij Zyber, djali i tij Kamberi si dhe gruaja Rahime.
Avdia nuk ka përdorur asnjë lloj pije. As duhan, as kafe dhe as alkool.

KAMBER AVDI FEJZALLARI



Këto shënime si dhe të gjithë shënimet e tjera që ne djemtë e Kamberit nuk i kemi jetuar, ose nuk kemi paraqitur interes për momentin për ti dokumentuar, janë të Kamber Avdiut, përfshi edhe shënimet për veten e tij. Ne fëmijët i jemi shumë mirënjohës.
Djali Ademi.

"Kamber Avdia ka lindur më 13 Mars 1912 (Natën e Verës) në Canaj, Bicaj.
- Në vitin 1922 ka filluar shkollën fillore 5 klasëshe në Bicaj.
- Shkollën fillore e ka përfunduar në korrik 1927, por megjithëse ishte nxënës me nota shumë të mira, kushtet për shkollë të mëtejshme ishin të pamundura, pasi dhe shteti nuk jepte bursa studimi.
- Me datë 5 korrik 1927 ka filluar punë si praktikant në Postë Telegraf në Bicaj , deri më 5 tetor 1928, pa asnjë pagesë.
- Mbas kësaj date është emëruar shpërndarës në Postë Telegraf në qytetin Kukës, me rrogë bazë 53 franga ari.
- Në prill 1931 ka filluar punë në administratën e Prefekturës Kukës me rrogë bazë 60 franga ari në muaj.
- Më datë 31 gusht 1934 është mobilizuar ushtar në shërbimin e xhenios Tiranë, në Kompanisë e ndërlidhjes si radiotelegrafist (pasi gjatë punës në Postë Telegraf Kukës kishte përvetësuar edhe këtë specialitet).
- Nga viti 1935 ka punuar si N/Sekretar Komune në Bicaj me pagë 100 frang ari në muaj.
- Nga fillimi i vitit 1939 ka qenë N/Sekretar Bashkie në Kukës.
- Në prill 1941 është transferuar në Bashkinë e Prizrenit në atë detyrë, e më pas Sekretar Bashkie, deri në dhjetor 1944.

- Më janar 1945 është emëruar daktilografist i tre përkthyesve të Shtëpisë Botuese Prizren, e cila merrej me përkthim librash dhe nxirrte shtypin periodik lokal.
- Nga 1 shtator 1946 ka qenë në dispozicion të Gjendjes Civile Kukës.
- Me 1 nëntor 1946 ka punuar si Sekretar në Prokurorinë e Kukësit.
- Nga marsi 1948 ka punuar si N/Prokuror Hetuesie.
- Në mars 1953 është emëruar në punë si Kryetar i Kooperativës së Artizanatit Kukës me rroge mujore 6000 lek të asaj kohe.
- Në shkurt 1955 ka kaluar si "Avokat i kolektivizuar", pa shpërblim të përcaktuar, po sipas të ardhurave me 60% shpërblim.
- Për shkak të mbylljes së kolektivave të avokatëve, nga viti 1959 deri me 31 maj 1972, ka punuar në administratën e SMT dhe Gjeologjisë, kohë në të cilën ka dalë në pension pleqërie.

Më 3 nëntor 1940 është martuar me Nurie Ramadan Spahiun nga Kolesjani, me të cilën ka krijuar dhe e ka zhvilluar familjen.

Karakteristika të veçanta :

Nga jetëshkrimi i tij rezulton se edhe para çlirimit ka punuar mirë, sepse me ardhjen në Kukës nga Prizreni, e kanë njohur shumë njerëz dhe e kanë afruar dhe stabilizuar me punë.

Ka njëfarë arsyetimi e dhembshurie për njerëzit, e me sa ia pret mendja mundohet të orientoi ndonjërin që e pyet. Duket që ka lexuar libra të kohëve të kaluara, sepse në muhabete të ndryshme përzien ndonjë fjalë të tyre.

Mbas çlirimit, e veçanërisht në punën në organet e drejtësisë tek ai është ndjerë njëfarë zgjerimi njohurish e të kulturës së përgjithshme.

Pas daljes në pension vërehen disa të meta të theksuara :
- Kërkon të dije të gjitha problemet që diskutohen, meqë nuk i kap shpejt.
- Vuan nga tensioni i gjakut.
- I është pakësuar shikimi.

Pra të gjitha këto kanë filluar t'ia bëjnë jetën pak të bezdisshme.

Për tu orientuar më konkretisht me jetën e tij dhe për të nxjerrë në pah vuajtjet dhe të mirat që ka pasur, shihet e nevojshme të nxirren disa shënime nga autobiografia e tij e fundit, dhënë për efekt dokumenti, në

ndërmarrjen ku ka punuar. Para se të hyhet në temën e autobiografisë shënon : "Unë, që ditën e parë të lindjes, posa rashë në tokë thuhet se kam qarë, e këtë të qarë e kam vazhduar deri në moshën 4 vjeç, duke mos e ditë se pse po qaj. Në këtë rast, për lindjen e fëmijës është dëshira e nënës dhe e babës dhe jo e fëmijës. Pra unë këtë e kam kuptuar në moshën 4 vjeç, dhe atëherë kam filluar të qaj përnjëmend që erdha në botën e vuajtjeve".

Më kujtohet që çdo vit na dërgonin në stan verës. Axha Zyber kishte një grua nga fisi "Oruç" i Kolesjanit. Kjo në verën e vitit 1915 kishte shkuar tek prindërit e saj në Kolesjan, ku kishin rënë dy sëmundje shumë të rrezikshme : kolera dhe lija, të sjella në vendin tonë nga ushtarët austro - hungarezë gjatë Luftës së Parë Botërore. Këtë grua të infektuar nga të dy sëmundjet e sollën në bjeshkë. Unë si fëmijë duke qëndruar me atë ma ngjiti sëmundjen e lisë, po ashtu dhe Axhës Zyber, kushëririt tim Asllanit e të tjerëve. Me rëndë e kanë pas Oruçja dhe Kadirja, nëna e Asllanit, të cilat vdiqën. Unë, Asllani e axha Zyber vuajtëm afro 1 vit dhe pastaj u shëruam, duke na mbetur shenja në trup e në fytyrë. Axha Zyber mbeti qorr në një sy.

Në vitin 1916 kam qenë 4 vjeç dhe mbaj mend ndarjen e babës tim nga vëllai Nebi. Me kujtohet se plak për ndarje ka qenë Axha Zyber, njëkohësisht vëlla me ata. Në ndarje nuk është bërë shamatë, vetëm kur kam parë që është ndez zjarr në odën e miqve, që më vonë e mora vesh se i kishte ra Nebisë. Zjarr u ndez edhe në odën e zjarrit ku qëndronim, që i kishte ra Avdisë e Zyberit.

Në vitin 1918 Austria humb luftën e ushtarët u larguan nga vendi ynë, duke lënë prapa materiale e ushqime. Gjate viteve 1915 - 1916 në Lumë ka pas zi buke, ku nga uria kanë vdekur dhjetëra veta. Mbaj mend që në shtëpinë tonë në vend të drithit bluanim boçka, lëvore ahu e përdornim shpesh hithra për ushqim. Por meqë kishim bagëti shumë, thernim dele e hanim shpesh mish. Kati i parë i shtëpisë sonë në Bicaj ka qenë magazinë ushqimesh e ushtrisë austriake, sepse shtëpia ndodhej afër rrugës automobilistike. Bile ushtria kishte bërë një rrugë përmes arës tonë, e që sot në atë vend ka ndërtuar një shtëpi 2 katëshe Rehan Shemsi Media (Bilali) nga Canaj. Kjo magazinë nuk u zbraz krejt prej

ushtarëve dhe mbetën mjaft ushqime, që i kanë hyrë në punë familjes sonë. Në katin e sipërm të kullës ndodhej burgu për civilë.
Me largimin e austro - hungarezëve, erdhën autoritetet serbe, me idenë që vendi ishte i Shqipërisë por këta do të rregullonin administratën shtetërore. Kjo marrëveshje është bërë në mes serbëve e krerëve të Lumës, si Alush Agë Luma, Nexhip Ahmet Aga, Miftar Selman Bajraktari, Osman Lita etj, të cilët shpërbleheshin nga Pashiq, kryeministër i Serbisë dhe Stojan Daçiç, që administronte Bicajn me qendër në Prizren. Këto regjistruan një detashment xhandar (zaptije me nga një shirit të kuq në krah, si flamur shqiptar) për të mbajtur qetësinë. Kjo gjendje vazhdoj deri në janar 1920, kur u mbajt Kongresi i Lushnjës e ku u vendos sistemi i rregullt qeveritarë dhe u saktësuan përfundimisht kufijtë, veçanërisht me Jugosllavinë.
Mbas Kongresit të Lushnjës në Bicaj u hap shkolla e parë Shqipe, me mësues Kol Vilën dhe Kol Shalën, të dy nga Shkodra. Këta bënin shkollë nate. Në këtë shkollë morën pjesë dy kushërinjtë e mijë Isufi dhe Asllani, të cilën e vazhduan për 2 vjet. Pas kësaj kohe Asllani shkoj ushtar në Përmet dhe Isufi u regjistrua për xhandar.
Karakteristikë është se Asllani ka shkruar letër pas një viti, e pikërisht në dimër 1923, e në letër tregonte se ka bërë një muaj rrugë në këmbë deri sa arriti në Përmet. Komandant aksioni e mobilizimi ishte Ismail Haki Tatzoti dhe Azis Çami. Letra që kishte dërguar Asllani ishte me bojë të kuqe. Baba Nebi e kishte marrë dhe nuk e kishte hapë fare e kur shkova unë e gjeta me lot në sy. Kur e pyeta më tha: "Ka ardhe letër nga Asllani e paska vdekë, se letra kur shkruhet me të kuqe, ashtu ashtë". Unë isha në klasë të dytë dhe kisha arritur të kuptoj se letra me bojë të kuqe mund të shkruhen edhe për të mirë. E sigurova, se mua më besonte e më donte shumë. E hapa letrën dhe e lexova me zë të lartë. Tregonte se ishte mirë. Kishte për të ngrënë e për të vesh në rregull, pyeste për të gjithë dhe tregonte se do të lirohej nga fundi i vitit 1924. Në fakt ashtu u bë, se me fillimin e Revolucionit të Qershorit, ushtria u caktua në afat 2 vjeçar, e ata që kishin plotësuar afatin u liruan.
Kur kam hyrë në shkollë kam qenë i përgatitur, se kam mësuar nga librat e kushërinjve. Ata më ndihmonin shumë e gjithmonë dilja i pari i klasës.

Në vjeshtën e vitit 1924 vdiq kushëriri ynë Dull Muslia, i cili la nënën 60 vjeçe, gruan dhe një vajzë. Gruaja e tij u martua duke u larguar nga Bicaj, kurse vajza me nënën e Dullës erdhën në shtëpinë tonë. Vajza vdiq pas një viti, e në shtëpinë tonë mbeti plaka Sulltane, derisa vdiq në Prizren me 3 gusht 1946.

Pasi mbarova shkollën kam filluar pune shteti, praktikant në PTT Bicaj. Për 2 vjet rresht pa rrogë kam bërë punën e telegrafistit e të nëpunësit të pranim letrave e mandaposta, duke më dhënë telegrafisti vetëm 1 lek shqiptar në ditë, edhe ato m'i falte. Në fakt me atë lek në ditë blihej 4 kg misër, ose 1 kg oriz, ose 1/2 kg sheqer, ose 1 kg vajguri, që atëherë sillej nga Shkodra nga tregtari Gjon Shiroka, i cili e dorëzonte tek Mulla Idriz Hoxha, që ishte i lidhur me tregtarin e madh "Vllazën Spahia" nga Gjakova.

Me vonë e mora veten dhe u emërova shpërndarës i rregullt në PTT Kukës me page bazë. Fillova me ndihmue shtëpinë. Baba kujdesej për bujqësi e blegtori dhe unë i dërgoja pare, që i mjaftonin.

Nga fillimi i punës në shtator 1930, kam qenë shumë i rregullt, nuk shpenzoja asnjë lek dhe gjithë rrogën e dërgoja në shtëpi, mbasi shpenzimet e mia i nxirrja duke bërë shërbim ndër zonja jashtë orarit zyrtar. U shërbeja me pazar zonjave të nëpunësve të lartë (Prefektit, Qark Komandantit, Prokurorit, Gjykatësit etj), të cilët më donin, se gjoja punoja pa hile. Në anën tjetër unë veproja si "ekonomist".

Ditën e shtunë baba me sillte një krroçe (enë druri) me kos, meqë ishte dhe ditë pazari. Të shtunën tjetër më sillte krroçën tjetër dhe e merrte të parën bosh. Gjithashtu me sillte dhe bukën. Me kujtohet nganjëherë nga vapa e madhe që bënte në Kukës (atëherë vend pa ujë, vetëm me 2 puse, njeri privat i Bacës Dan, Dan Magjypit e një në publik në Qafë të Pazarit), kur shkoja me nxjerrë kos nga krroçja që e kisha në podrum të Postë Telegrafës, kishte humb kapaku i kroçes, e plasur nga forca e thartirës e kishte shkuar deri në tavan.

Ne shtator 1930, bënim stërvitje ushtarake me një major italian (Angjelo Antika) në Kukës, dhe unë me që isha i dalluar me dërguan në Tiranë për parade para NMT Mbreti Zog I-rë, me rastin e ditës së lindjes, (8 tetor 1895) dhe 3 vjetorit si Mbret. Në Tiranë qëndruam 1 muaj e gjysmë dhe

mësova njëfarë jete qyteti dhe si me prish pare, si me ndej me shokë, me pije birra etj. Kur u ktheva në Kukës fillova me i vu në zbatim.
Nga viti 1931 - 1934 kalova në administratën e Prefekturës. Në këtë vend paga ishte më e madhe, por puna ishte me kërkesë të lartë llogarie, se kishe të bëje me njerëz me rëndësi (Prefekt, Qark Komandant, Kryetar Gjyqi, Prokuror, Drejtor Finance etj), por shpejt ua mësova huqet, u rrija gati dhe fitova njëfarë besimi tek ata. Fillova të mësoj edhe mbi punën në administratë. Mësova makinën daktiliografike dhe mënyrën e arkivimit e të konceptimit të akteve.
Me 1 shtator 1934 shkova ushtar në kompani të ndërlidhjes si radist në Tiranë. Qëndrova 10 muaj e pastaj u ktheva në Bicaj me leje, se baba ishte sëmurë rëndë, e duke qenë me leje ai vdiq. Pas vdekjes së babës, pa shkue në Tirane, u caktova Kryetar i stacionit të radios ushtarake në Kukës, e njëkohësisht kreva formalitetet për tu liruar si "pa ndihmë". Pas 2 muajve dorëzova rrobat, se pajime të tjera nuk kisha marrë as në Tiranë.
Barra më e rëndë në jetë më ka ra me vdekjen e babës. Ai la në familje Zyberin e nënën e Dullës, të moshuar e krejt të paaftë për punë. Nënën, që si grua nuk mund ti çonte përpara punët e burrave në bujqësi. Më la dy motrat, Nuren të fejuar me Rexhep Halil Përzhitën nga Morini, e që duhej bërë gati për martesë, e Zaren ende e pafejuar dhe e rritur. Duhej përpjekje e kujdes për çdo gjë, në lidhje me karakterin e zgjedhjes së miqve, sipas zakoneve që ishin atëherë. Bajrami, vëllai ishte 7 vjeç, vazhdonte shkollën e duhej me i dhanë me tepër shkollë, se ishte mirë me mësime, e mungesën e shkollës e pata ndjerë në kurrizin tim. Unë nga bujqësia e blegtoria nuk kisha fare haber (dijeni), e nuk i isha shtruar kurrë punës, kështu që kisha ra në hall. Nga ana tjetër isha mësue me punë shteti e nuk mund të rrija pa punë. Kjo ishte e vështirë se duhej shoqëri e miqësi. Fillova mënyrën më të zorshme për vete. Gjeta rastin e me anën e një miku u njoha me Nënprefektin Ismail Jakupi nga Katundi Lis i Matit (burrë bujar, por ishte autodidakt dhe kam marre vesh më vonë, se gjatë Luftës djemtë e tij kanë kontribuar shumë dhe janë pranuar edhe në Parti). Ky me punësoj si N/Sekretar në Komunën e Bicaj, e kryesisht në Zyrën e Gjendjes Civile. Aty përfitova shumë nga

puna dhe u njoha në masë, sepse ishte Komunë me 37 copë katunde. Fillonte nga Morini deri Kalisë e Vilë, duke përfshirë Arrën, Surroj e Kolsh.

Nën drejtimin e Axhës Zyber u rregulluan dhe punët e shtëpisë. Kisha 30 kokë dele e 2 lopë, për të cilat kujdesej axha (i kulloste vetë). Nëna Rahime ishte shumë e fortë, por sidokudo ishte grua. Më kujtohet se duke vaditë në ara (Prrojnas), në pikë të drekës, këmbët i kishte në ujë deri në gju, në anën tjetër djersët i shkonin në ballë, flokë e trup. Kështu mbas një viti të vdekjes së babës, ajo u sëmurë rëndë nga ftohja. Mjete e ilaçe nuk kishte. Krejt rrethi Lumë kishte vetëm një mjek, e ai ishte plak (Islam Korça) e nuk lëvizte askund. Nëna mbeti e sëmurë afro dy vjet. Motra Nure u martue në nëntor 1938 dhe mbas pesë ditëve më vdiq nëna. Ndjeva dhimbje të madhe shpirtërore dhe u shkatërrova ekonomikisht. Isha fejuar, por nuk isha duke pyetur për martesë, sepse miku Dan Spahiu ishte mik i mirë dhe vajzën Nurie e kishte të re (fejuar sipas zakonit gati 10 vjeçe).

Problemi ishte tek martesa e Zares, sepse axha e kishte fejuar për Idriz Laçin nga Bardhoci, që njihej si shtëpi e parë dhe e pushkës. Ai e kërkonte dhe "duhej ti plotësohej dëshira mikut të mirë" - thoshte Axha.

Në foto dy miqtë e Kamber Avdisë : Rexhep Halili, martuar me motrën Nuren. Kanë rritur dhe edukuar fëmijët Lutfi, Bukurie, Avni dhe Fatmir dhe Idriz Laçi, martuar me motrën Zaren, dhe lindur e edukuar fëmijët Fasli, Fetie, Haxhi, Ruhie, Skënder, Selim dhe Xhafer.

Pushtimi italian më gjeti në Komunën e Bicaj. Rrëzimi i Flamurit Shqiptar duke e zëvendësuar me atë italian me ka prekur rëndë në zemër. Jo se isha komunist, por si shqiptar dhe atdhetar, se aq gjë e kisha ndjerë në shpirt dhe se paku kisha njohuri nga shkolla dhe Historia e Shqipërisë. Po çfarë mund të bëhej kur nuk kishte udhëheqës patriotë, sepse e gjithë paria e Lumës ishte lidhë me reaksionin. U vendos njëfarë

qetësie. Mua më transferuan N/Sekretar Bashkie në Kukës. Mora detyrën dhe fillova punë nga fillimi i vitit 1940.
Idriz Laçi kërkonte me insistim të martohej. Atij iu dha fjala. Me martesën e Zares, pleqtë, Zyberi e nëna e Dullës do të piqeshin në furrën e zjarrit duke gatuar.
Bajrami, vëllai i vogël, kishte kryer shkollën fillore dhe kish dalë me nota të mira. Me zotësinë e tij kishte fituar bursën dhe vazhdonte shkollën Normale të Elbasanit që nga shtatori 1938. Një telash me pati nxjerrë në plotësimin e dokumenteve, sepse kish filluar shkollën 5 vjeç, e kur mbaroj filloren ishte 10 vjeç. Për të vazhduar shkollën e mesme duhej të ishte 13 vjeç. Duke qenë i detyruar, gjeta rastin e shkova në Komunë, bëra korrigjimin nga 9 Maj 1928 në 9 Maj 1926, duke i lëshuar Letër Njoftimi me firmën time. Ky veprim nuk u shikua imtësishëm nga arsimi dhe u pranua.
Tani lindi nevoja (1940) me gjete mënyrën se si të martohem unë, sepse për të zëvendësuar Zaren, duhej të merrnim nusen. Kjo ishte shkatërruese për mua, megjithëse në atë kohë kisha disa pare dhe gjë të gjallë. Në rast ngushtllëku kisha mundësi me gjetë pare borxh, sepse kisha fituar njëfarë simpatie në masë dhe axha Zyber kishte miq që i zgjidhnin problemin. Pengesa më e madhe ishte se nusja ishte në moshë shumë të vogël. Ishte 12 vjeçe dhe duhej të ishte (sipas ligjit të martesës) jo më pak se 16 vjeçe. Kjo punë ishte pengesë e madhe, sepse nuk mund ta shkelja ligjin vetë për veten. Dashtë e pa dashtë, gjeta mënyrën e ia korrigjova moshën nga 20 prill 1926 në 20 prill 1922. Pas këtij veprimi iu drejtova mikut vetë e i tregova hallet. Më në fund, më 3 nëntor 1940 u martova. Në mars 1941 u martua edhe Zarja.
Pas shkatërrimit të Serbisë së Vjetër, me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, Serbinë e pushtoj Gjermania. Ajo kishte shtrirë kthetrat deri në Mitrovicë. Italia, si fuqi aleate me Gjermaninë, donte të merrte tokat e Kosovës e të Malit të Zi në marrëveshje me reaksionin vendas. Forcat italiane u shtrinë edhe në Kosovë, Strugë e Ohër, duke krijuar një Komisionar të Naltë, që përfaqësonte Qeverinë Shqiptare nën Perandorinë e Viktor Emanuelit III-të. Në këtë rast, në Prill 1941, nga nëpunësit më të vjetër të Kukësit na shpërndanë nëpër Kosovë për të

sistemuar administratën shtetërore, gjoja shqiptare, sepse regjistrat e mëparshëm ishin në gjuhën serbe ose turke. Mua më takoj me shkue në Bashkinë e Prizrenit si sekretar i dytë (N/Sekretar). Si pozitë nuk ishte e keqe dhe paga ishte e mirë, por puna ishte e shumtë. Kishe të bëje me njerëz që për tu marrë vesh e për të kryer veprime duhej me ditë tre gjuhë : shqip, serbisht e turqisht. Unë kisha në atë kohë njëfarë njohurie

Kamberi familjarisht në Prizren. 1945
Bajrami dhe Nëna e Dullës me dy fëmijët e familjes, Myrveten dhe Bashkimin.

për këto gjuhë, se në punë në Kukës e Bicaj kisha pas takime si me goranët, ashtu edhe me prizerenjanët. Për pak kohe fillova me e marre veten në llafe e në punë. U stabilizova dhe pas pesë muajve mora me vete dhe gruan Nurien, duke lënë në Bicaj Axhën Zyber dhe Nënën e Dullës, sepse ata nuk dëgjonin me e lanë vendin dhe nga ana tjetër akoma kishin një bazë ekonomike të shëndoshë. Kishin deri 20 krerë dele, 1 lopë, token e bahçen të pacenuar.

Mbasi mora gruan atje, Axha Zyber tokën e punonte me njerëz përgjysmë dhe kishte hesap. Nëna e Dullës merrej me bahçen dhe kalonin mirë. Shkoja shpesh për t'i parë dhe mixha Zyber vinte shpesh herë në Prizren.

Bajrami ndiqte mësimet në Elbasan. Fryma e lëvizjes çlirimtare kishte marrë zjarr. Studentët së bashku me punëtorët kudo bënin greva e demonstrata. Normalja e Elbasanit u mbyll për shkak të një demonstrate të madhe. Bajrami erdhi në Prizren gjoja për pushime dhe mua, me që kishte besim, më tregoj për lëvizjen N.Çl. dhe pjesëmarrjen në atë luftë. Unë, helbete nëpunës i vjetër, e nuk do të pranoja një gjë të tillë (me pasë komunist në familje), megjithatë, dashtë e pa dashtë unë e kuptova

dhe pranova. Ai filloj të sjellë edhe shokë të Lëvizjes ilegal në shtëpinë tonë, të cilët duheshin larë, ushqyer e përcjellë.

Në Prizren u krijua celula komuniste. Në fillim të vitit 1942 filluan haptazi ndjekjet për komunistët. Tek ne vazhdonin të strehoheshin, pasi nuk i shkonte mendja kujt që unë mund të pranoja dhe të strehoja ilegalisht komunist në shtëpi, veçanërisht si nëpunës shteti (Sekretar Bashkie). Kështu edhe kontrollet tek ne i bënin të përcipta. Në ndihmë të Lëvizjes Çlirimtare është aktivizuar dhe gruaja Nurie, veçanërisht me transport materialesh e armatimi. Gratë e fëmijët në Prizren bënin punë të mëdha, sepse italianët e gjermanët, gjoja për të respektuar zakonet e vendit, përkrahnin fanatizmin. Gratë e mbuluara me çarçaf nuk lejoheshin të kontrolloheshin, ndërkohë transportonin armë të lidhura si fëmijë.

Më 12 prill 1942 në të gjithë rajonin Kosovë - Metohi - Strugë e Ohër u deklarua festë, sepse do t'i dhurohej Kurora e Skënderbeut Perandorit të Italisë, si Mbret i Shqipërisë. Studentët e punëtorët, të organizuar në celula komuniste, atë paradite u ngritën në grevë e rrahën Prefektin dhe Prokurorin e Prizrenit. U përleshën edhe me forca të karabinierisë. Të nesërmen autoritetet morën në analizë të gjithë shqiptarët që kishin ardhë nga Shqipëria e Vjetër, siç na quanin, e arrestuan shumë vetë. Ndër ta isha edhe unë. Në burg gjeta shumë të njohur politik, si : Xhevit Nimani me vëllain, Xheladin Hanën, Simo Baton, Zhivko Petkoviçin, e të tjerë kosovarë. Nga njerëzit tanë ishin : Meriman Braha, Abaz Shehu dhe 2 nga Tirana. Pas disa ditëve shumica e tyre u liruan me ndërmjetësi

miqsh, sepse njëfarë Mehmet Hoxha nga Gjakova ishte komunist, por kishte pozitë të madhe si Kryesekretar i Prefekturës, dhe në shumë raste fjala e tij shkonte më shumë se e Prefektit. (Xhevit Nimani, Elhami Nimani dhe Mehmet Hoxha, me mbarimin e luftës u bënë trockist shumë të rrezikshëm, se u lidhën me Rankoviçin, Ministrin e Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, si armik i betuar i kombit shqiptar. Xheladin Hana e Simo Bato më vonë u persekutuan me aprovimin e Rankoviçit direkt nga Xhevit Nimani, i cili ishte në atë kohë Ministër i Punëve të Brendshme për Qeverinë Autonome të Kosovës e Metohisë - Poverenik Unutroski Posllav - I besueshëm i Ministrit të Punëve të Brendshme, d.m.th. i Rankoviçit).

Unë mbeta në burg deri me 31 Maj 1942. U vonova pa lirue për arsye se arrestimi im ishte bërë nga Organet e Sigurimit S.I.M-t në Gjakovë. Shpjegime më të sakta nuk jepeshin. Jam lirue me ndërhyrjen direkte të Tahir Kolgjinit, nga që ishte Prefekt i Kukësit. Ai më njihte mbasi e kam pasur mësues, e me tepër njihte Axhën Zyber dhe i vinte keq për atë. Tahir Kolgjini ka shkuar vetë në Gjakovë dhe ka lëshuar deklaratë personale, si Prefekt i Kukësit, para Nënprefektit të atjeshëm Rrok Perollaj, që më vonë erdhi Prefekt në Kukës e u vra nga Çeta e Lumës së bashku me Xhafer Bislimin tek Kryqet e Nangëve. Tahir Kolgjini ka garantuar për mua se me njeh mirë dhe nuk përzihem në politikë. Nga ana tjetër më ka pas porositë me dhjetra herë : "Mos e lë Bajramin brenda se do gjesh belanë"! Unë bisedoja lirisht me të dhe i thoja : "Unë nuk mund ta përzë po të më vijë tek shtëpia. I jap bukë dhe e përcjelli. I kryej çfarë nevoje ka se e kam vëlla. Po në qoftë se është i rrezikshëm, kape, se e ke andej në rajonin tënd. Unë nuk mund të veproj në asnjë mënyrë kundër tij".

Te nesërmen që u lirova nga burgu e takova ne qytet Tahir Kolgjinin. Menjëherë ai me tha: “A te kam thënë se mos e mbaj brenda Bajramin. Shih se çfarë të ndodhi". Unë iu përgjigja : "Unë do të bëj çmos që ai të shpëtoj dhe unë le të vuaj. Për këtë rast të faleminderit. Për herë të tjera të mendojmë". Në ditët e fundit të luftës Tahir Kolgjini u bë shumë i rrezikshëm, por nuk u kap nga partizanët. Ai u arratis së bashku me krerët reaksionarë dhe anglo -amerikanët, që ndodheshin në Shqipëri.

Më vonë mora vesh se arrestimi ishte bërë për shkak se në Gjakovë, një person i dyshimtë, Ali Reka, kishte qenë në shkollë me Bajramin. Kur e kanë kapur atij i është gjete një listë me emra të ndryshëm, e në të ka figuruar dhe emri im, "Kamber Avdia, Sekretar Bashkie Prizren". Në bazë të kësaj më arrestuan mua në Prizren.
Më vonë lëvizja filloj me u ngjallë. Filluan reprezaljet dhe arrestimet. Ndodhnin vrasje nëpër shtëpi e në rrugët e qytetit. Një vrasje në qytet ndodhi me një djalë të ri, të quajtur Mustafa Hoxha nga Gjakova, i cili u fut në shtëpi të dajës së vet dhe nuk u dorëzua, deri sa u dogj shtëpia. Në momentet e fundit, doli në oborr të shtëpisë dhe hodhi bombën e fundit, duke rënë i vdekur nga plumbat e automatikut të Shefit të Kuesturës Beqir Malokut, i cili e kishte të vetin. Këto veprime të Kuesturës ngjallën urrejtje në masë. Filluan të mos përfillen njerëzit e Qeverisë, sepse pushka filloj të afrohej. Sidomos në Shtator 1943, kur ra Italia e Kosovën e Metohinë e mori në sundim Gjermania, populli u çorientua krejt. Nga ana tjetër komunistët në terren zgjeruan aktivitetin, duke sqaruar popullin me mjete e mënyra të ndryshme propagande. Në këtë kohë në Prizren u krijua baza e Organizatës Komuniste, që drejtohej nga shqiptarët Reshat Isa dhe nga ortodoksët Petrag Ajtiç, të cilët në ditët e para të çlirimit të Prizrenit u përmendën si luftëtar dhe organizator të çlirimit të vendit nga okupatori. Mua pasi dola nga burgu, më është krijuar më shumë bindja në fitore, e nuk me vinte aspak çudi kur dëgjoja fitore të çetave partizane, kurse shumë nëpunës çuditeshin për këtë luftë të filluar nga partizanët pa kurrgjë.
Pasi dola nga burgu kam marrë me vete Axhën Zyber dhe Nënën e Dullës. Ata nuk përziheshin se kush hynte e kush dilte në shtëpinë tonë nga të rinjtë, sepse e dinin që janë shokët e Bajramit ose te mitë.
Në këtë kohë Bajrami ndodhej në çetë, por unë vendin nuk ia dijsha. Kur binte fjala thuhej se ishte në shkollë.

Prizren, me nëpunësit e Bashkisë – Ndue Vita dhe Qemal Et'hem Prizreni, viti 1941-42

Punoja në zyrë si i ngrirë. Kur kthehesha në shtëpi, ose gjeja një shok të luftës ose ndonjë material.
Shemsi Rasim Hoxha punonte berber e kafexhi në Prizren. Rrinim në një shtëpi me atë. Ai kishte një vëlla xhandar, e në shumë raste e shpëtonte shtëpinë tonë nga kontrollet.
Me ardhjen e gjermanëve gjendja u keqësua, se ata pasi të mbanin dy ditë në burg, ose të lironin ose të varnin midis tregut. Nga natyra ishin shumë të ashpër e mizor.
Pak para çlirimit Fejzi Alizoti la Komisariatin e shkoj në Tiranë. Gjithë veprimtarinë e operacionit ia lëshoj Xhafer Devës, kriminel me famë. Ky u mundua të vendos qetësi me forca vullnetare të komanduara nga komiti Bislim Bajgova, por ishte e pamundur. Parullat hapeshin në gjithë qytetin. Tregohej fitorja e luftës së Ushtrisë së Kuqe Sovjetike mbi gjermanët, etj.
Më 17 nëntor 1944 është çliruar Prizreni nga forcat e Brigadës së V-të Sulmuese, të komanduara nga Shefqet Peçi. Është mbajtur miting i madh para Bashkisë dhe është vendosur rendi. Janë qëruar të gjithë mbeturinat e reaksionit dhe më vonë u vu dorë dhe në konfiskimin e tregtarëve të mëdhenj. Atyre, përveç se u merrej malli, i shëtitnin nëpër treg të hipur në karrocë, me mallin e fituar me dallavere në kurriz të popullit. Të tillë tregtarë quheshin "Cerno berzo", Tregu i Zi.

Me punonjësit kolegë
të Shtëpisë Botuese Prizren, 1946

Në ditët e çlirimit të Prizrenit unë isha familjarisht atje. Për momentet e para isha i përgatitur për ushqime e artikuj të tjerë për familjen. Në familje kisha Nënën e Dullës, gruan dhe vajzën Myrvete.
Më vonë, furnizimi i popullatës i kaloj Këshillit Nacionalçlirimtar, i cili ushqimet i merrte tek tregtarët e mëdhenj. Mua furnizimi më sigurohej direkt nga Intendenca e Shtabit të Brigadës, se komisar ishte Xhavit Nimani e komandant Pedrag Ajtiçi, të cilit më njihnin mirë për ndihmat që kisha dhënë. Më furnizonin me miell, sheqer, oriz, vaj, mish. Më jepnin dhe të holla, përafërsisht sa rroga, se ushqimet ishin falas, si me qenë ushtar me gjithë familjen. Në janar të vitit 1945 u stabilizuan rrogat dhe vendet e punës. Mua me caktuan daktilografist i tre përkthyesve të Shtëpisë Botuese, e cila merrej me përkthim librash. Kjo shtypshkronjë nxirrte dhe organin e Frontit Demokratik "Lidhja e Prizrenit". Drejtor i kësaj Shtëpie Botuese ishte Xheladin Hana nga Gjakova, i cili kishte dhënë shumë gjatë lëvizjes e luftës, kishte dalë në mal partizan. Baba e nëna e tij ishin internuar në Gjermani, dhe në mënyra të ndryshme kishin shpëtuar nga kampi, e me shumë vuajtje kishin arritur në Kosovë. Edhe ata dolën në mal me çetat deri në çlirim. Xhaxhai i tij ishte vrarë nga gjermanët. Xheladini kishte kryer Normalen e Elbasanit dhe ishte i pjekur, i vendosur e guximtar. Dinte me shkollë frëngjisht, anglisht dhe latinisht. Pa shkollë (pa dëshmi) rusisht, serbisht e turqisht. Qëndrova në atë detyrë deri më 15 Shtator 1946.

U largova nga andej me kërkesën e Komitetit të Partisë Kukës. Sekretar ishte Abaz Arif Shehu nga Bicaj. Ai vdiq në Elbasan duke punuar në Komitetin e Partisë.
Jam sistemuar familjarisht në Kukës, ku jam emëruar në pune si Sekretar Prokurorie të Qarkut Kukës. Për punë të mirë jam rritur në detyrë si N/Prokuror për Hetuesinë. Në këtë sektor jam lodhë shumë se me mungonte arsimi përkatës. Megjithatë, për sa kohë qëndrova aty kam punue mirë dhe mbas largimit nuk jam thirre për sqarime, mungesa pune apo shkelje.


Vertetohet

KOMITETI VETERANEVE TE L.N.C.TE RRETHIT KUKES

KRYETARI

Iljaz Çiku

Bazat e luftës NÇL në Kukës

181

Kola, Isuf B. Kërxhaliu, Rifat Spahiu, Osman Domi, Rexhep Bulica, Hashim Gashi, Riza Spahiu, Ali Selmani, Elmaz Serani, Jonuz Shehu, Ahmet Shehu, Liman Nuhia, Taip Hoxha, Taf Rexhep Rexhmati, Mehmet Selimi, Hazir Murati, Ram Sokoli, Lazim Sula, Mevlan Ismaili, Xhem Sinani, Kamber Avdia, Bejt Rustemi, Tahir Asllani, Ejup Shehu, Brahim Brahimi, Hajdar Sinamati etj. (Nxjerrë nga Kujtime të Rasim Gurit, f. 12, Tiranë 30.05.1963).

FOLE SHQIPONJASH.....Dilaver Bajraktar

BAZA TE LUFTES ANTIFASHISTE NACIONALCLIRIMTARE SHPALL ME VENDIM TE BYROSE SE KOMITETIT TE PARTISE SE RRETHIT KUKES Nr. 19/1 DATE 29 MARS 1969 (secret) .

34	KAMBER	AVDI	FEJZULLAHI	BICAJ
35	MILAIM	RUSHIT	FEJZULLAHI	BICAJ

180

Kujtime të veteranit Rasim Guri dhe pjesë nga libri "Fole Shqiponjash" të Dilaver Bajraktari, ku vërtetohet se shtëpia e Kamber Avdi Fejzallarit dhe Milaim Rushit Fejzallarit kanë qenë baza të luftës Nacional – Çlimtare.

Aktiviteti i kryer në Prizren në favor të Lëvizjes Nacional Çlirimtare më është njohtë nga shokë të Partisë si material autobiografik, por nuk më është njohur për efekt pagese. Sipas pyetjeve që më kanë bërë disa shokë komunistë, më kanë thënë që aktiviteti ka qenë zhvilluar në një territor tjetër, të një Partie tjetër (P.K.Jugosllave). Për t'u njohur kjo duhet të vërtetohet nga persona që kanë qenë anëtar të Qarkut të asaj Partie. Unë kam punuar duke u mbështetë në parimin "Të përzëmë okupatorin nga vendet tona" dhe kam pranuar në shtëpi persona nga të gjitha kombësitë, duke iu shërbyer me gjithë familje, pa hile, deri në çlirimin e plotë të vendit e krahinës ku kam punue e jetue familjarisht, dhe as që

<u>më ka shkuar mendja për shpërblim për efekt ndihme të Lëvizjes Nacional - Çlirimtare.</u> (Nënvizimi Kamber Avdia)
Para se të mbylli kapitullin e qëndrimit në Prizren, dua të theksoj se me 3 gusht 1946 me ka vdekë Nëna e Dullës. Ajo ishte e vjetër dhe kur i erdhi vdekja ka qëndruar rënë vetëm dy ditë. Ajo na ka rritë mua dhe Bajramin dhe arriti me mbajt në prehër fëmijët e mijë, Myrveten 1942 dhe Bashkimin 1945. Me rastin e vdekjes në Prizren i janë bërë të gjitha nderimet e përcjelljes për në banesën e fundit dhe me ceremoni e popull, siç e lypte vendi, sidomos në Prizren. Kanë marrë pjesë në varrim jo vetëm 100 lumjanë , që ishin atje të vendosur familjarisht, por edhe mbi 200 të tjerë vendas, prizerenjanë, sepse kur isha para luftës Sekretar Bashkie kisha fituar simpatinë duke ndihmuar popullin. Vlen të theksohet se në Prizren e kishin zakon pjesëmarrjen në varrime, sidomos të jabanxhinjëve. Prizreni është vendi më fanatik dhe fetar në të gjithë Kosovën dhe Rrafshin e Dugagjinit. Respekti që kishin njerëzit dhe masat që mori Këshilli i Qytetit më krijuan lehtësitë që unë të mos bëj asnjë shpenzim, që nga varrimi, ushqimi etj. Për gjithë javën u bë një pritje e jashtëzakonshme, sepse më siguruan me shumicë ushqime dhe të holla.

Gjatë qëndrimit në prokurori gjendja ekonomike ka qenë e mirë. Fëmijët i kisha më të vegjël e shpenzimet më të pakta, por edhe ato ushqime që merrnim ishin të triskuara dhe në përqindje shumë më lirë se në “tregun e lirë”. Fëmijët nuk i kam pas me shëndet të plotë, se shtëpia ku banoja në breg të Drinit të Zi (tek Taf Bonjaku), ishte përdhese dhe dy metër në tokë. Vitet 1950 - 1955, kanë qenë vitet që më kanë tronditë shpirtërisht. Shtëpia ku banoja ishte e papërshtatshme për shëndetin, dhe fëmijët lindnin dhe nuk jetonin

shumë. Vdekja e tyre vinte brenda 24 orëve të sëmundjes, pra ne se sëmurej në 6 të mëngjesit, ose vdiste natën, ose nesër në atë orë. Mjekët i vizitonin e ata nuk paraqisnin asnjë shenjë serioze. Gjatë kësaj periudhe më kane vdekur 3 fëmijë, 2 vajza dhe 1 djalë. Këto vdekje me tronditën moralisht, por më shumë ndër të gjitha, vdekja e vajzës së madhe, Myrvetes, më 5 mars 1955. Myrvetja në atë kohë vazhdonte klasën e VII-të. Për 5 ditë, me 3 doktorë tek koka, me shpenzime sa të kërkonin e nuk arriti të shpëtoj. Mua më është bërë një shenjë në zemër dhe sa herë që e kujtoj, lë në mes çdo punë që kam, ose edhe n.q.se jam në sofër, ngrihem, dal përjashta ose në ndonjë vend tjetër për pak minuta, pastaj kthehem në vend. Unë u ndodha qytetar me zemër se "Fshatarit kur i ndodh ndonjë fatkeqësi, kur është në lidhje me nderin, kris pushka, kur është në lidhje me fatkeqësitë e natyrës, e shkon kohën me shokët të fisit, me punë e bagëti, kurse qytetari kur i ndodhë fatkeqësi e rëndë , ose var veten, ose pi raki e rri dejshëm". Nuk kisha punë shtetërore se isha avokat, e dilja në punë kur kisha mundësi e isha i qetë. Në fakt kisha krijuar njëfarë baze ekonomike sa me mbajt fëmijët e tjerë.

Në vitin 1956 gjendja e tronditur shpirtërore ndryshoj pak, e sidomos për gruan time Nurie. Lindi djali Adem me 14 Qershor 1956 (me emër përkëdhelës Dush). Shtëpinë ku ishim e ndërruam. Unë vazhdoja punën në drejtësi si Avokat. Kjo punë vazhdoj deri në vitin 1959 kur Kolektivat e Avokatëve u mbyllën se u krijuan Juristë pranë Gjykatave dhe Këshillave Popullore të Rretheve. Unë kalova në punë administrative të ndryshme, ku paraqitej nevoja. Kam punuar në Seksionin Komunal si llogaritar; tek i Plotfuqishmi i Grumbullimit si K/Llogaritar; në SMT si Shef Kuadër - Administratë dhe më në fund si Shef Administrate në Gjeologji, prej ku kam dalë në pension.

Prej vitit 1956 - 1961 me kanë lindur 3 djem, që i kam gjallë, që janë : Ademi 1956, Bilbili 1959 dhe Shkëlzeni 1961. Për rrijen e edukimin e tyre është kujdesur vajza e madhe Flora. Në këtë periudhë më është dashtë me shpenzu për t'i rritë fëmijët e vegjël, por për t'u kujdes edhe për të madhin, Bashkimin, i cili ishte në shkollë, pastaj ushtar e përsëri në Universitet. Për atë jam interesuar më pak, pasi ai kishte arrite njëfarë moshe me kuptue hallet e familjes.

Bashkim Avdia, Kudusi Shehu, Kamber Avdia Bajram Avdia Nuhi Gjana dhe Sherif Alia

Me kushëririn Isuf Nebia, dhe vëllain Bajram Avdia

Pse janë lënë shënimet e mia ?

Të sqarohet origjina e prejardhjes së fisit, e kjo zgjatje që po bëhet në shkrime, sidomos në rastin tim, vlen për t'u pas parasysh, me nxjerrë ato që mund të jenë të vlefshme, si kujtime për njerëzit tanë të ardhshëm.

Unë, nëpërmjet jetës që kam kaluar, në disa raste duke qenë në vetmi, sidomos në orët e vona, kam shkruar vargje të lira e të shkurtra, të pabotuara ose te pakomentuara nga ndonjëri. Po ashtu më ka takuar rasti të kap nga goja e popullit ndonjë anektodë, që dikush nuk e ka dëgjuar, dhe për këtë jam tue mendue me gjete njëfarë rasti me rishqyrtue dorëshkrimet dhe me i përmbledhë në një bllok të vetëm në formë materiali shoqëror, që në një kohë të mëvonshme të hyjnë në punë, makari, për efekt zbavitje.

Kamber AVDIA

Unë, Ademi për **babain** Kamberin :

E kush nuk dëshiron të shkruajë për babain e tij? E kush nuk e do dhe e respekton atë? Megjithëse nuk të takon në jetë ta zgjedhësh, ti duhet ta pranosh me të gjitha të mirat dhe të këqijat që ai ka, me gjithë kusuret që mbart. Njëherë ra muhabeti me një plak nga fshati Shtiqën mbi respektin ndaj baballarëve. Ai më tha : "Baba edhe thi (derr) me të qëllue, duhet me ia lëmu qimen". Unë isha me fat që baba nuk më qëlloi "thi", por edhe po të më kishte qëlluar ... kjo si hyrje me shaka.

Unë do të shkruaj disa kujtime si episode të shkurtëra, ku do të tentoj të nxjerr në pah karakterin dhe shpirtin e tij prej njeriu të mirë.

Babën, Kamberin, e mbaj mend gjithmonë të thjeshtë, komunikues dhe i gatshëm t'i japë ndihmesën kujtdo dhe kurdo. Ai tregon se ka përdorur alkool, ka pasur vese, se në pleqëri nuk ka dëgjuar mirë, ka bezdisur të tjerët, etj. Qëndrojnë, por jo në masën që të krijonin bezdi dhe mosdurim te të tjerët. Ai ka qenë i ëmbël në muhabet, por i shmangej atij që nuk e donte ose dikujt që i krekosej. Nuk e duronte kapadaillëkun dhe ia plaste gjithkujt në sy. Ishte shumë i kujdesshëm në biseda direkt dhe ruhej shumë që të mos fyente. Edhe në biseda me ne fëmijët ka qenë shumë i kujdesshëm. Kur kishte ndonjë porosi të veçantë ose kur e kisha shkelur në ndonjë rast, atëherë vepronte kështu: - Sonte kam një muhabet – më thoshte. Atë natë, pasi të gjithë binin të flinin, ne bisedonim për problemin në fjalë. Rrallë mund të tërhiqte vëmendjen në sy të të tjerëve. Këtë e bënte që askujt të mos i ulte autoritetin.

Që të vegjël na ka mësuar të numërojmë, të shkruajmë e të bëheshim gati për shkollë, pa filluar ajo. Lexonte shumë libra dhe në shtëpi kemi pasur shumë të tillë, bile edhe botime të viteve 1935 e prapa. Librin e ruante dhe e vlerësonte. Në një rast i them unë ta hedhim "Tregtarë Flamuj" të Ernest Koliçit, pasi ai ishte i dënuar nga Partia dhe nuk duhej ta mbanim në shtëpi librin e tij. Edhe novelat e tij më dukeshin pesimiste. Isha mësuar me realizmin socialist ku personazhi kryesor, kushdo që të ishte, do të përfundonte triumfator, ndoshta edhe duke vdekur.

- Mirë – tha – pse ta hedhim, po të kërkon bukë e ujë? Lëre aty në raft, po të duash lexoje, po të duash, jo. E ai libër akoma ndodhet në raftin e librave.

I kishte merak dhe i kujtonte të gjitha librat e vjetër që i kishin humbur e nuk i kishin kthyer ata që i kishin lexuar. Në vitet e vona nuk mundi më t'i inventarizonte ato dhe në kohën kur unë isha në shkollë na e kanë masakruar bibliotekën.

Mbante mend shumë nga librat që kishte lexuar dhe në biseda të ndryshme citonte vargje përmendësh. Me shumë i pëlqenin "Rubaiat" e Omar Khayyám, e veçanërisht vargjet kur ai shkruante për alkoolin, jetën pas vdekjes dhe dashurinë. Recitonte Fishtën e mbante mend shumë nga "Lahuta e Malësisë", dialogë të Marash Ucit dhe bijve të Calit.

Ishte nëpunës i rregullt dhe e njihte mirë profesionin që zotëronte. Gjithë jetën kishte shkruar në makinë shkrimi. "Makinën time të shkrimit e njoh nga zhurma kudo që të jemë", thoshte. "Kjo është pesha më e rëndë që kam ngritur në jetën time. Lëvizjen e makinës shkrimit nga njëra tavolinë te tjetra". Kur shkoja në zyrën e tij e gjeja gjithmonë duke shkruar. Zakonisht në zyrë kishte dy makina shkrimi. Mua më ulte te makina e vogël, më jepte fletë kalendari në të cilat kishte ngjarje përkujtimore, etj dhe më thoshte t'i kopjoj. Kishte qëllim të më mësonte makinën e shkrimit.

Mbante mend ditëlindjet e të gjithëve dhe ishte në merak të kujtoheshin e festoheshin me sa mundësi kishim. Më kujtohet njëherë, isha adoleshent në gjimnaz dhe atë ditë kisha ditëlindjen, por e kisha harruar fare. Dola me shokët pasdite, pas mësimeve, dhe duket u vonova më shumë se ditët e tjera. Kur shkova në shtëpi darka ishte ngrënë dhe mua ma kishin ruajtur, si zakonisht, pjatë mbi pjatë. E shtrova tavolinën, kur ai u ngrit dhe më solli një gotë raki dhe me gotën e vet në dorë më

uroi. Mua më erdhi shumë rëndë, më shumë nga kujdesi tij se sa nuk isha kujtuar për veten time.

Kishte merak edukimin e fëmijëve me traditat. Na merrte dhe na ulte të hanim ulur, si në sofër dhe na mësonte si të nxjerrin gjurin e majtë para, në mënyrë që të mos zëmë shumë vend, si të përdorim lugën, etj. Kishte merak që kur të shkojmë në fshat të mos turpërohemi.

Kujdesej për ne që në rast festash të ishim pak më ndryshe. Ishim të vegjël dhe në kohët e atëhershme nuk supozohej të festohej Viti i Ri me të gjitha kushtet. Jo vetëm që nuk kishim, por edhe tradita mungonte. Por ai për atë ditë merrte një sasi arrash, i ndante mes nesh afërsisht barabar dhe pas kësaj luanin me letra si bixhoz, kush do të fitonte më shumë shoqi shoqit. Kështu kalonte koha e afrohej ora e pritjes së Vitit të Ri. Në fund ia shpërndanim prapë arrat njëri tjetrit dhe i hanim. Nuk kishte rëndësi kush fitonte, arrat ishin të të gjithëve, i hanim të gjithë.

Kur merrte rrogën nuk harronte të fustë në çantën e bukës ndonjë frut për ne fëmijët. Ishte shumë i kujdesshëm në këtë ditë.

Nëna punonte në spital në pediatri dhe puna ishte me tre turne. Ai në këtë kohë kujdesej shumë për ne fëmijët, si për përgatitjen e ushqimit, mësimeve, fjetjeve e nevoja të ndryshme. Gatuante më shumë supë me perime, apo një lloj fërgese që ai e kishte shumë qejf.

I priste njerëzit që vinim për probleme e halle të ndryshme në shtëpi, veçanërisht kur kishin probleme që lidheshin me administratën shtetërore. Ata mbanin mend kohën kur ai kishte qenë avokat dhe i drejtoheshin atij për “lutje” (kështu quheshin kërkesat drejtuar titullarëve të administratës apo institucioneve të ndryshme). Në të shumtën e kohës problemet zgjidheshin. Më kujtohet rasti i disa familjeve mirditore të vendosura me inisiativ në rajonin e Fushë Dugagjinit, në Kolsh. Vinte në shtëpi Zef Gjegja (Zefi i Gjatë) si përfaqësues dhe një tjetër. Baba i drejtonte lutje Kuvendit Popullor e qeverisë e në përfundim ata fituan, u vendosën definitivisht dhe u bënë anëtarë të fermës së Grumbullimit, Kukës. Si shpërblim merrnin me vete një shishe raki ½ litri, të cilën baba e pinte ndërkohë që merrej me lutjen. Këtu përfundonte shpërblimi.

Ishte shumë sistematik në mbajtjen e dokumenteve dhe shënimeve dhe i ruante me fanatizëm. Në një rast gjej në valixhen e tij një ”Leje

varrimi" të Nënës së Dullës. (Në shënimet e mësipërme, kush t'i lexoj, do të ketë hasur se Kamberi ka pasur me vete gruan e kushëririt të tij, Dullës, në përkujdesje deri në vdekje, pasi asaj nuk i mbeti asnjë pjesëtar gjallë nga familja). Unë i thashë se pse e ruan atë leje varrimi, dokument pa vlerë. – E ruaj – më tha – për disa arsye: 1. Dihet që Nëna e Dullës, Sulltania, ka qenë nën kujdesin e Kamber Avdisë. 2. Dihet vendi i saktë i varrimit, nëse ndonjë nga fisi i saj interesohet. 3. Data e saktë e varrimit.

Kur isha oficer trupe kisha ushtar dhe djalin e E. M, në atë kohë sekretar partie në Komunale. Ai pretendonte që djalin ta mbanim ndryshe, si djalin e sekretarit dhe ngaqë kishte muhabet edhe me komisarin e Brigadës, I.B. Unë nuk i kisha dhënë leje dhe ai shprehet tek komisari se si mund të jetë oficer djali i një nëpunësi të Prizrenit të paraçlirimit, si i Kamber Avdisë. Mua më tregoi një person i tretë prezent në bisedë. Në darkë, si kishim zakon, i them babës se sonte kam një muhabet. Pasi ranë të flenë të gjithë unë i shtrova problemin dhe i thashë se n.q.se ka diçka, unë duhet të tërhiqem nga ushtria. Më mirë herët se vonë. Babai nuk u mendua fare, por shkoj hapi "valixhen" dhe nxori një letër të shkruar në 2 gjuhë, serbisht e shqip. Aty ishte një vërtetim ku thuhej përafërsisht se "Kamber Avdi Fejzallari ka punuar në ... për periudhën ... ka mbajtur qëndrim të mirë moral e politik, ka ndihmuar lëvizjen nacionalçlirimtare.." Letra kishte tre nënshkrime dhe tre vula nga pushteti, partia dhe policia. Letrën ma dha për t'ia treguar komisarit dhe unë shkova ia dhashë atij. Komisari me habi më pyeti se çfarë është kjo dhe unë i thashë t'ia tregonte E.M. për llafet që ka bërë. Komisari u prek dhe u merakos për shqetësimin e krijuar në familje. Ai tha se ne ju njohim mirë si ju, babain dhe Bajramin. Nuk ka vend për asnjë mëdyshje në këtë mes. Këtë e tregova jo vetëm për përkujdesjen e tij në pajisjen e ruajtjen e dokumentacionit, por dhe mendimin që të marrë një dokument të tillë në shtetin fqinj e që sot merr një rëndësi të veçantë.

Në takime me njerëzit e ndryshëm mbante shënime momentale në copa letre dhe pastaj kur vinte në shtëpi e krijonte mundësi i hidhte në bllok. P.sh : "sot piva kafe me ... shok i djalit tim ... ishte ... familja, babai ose xhaxhai i tij ...kam njohje që nga ... " etj. Kjo na krijonte mundësi jo

vetëm të merrnim informacion për njerëzit, por edhe të krijonim lidhjet fisnore e miqësore.

Ka punuar shumë vite në organet e drejtësisë. Asnjë shënim i vetëm në blloqet e tij të shumtë për këtë periudhë. Asnjë emër apo episod, qoftë vetëm i parëndësishëm ose objekt humori. Nuk donte të kujtonte dhe të dëmtonte askënd. Kur e pyesja direkt për ndonjë person që kishte qenë i dënuar, mbi rrethanat e masën e dënimit, ai më thoshte. "Sot ai ka djem e vajza të arsimuar. Mos u merr me emra se njollos familje. Mos prish ardhmërinë e askujt. Këto gjëra i di shumë mirë partia e pushteti, organet kompetente".

Kur mbushi moshën 75 vjeç unë i dhurova një bllok dhe një stilograf. Në faqen e parë përveç urimit për ditën e lindjes i kërkova që në bllok të shkruante dhe shënime për punën në administratë para çlirimit në Kukës e Prizren, por theksova të përmenden me emra personat që kishin ndikuar pozitivisht dhe negativisht në zhvillimet politike të kohës. Ai nuk ma plotësoi këtë dëshirë, e shkak mbeti mospërmendja e personave konkretë në ngjarjet politike si dhe gjendja shëndetësore e tij, që filloj të rëndohej.

Vetë nuk ka qenë asnjëherë i organizuar në parti, megjithëse vëllai i tij Bajrami të shumtën e karrierës e kishte në/pranë KQ-rë të PPSH. Mua më thirrën në ushtri dhe më dhanë dosjen për ta plotësuar për tu pranuar si kandidat për anëtar partie. Mora dosjen dhe në darkë si zakonisht, pasi pushuan të tjerët i tregova qëllimin e dosjes. "Kur isha Kryetar i Kooperativës së Artizanatit më thirri sekretari parë i partisë, A. Shehu dhe më tha se duhet të pranohesh në parti, se kryetar pa parti nuk mund të ketë. Unë në atë kohë përdorja pak rakinë e zura sebep me ketë. A të lejon partia me pi raki? – e pyeta. Pak nuk ka problem. – Po mos me u përmbajt? Jo, ashtu jo, më tha. Atëherë mu drejtua mua : - Vlerësoje mirë. Nëse pranimi në parti të detyron të ndryshosh karakterin mos u prano. Ti nuk do ta ndryshosh e për rrjedhojë do të përjashtohesh. Përjashtimi nga partia është pushkatim politik. Vendos vetë". Të nesërmen mora dosjen dhe e dorëzova bosh e deri në fund mbeta pa parti, si rrallë ushtarak karriere.

Bajrami, vëllai tij, ishte në pjesën më të madhe të kohës me punë në/pranë KQ të PPSH. Nuk e kam dëgjuar ndonjëherë të ndërhynte për dikë apo për vete. Ndoshta ai nuk kishte nevojë të ndërhynte se udhëheqja politike e dinte vetë që ishte vëllai i Bajramit. Si vëllezër duheshin shumë dhe në rrethe të ngushta e familjare fliste me shumë respekt për atë. Kur ne i thoshim ndonjëherë pse mbete në Kukës, ai tregonte se kur u shkrinë Kolektivat e Avokatëve, Bajrami më tha e unë desha të qëndroi te eshtrat e të parëve. Dhe ashtu qëndroj ai e ne bashkë me atë.

I respektonte shumë miqtë, por ishte i drejtpërdrejtë me të gjithë, pavarësisht kush ishte dhe çfarë lidhje kishte. Gjithmonë thoshte : "Mikun duaje me gjithë kusuret që ka".

Disa njerëz i donte shumë. Një shokun tim, Ramazan Leka, e kishte shumë qejf e merak. Kur vinte në shtëpinë tonë ai i thoshte : - Ku je Ramazan Leka se ke 11 ditë pa ardhur! E me të vërtetë ishin plot 11 ditë që ai nuk kishte ardhur në shtëpinë tonë. Po kështu kishte edhe për një shok tjetër nga B.Curri, Mirash Sokolin, etj. Kur po martohet Ramazani, rrobat dolën nga shtëpia jonë për tek miqtë, si e do zakoni. Motra, Flora, bëri adetet me këngë me shoqet e punës së rrobaqepësisë. Kur ikën rrobat unë u futa brenda. Kur shoh baba po qante. Qante nga gëzimi që Ramazani pa prindër gjallë u bë për tu martuar. Dhembshuri prindi.

Kur vinin mysafir dhe ishte i detyruar të pinte raki me ata, ne fëmijëve nuk na afronte asnjëherë në pije. Nuk tentoj asnjëherë të na mësoj alkoolin dhe e quante shumë të dëmshëm. "Alkooli – na thoshte – jo vetëm të dëmton ekonomikisht, por të prish karakterin dhe të ul dinjitetin. Kam pasur raste që kam diskutuar në mbledhje të ndërmarrjes. Dikujt nuk i ka pëlqyer dhe ka shprehur. "Ulu o Kamber se më duket paske pi sot", kur unë atë ditë nuk kisha pi fare: Gjithë diskutimi kot. Ose nëse hyj në lokal e duke dal jashtë pengohem e rrëzohem. Të gjithë shohin e mendojnë se Kamberi paska pi, kur unë jam futur në fakt të blej një shkrepëse. Plus të tjerave më të rëndësishme: ngatërresat e prishja harmonisë në familje, edukimi fëmijëve dhe mbarëvajtja e problemeve të përditshme që dalin në jetë.

Rakia theksonte "është e mirë për gëzime e raste". Të rregullon atmosferën dhe të shton harenë e muhabetin. "Njëherë shkova te njerëzit Nuries, gruas time, që në atë kohë banonin në Fajza – dhe vazhdonte – më respektuan, kafe, muhabet, pasi edhe shkoja rrallë dhe isha pa pretendime. Shpëtimi, djali madh, ishte te puna dhe kur kishte marrë vesh që kisha shkuar atje, në kthim kishte marrë edhe një shishe raki. Erdhi dhe e hapi shishen e na mbushi gotat. Filluam "gëzuar", "shëndet" etj.

- O Shpëtim - i them - po deri tani ishim shurdh e nuk kemi bërë asnjë urim. Po shyqyr që solle këtë shishe raki dhe e uruam njëri tjetrin. Rrofsh!"

Kamberi ne dasmë të djalit, Ademit.
21 Gusht 1983

Dilte paradite dhe pinte me të vetat 1 raki e një kafe. Mund të qëllonte ndonjë i njohur dhe i mbushte edhe një gotë tjetër e pastaj vinte në shtëpi. Nuk pinte e ulej me këdo. Në një rast ulet me një oficer, koleg ushtarak timin, K. Berberi, i cili pinte shumë. Ai i kishte dhënë një fërnet dhe kur erdhi tek ne në stërvitje në terren, mes shokësh më tha se kam takuar babanë tënd dhe i kam dhënë një fërnet. Mua më erdhi inat nga shokët. Në darkë i thashë bisedën dhe e porosita që të mos pinte më me atë. Ai nuk foli. Të nesërmen K. erdhi dhe më takoi i acaruar. Ai e kishte thirrur kamerieren, Shkurten, tek "Parku", dhe i kishte thënë: - "mbushi atij magjypit (K. ishte i zi në paraqitje) një fërnet e të shkojë e t'i tregojë djalit tim se Kamberi ma ka kthye fërnetin".

Ai nuk është sot me ne, por ne bisedojmë dhe e kujtojmë shpesh. Dua të theksoj se sa herë bisedojmë për atë në familje nuk ngrysemi. Edhe mund të qeshim me bëmat e tij, zakonisht kur tregojmë histori me motrën, Florën. Nuk ka lënë hidhërim pas. E kujtojmë ashtu si ishte, thjesht, pa komplekse, pa paragjykime. E kujtojmë ashtu si doja, sinqerisht, të më kujtonin edhe mua. Të më kujtonin pa u brengosur, lirshëm sikur të jem unë aty me ata.

Dy fjalë për shoqen e tij **Nurien** :

Nurie Ramadan Saphiu ka lindur në Kolesjan më 20 prill 1926, por në regjistrat e gjendjes civile figuron 20 prill 1922. Është e bija e Ramadanit dhe e Shahe Spahiut (Cengu). Është martuar dhe ka krijuar familje me Kamber Avdinë nga Bicajt më 3 nëntor 1940.
Prejardhja e saj si familje është e njohur, pasi fisi i Spahive të Kolesjanit jo vetëm që ka pasur pasuri, por ka nxjerrë edhe njerëz me zë për trimëri dhe patriotizëm. Ata që para shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (1912), kanë marrë pjesë në luftëra e kryengritje të ndryshme kundra turkut e pushtuesve të trevës sonë. Nga ky fis, që është i afërm me familjen e saj, ka qenë patrioti Baba Lam (Islam Spahiu, i cili ka marrë pjesë në Luftën e Kaçanikut, në beteja kundër forcave turke, serbe, etj). Nuk ka qenë njeri i kompromiseve. Nga familja e Spahive kanë dalë njerëz të zgjuar si : Riza Spahiu, Rifat Spahiu, etj, të cilët kanë qenë nga mësuesit më të parë e ndër më të mirët. Nga fisi i Babës Lam kanë dalë kuadro në mjekësi, ushtri e sektorë të rëndësishëm të ekonomisë.

Babai i Nuries, Ramadani, është marrë kryesisht me bujqësi e blegtori. Ka qenë njeri me karakter të fortë dhe nuk bënte asnjë lëshim kur i hipte gjaku.
Nana e Nuries, Shahe, ka qenë e bija e Sul Imer Cengut nga fshati Shtiqën. Familja e saj ka qenë familje me zë për trimëri e pasuri. Historia pasqyron më së miri se njerëzit e kësaj familje janë të parët qendrestarë kundër evazionit turk, serb dhe forcave pushtuese në vitet e luftës nacionalçlirimtare. Njerëzit e kësaj familje gjithmonë kanë qenë të lidhur me Partinë e Pushtetin. Me detyra shtetërore në Degën e Rendit ka punuar Sul Hajrulla Cengu. Po në marrëdhënje shtetërore dhe te organizuar në Parti kanë qenë dhe 2 vëllezërit, Riza dhe Hysni. Rizai ka qenë gjithmonë më aktiv dhe i ngarkuar me detyra të rëndësishme për kohën në fshatin Shtiqën.
Nuria ka pasur 2 vëllezër, Hilmi dhe Bajramin. Të dy vdiqën të rinj duke lënë pas vetes :

- Hilmia, gruan Nuren, të bijën e Xhem Rexhep Dogjanit nga Bicaj dhe djemtë Shpëtimin, Qemalin, Beharin dhe Hasimin dhe 2 vajza Zyrafete dhe Fiqirie, te martuara njëra tek Sadik Hoxha në Malqene dhe tjetra tek Qemal Qazim Velia (Zeneli) në Kukës.
- Bajrami, gruan Fatime Baja nga Kalisi, 1 djalë Ramadanin dhe 2 vajza Lumturie dhe Hatije. E para është martuar me djalin e Selim Shehut, Besnikun në Kukës.

Të dy vëllezërit e Nuries kanë vdekur brenda 7 muajve, në mënyrë të menjëhershme dhe pa vuajtje. Kanë qenë punëtor dhe të arsyeshëm. Kanë vdekë në moshën, 48 vjeç (Hilmia) dhe 37 vjeç (Bajrami).
Karakteristika të veçanta :
Nuria para martesës nuk ka pasur asnjë profesion, se ka qenë shumë e re dhe është marrë me punë shtëpie.
Pas martesës me Kamber Avdinë ka shkuar me banim në Prizren, ku fitoi njëfarë zhvillimi si grua e filloj të njihte jetën, por fatkeqësisht ishte e paarsimuar e pas lindjes së fëmijëve mbeti në atë gjendje.
Në Prizren, për hir të lidhjeve me vëllain e burrit, Bajram Avdiun dhe për hir të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, me ato mundësi që ka pasur, është

munduar dhe ka ndihmuar Lëvizjen me të gjithë ato mundësi që u takojnë grave (larje, qepje, transport materialesh etj)
Nga fillimi i martesës e deri vonë ka qenë e shëndoshë, por me kalimin e kohës, fëmijët u shtuan në numër, po ashtu dhe vdekjet e fëmijëve e të vëllezërve, i shtuan shqetësimet.
Ka qenë shumë e urtë dhe e pastër në ndërgjegje.
Me kthimin nga Prizreni erdhi në kontakt me shoqe të Organizatës së Gruas, të cilat e ngarkuan me detyra shoqërore.
Është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të R.P.SH.
Më pas u punësua si edukatore definitive në spitalin civil. Aty punonte mirë dhe shpërblehej shpesh.
Ka qenë administratore dhe ekonomiste shumë e mirë në familje.
Mundohej me gjithë shpirt të ndihmojë njerëzit e pamundur dhe shoqet e saj, në rast fatkeqësish, me fjalë e me punë.
Mundohej t'i bënte të gjitha punët e shtëpisë, gatime, arnime, qepje etj.
U nda nga jeta më 28 Tetor 2010 në Kukës.
Kamberi dhe Nurija gjatë kohës që jetuan bashkë krijuan familje dhe rritën e edukuan këta fëmijë :

Myrvete Kamber Fejzallari, lindur në Prizren më 3 qershor 1942. Ishte fëmija i parë i familjes. Dallohej për një zgjuarsi natyrale dhe fëmijë shumë i dashur dhe i afrueshëm. Në shkollë kishte rezultate shumë të mira. Kur u sëmur ishte në klasën e 7-të. Vdekja e mori brenda 5 ditëve dhe qe një ndër humbjet më të mëdha që goditi familjen e Kamber Avdisë. Ajo kujtohet gjithmonë nga familja. Emrin e saj e mban vajza e Shkëlzenit, djalit të fundit të Kamberit.

Bashkim Kamber Avdia,

ka lindur më 16 prill 1945 në qytetin e Prizrenit, pasi në atë kohë babai Kamberi së bashku me familjen e tij punonte e jetonte në këtë qytet.

Shkollën fillore e kreu në qytetin e Kukësit, kurse atë 7 - vjeçare në qytetin e Tiranës, në shkollën „Lidhja e Prizrenit“, ku banonte xhaxhai i tij, Bajrami.

Në vitet 1961 - 1965 ka vazhduar e përfunduar Teknikumin e Ndërtimit „ 8 Nëntori“ në Tiranë, e më pas është kthyer në qytetin e tij në Kukës ku është punësuar në Seksionin e Arsimit pranë Komitetit Ekzekutiv të KP-rë së rrethit në ndjekjen e zbatimin e investimeve nga ky seksion. Në këtë periudhë ka bërë një punë të madhe dhe të palodhur në ndërtimin e riparimin e shkollave dhe lapidarëve në zonat më të thella të vendit.

Në vitin 1966 - 1968 ka kryer shërbimin e detyruar ushtarak dhe më pas ka filluar menjëherë punë në Ndërmarrjen Komunale Kukës.

Në këtë kohë zgjohet tek ai ndjenja e arsimimit të mëtejshëm, sepse vazhdimisht konstatonte se detyrat që mund t‘i kryente donin jo vetëm vullnet e aftësi por dhe arsimimin përkatës. Kjo e detyroi që në vitet 1970 - 1975 të ndjekë dhe të përfundoj me sukses studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Ingjinjerisë së Ndërtimit.

Me mbarimin e studimeve emërohet si Kryetar i Degës Teknike në Ndërmarrjen e Riparim Shërbimeve Kukës. Në këtë ndërmarrje u detyrua të përballoj një ngarkesë relativisht të madhe për faktin se përveç detyrave të mëdha që ndërmarrja duhej të përballonte në Kukësin e Ri, që po rindërtohej, një ngarkesë

akoma më e madhe ishte në Kukësin e Vjetër që po prishej, e nga ku duhej të punohej me përkushtim maksimal, për të marrë maksimumin e materialeve të hequra e që kishin mundësi të ricikloheshin nga ndërmarrja.
Ndiqte me shumë profesionalizëm punimet e zbatimit që kryheshin në objektet social - kulturore si, Shtëpia e Oficerëve etj dhe kujdesej me shpirt që objektit të mos i mungonte asgjë duke e realizuar atë si në kohë ashtu dhe me cilësinë maksimale.
Më 8 qershor 1975 u fejua me Vjollca Din Durakun dhe u kurorëzuan me martesë më 18 korrik 1976, duke krijuar familjen e tij. Së bashku lindën djalin e vetëm, Dorianin.
Vjollca ka lindur më 30 prill 1951 në një familje shumë të mirë, të ndershme, punëtore dhe me tradita atdhetare. Jo vetëm prindërit e saj, Dini dhe Xhylzarja, por dhe gjithë xhaxhallarët e saj kanë qenë të inkuadruar në punë intelektuale dhe kanë kontribuar në sektorët shtetërorë si drejtues dhe ato të mbrojtjes si kuadër ushtarak. Të gjithë janë të repektueshëm e gëzojnë reputacion në popull. Vetë Vjollca ka kryer arsimin e lartë për mësuese gjuhë – letërsi dhe e ka ushtruar në shkolla të ndryshme 8 vjeçare të qytetit Kukës. Gjithmonë është paraqitur inteligjente në profesion dhe ka gëzuar respektin maksimal të kolektivave mësimdhënëse.

Në mesin e vitit 1979 Bashkimi u sëmur rëndë, e megjithë përpjekjet e institucioneve shëndetësore në Kukes e Tiranë, gjëndja e tij nuk u përmirësua, e kështu me 3 Gusht 1980, në prani të familjes, shokëve të fëmijerisë e kolegëve të punës, që e deshën aq shumë, u nda nga jeta në spitalin e Kukësit.
Gjatë gjithë jetës së tij, në të vertetë shumë të shkurtër, 35 vjeçare, ai la shumë mbresa tek njerëzit me të cilet kishte punuar, jetuar e ushtruar aktivitete të ndryshme.
Lexonte shumë dhe gjithë kohën e harxhonte duke përpiluar e studiuar projekte e duke

shfaqur ambicie shumë interesante për veprat që mund të ndërtoheshin në Kukësin e Ri. Shumë projekte mbeten në letër e shumë vetëm të skicuar e të fshehura perjetësisht në mendjen e tij. Kur fliste për projekte, dukej se atë vepër e kishte përpara të përfunduar e krenohej me punën që do të bënin.
Ka pasur marrëdhënie të mira me shokët dhe kolegët, sa edhe sot bashkëmoshatarët dhe ish - kolegët e tij shprehen me superelativa e thonë që jemi shumë krenar që kemi punuar me Bashkimin si teknik ndertimi e më pas si inxhinier në ndërtimin e veprave të Kukësit të Ri. Me shumë dashuri flasin për atë shtresa e varfër e asaj kohe, sepse gjithë kohën atë e degjoje të fliste për këta njerëz, që mezi siguronin bukën e gojës dhe nuk ndjehej rehat deri sa t'i sistemonte në ndonjë punë, e këtë gëzim vazhdimisht e ndante me të tjerët.
Kur punonte fishkëllente nën zë muzikë të festivaleve të asaj kohe e kishte shumë dëshirë të organizonte aktivitete me shokët, veçanërisht ato në natyrë e në vende me ajër të pastër e të gjelbëruar.

Flora Kamber Aliaj,

ka lindur në Kukës më 14 dhjetor 1947. Ka mbaruar shkollën fillore dhe në të pastajmen e ka ndërprerë shkollimin, pasi fëmijët e tjerë pas saj ishin të vegjël e prindërit në punë shteti. Ajo që e vogël është marrë me rritjen dhe edukimin e vëllezërve Adem, Bilbil dhe Shkëlzen.
Ka punuar si rrobaqepëse në ndërmarrjen e Riparim Shërbimeve. Është njohur dhe ka lidhur jetën me Sherif Beqir Aliaj nga fshati Brekijë, Kukës. Sherifi ka punuar në ndërmarrjen e Artizanatit me profesion qeleshepunues, deri në periudhën e pensionit. Sherifi me familjen e tij, nënën e vëllezërit ka ardhur shumë

herët nga Brekia dhe është vendosur në Kukësin e vjetër. Kanë qenë familje e thjeshtë, punëtore dhe kanë qëndruar në hesap të tyre.
Nga martesa e tyre kanë rritur fëmijët Mimoza dhe Klodian, të cilët kanë krijuar familjet e tyre. Familjarisht banojnë në Tiranë.

Adem Kamber Avdia,

lindur në Kukës më 14 qershor 1956. Erdhi në familje pas disa fatkeqësish së ndodhura në këtë kohë, pas vdekjes së tre fëmijëve njëri pas tjetrit. Lindi si gëzim pas hidhërimeve. Duke qenë në këto kushte ai vjen më "i brishti" ndër fëmijët, si duket edhe nga kujdesi i tepruar i familjes.
Ka mbaruar shkollën e mesme të përgjithshme "8 Nëntori" në Kukës dhe pas stazhit 1 – vjeçar në prodhim ka vazhduar në vitet 1976 – 1980 Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" në Tiranë.
Më 30 maj 1980 është titulluar "oficer aktiv" dhe ka shërbyer në repartet e garnizonit të Kukësit deri më 1 shtator 2006, kohë në të cilën ka dalë në lirim. Gëzon pension të parakohshëm si ushtarak dhe merret me aktivitet privat, si riparues i pajisjeve kompjuterike.
Është martuar në vitin 1983 me Shpresa Sabri Tolën nga fshati Buzëmadhë, Kukës me të cilën ka krijuar familje e kanë rritur, shkolluar e martuar fëmijët Ermal dhe Albana.

Bilbil Kamber Avdia,

lindur në Kukës më 18 mars 1959. Që i vogël ka qenë shumë i shkathët dhe dallonte nga vëllezërit sepse bënte shumë mirë ushtrime akrobatike. Me mbarimin e shkollës 8 – vjeçare ai iu fut rrugës profesionale të zanatit, pasi nuk paraqiste interes për vazhdimin e studimeve.
Menjëherë filloi punë në ndërmarrjen Komunale, në punë të ndryshme e deri në prishjen e Kukësit të vjetër. Për mbarëvajtjen e punëve kujdesej vëllai i madh Bashkimi, i cili punonte si inxhinier ndërtimi në këtë ndërmarrje.
Që i vogël u bë një ndihmës i madh për ekonominë e familjes dhe për familjen ka kontribuar të gjithë jetën e tij.
Ai u njoh dhe u martua duke krijuar familje me Drita Kadri Bilalin nga fshati Brekijë, por me banim në Kukës. Familja e Dritës ishte një familje e ndershme me origjinë punëtore.
Nga kjo martesë ata patën fëmijët Blerta, Besiana dhe Pranvera.
Blerta është arsimuar dhe është pedagoge universiteti në Tiranë. Mban gradën shkencore "Doktor shkencash" në gjeografi.
Besa ka krijuar familje me Urim Dali Dungën dhe kanë së bashku vajzën Ajkuna. Është mësuese në Shkollën e Mesme të Bashkuar, Bushtricë.
Pranvera ka mbaruar arsimin bazë dhe qëndron pranë familjes.
Kohët e fundit Bilbili punoi pranë ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve Kukës. Ka qenë një nga punonjësit më specialist, më të mirë, më të ndershëm e më të dalluar. Kishte një komunikim të përsosur me njerëzit dhe të gjithëve u mbaronte punë në kohën më të shkurtër.
Në muajin janar 2004 ai u sëmur rëndë. Megjithë kujdesin e treguar nga personeli mjekësor në Kukës e Tiranë, më 31 janar 2004 u nda nga jeta duke sjellë hidhërim të papërshkruar në familje, shoqëri dhe tek të gjithë ata që i njihte dhe bashkëpunoi. Këtë e tregoi dhe ceremonia e madhe në përcjelljen për në banesën e fundit.

Shkëlzen Kamber Avdia, lindur më 16 nëntor 1961 në Kukës. Me mbarimin e shkollës 8 – vjeçare në Kukës, vendosi të merrte drejtimin profesional.

Në shtator të vitit 1977 filloi shkollën e Ulët Mekanike Shkodër në profilin saldator – hekurkthyes, të cilin e përfundoi në vitin 1979.

Pas mbarimit të shkollës menjëherë filloi punë në Ndërmarrjen e Ndërtimit Kukës me këtë profesion. Ngarkesa e punës ishte shumë e madhe sepse punohej krahas ndërtimit të qytetit të ri të Kukësit, ashtu edhe për fortifikimin e gjithë territorit të vendit.

Shkëlzeni u njoh dhe krijoi familje me Nimete Hamdi Cenën nga fshati Gostil, Kukës, e cila punonte asokohe në Ndërmarrjen e Artizanatit, Kukës.

Ata kanë rritur dhe edukuar fëmijët Ditmir, Sidrit dhe Myrvete.

Ditmiri ka krijuar familje me Lida Ethem Peposhin dhe kanë së bashku vajzën Lajla.

Aktualisht Shkëlzeni punon në Ndërmarrjen Elektrike Kukës si elektricist.

Si u ndërrua mbiemri në **AVDIA** !

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS
ZYRA E GJENDJES CIVILE

Prot. 2423 **Kukës me** 04/09/**2012**

Vërtetim

Me anë të të cilit vërtetojmë se ne bazë të verifikimeve te bëra sipas Rregjistrit Themeltarë Kukës 10/24 dhe sistemit NCR te Rregjistrit Kombetar te shtetaseve vërtetojmë se shtetasi/ja Kamber Abdi Fejzollari i/e datelindjes 12.03.1912 lindur ne Canaj,Kukes eshte i njeti person me shtetasin Kamber Abdi Fejzollari i po kesaj datlindje lindur ne Canaj,Kukes pasi ka bere ndrrimin e mbiemrit nga Fejzollari ne Avdia me Dat.13.09.1976.

E lëshojmë këtë vërtetim sipas kërkesës së të interesuarit.

Përgjegjësi i Z.Gj.Civile B.Kukës
Adem TAFHASI

BASHKIA KUKES

Në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” kam shkuar me mbiemrin “Fejzallari”. Në atë kohë në shtëpi u diskutua ndërrimi i mbiemrit, veçanërisht në mes të babait, Kamberit dhe vëllait, Bashkimit. Ata ishin më të interesuar për faktin se babai që në vitet e Mbretërisë, kur punonte si nëpunës, e deri në momentet kur vihej në diskutim mbiemri, njihej me mbiemrin “Avdia”. Po me këtë mbiemër njihej edhe vëllai Bashkimi dhe xhaxhai Bajrami. Avdia ishte babai i Kamberit dhe Bajramit, pra gjyshi im. Kështu ka qenë traditë në malësi, ku njeriu njihej me atësi e pastaj me fis. P.sh. Adem Kamberi Fejzallarve.. etj.

Por përsëri, në regjistrat e Gjendjes Civile dhe në dokumente ka përplasje dhe emërtime sipas dëshirës. Në disa dokumente të Kamberit, Bajramit, etj, gjen mbiemrin “Abdiu”, “Avdiu”, “Avdia”, kur gjyshi, cituar më

sipër, e ka të regjistruar Avdi. Rrjedhimisht ne duhet të mbajmë mbiemrin "Avdia".

Edhe për mbiemrin e parë tonin, ose atë që mbajnë aktualisht kushërinjtë tanë nuk kemi unifikim. I pari ku kemi marrë mbiemrin quhej "Fejz-a" e jo "Fejz-o" apo "Fejz-u", e rrjedhimisht ne duhet të mbanim mbiemrin "Fejza-llar". Këtu disa e përdorin "Fejzollar", disa "Fejzallar" e disa "Fejzullar", por të gjithë jemi njerëz të të njëjtit fis.

BAJRAM AVDI FEJZALLARI

Bajrami ka lindur në lagjen Canaj, të katundit Bicaj më 9 maj 1928. Ai ishte fëmija më i vogël i Avdisë dhe vinte i katërti në familje pas vëllait Kamber dhe motrave Nurie dhe Zare. Ai u rrit në një familje me zakone malësore, jo patriarkale të theksuara, por me moral të lartë, me tradita patriotike dhe me besë e burrëri. Ai pati fatin që jetoi me vëllain e madh Kamberin, i cili duke qenë nëpunës i hershëm dhe me përvojë, duke qenë më i madh në moshë, pati mundësi t'i jepte "dorën" e të nisë hapat e parë në jetë. Fitoi shumë se jetoi në një kohë me xhaxhain e tij Zyberin, njeri i mençur e i kujdesshëm, i cili e pajisi me dije e shkollim, aq sa ishte dhe i vëmendshëm ta mbante të lidhur me ngjarjet dhe njerëzit patriot të fisit Fejzallar dhe të mbarë krahinës së Lumës. Bajrami kishte një baba shumë të ndershëm e punëtor. Megjithëse ai jetoi shumë pak kohë me Bajramin dhe atë kohë ishte i sëmurë, la prapa amanetin që "djalin e vogël të ma bëni me shkollë", amanet që xhaxhai Zyberi dhe vëllai Kamberi e çuan deri në fund. Qëlloi i shpërblyer se jo vetëm piu qumështin, por mori edukatën e ngrohtësinë, dashurinë për jetën, familjen, njerëzit e vendin, kurajën e vendosmërinë për t'i çuar gjërat deri në fund, nga nëna e tij Rahime, të cilën e deshi aq shumë, por nuk u çmall asnjëherë me atë.

Nga padurimi për ta shkolluar dhe duke parë aftësitë e rralla intelektuale të Bajramit, atë e futën në shkollë fillore në moshën 5-vjeçare. Shkollën fillore e mbaroi në moshën 10 vjeç me të gjitha notat 1, shkëlqyeshëm (shih më poshtë kujtimet e Mësuesit të Merituar Shuaip Halili).

Për të krijuar një tablo të jetës dhe veprimtarisë së Bajramit, si fillim po lexojmë një autobiografi të tijën, e paraqitur personalisht para institucioneve shtetërore në vitin 1959 :
"Unë, Bajram Avdi Fejzollari, kam lindur në vitin 1926 në katundin Bicaj të rrethit të Kukësit.
(Mbi datën e saktë të lindjes së Bajramit, vëllai i tij Kamberi, në shënimet mbi jetën e tij shkruan dhe këtë fragment për Bajramin: "Bajrami, vëllai i vogël, kishte kryer shkollën fillore dhe kish dalë me nota të mira. Me zotësinë e tij kishte fituar bursën dhe vazhdonte Shkollën Normale të Elbasanit që nga shtatori 1938. Një telash me pati nxjerrë në plotësimin e dokumentave, sepse kish filluar shkollën 5 vjeç, e kur mbaroj filloren ishte 10 vjeç. Për të vazhduar shkollën e mesme duhej të ishe 13 vjeç. Duke qenë i detyruar, gjeta rastin e shkova në Komunën Bicaj, bëra korrigjimin nga 9 Maj 1928 në 9 Maj 1926, duke i lëshuar Letër - Njoftimi me firmën time. Ky veprim nuk u shikua imtësishëm nga arsimi dhe u pranua").
Rrjedh nga një familje fshatar i varfër. Prindërit e mijë kanë vdekur para vitit 1939.
Mbasi mbarova shkollën fillore më 1938 kam ndjekur me bursë mësimet në Shkollën Normale të Elbasanit, deri në Maj të vitit 1943. Që në vitin 1942 jam bërë anëtar i Rinisë Komuniste Shqiptare dhe kam qenë përgjegjës i një grupi edukativ deri në Maj 1943, ku me mbylljen e shkollës kam vajtur në Lumë. Këtu u caktova përgjegjës i rinisë në krahinën e Lumës dhe në Shtator 1943 dola partizan me çetën e Lumës, ku isha përgjegjës rinie në çetë. Në ushtrinë nacionalçlirimtare kam qëndruar deri në nëntor të vitit 1944 dhe kam qenë zëvendëskomisar e komisar kompanie, përgjegjës rinie në batalion në Br24S.
Në nëntor të vitit 1944 u lirova nga ushtria dhe u dërgova në Prefekturën e Kukësit si anëtar i Komitetit Qarkor të Rinisë Komuniste. Këtu kam qëndruar deri në fund të vitit 1945.
Në vitin 1946 u lejova të ndjek studimet e mësimet në gjimnazin e Gjirokastrës, të cilat i mbarova në vitin 1947. Këtu kam qenë anëtar i komitetit qarkor të rinisë komuniste të Gjirokastrës.
Me mbarimin e shkollës më doli bursa për në BRRS. Në vitin 1952 mbarova Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Leningradit.

Nga viti 1952 deri në vitin 1955 kam punuar si pedagog e më vonë si Zv/Drejtor i Shkollës së Partisë.
Në fillim të vitit 1955 u caktova si Instruktor në Drejtorinë e Agit – Propit të KQ të PPSH.
Nga viti 1956 deri në Maj të vitit 1959 kam qenë shef seksioni e tani punoj si zv/kryeredaktor i revistës "Rruga e Partisë".
Anëtar i PKSH (sot PPSH) jam bërë në shtator të vitit 1943 në organizatën e partisë së Lumës. Nga ushtria nacionalçlirimtare nuk jam shkëputur asnjëherë. Nuk kam asnjë nga të afërmit e mijë me armikun. Mbaj Medaljen e Kujtimit, të Trimërisë dhe të Çlirimit si dhe Urdhrin e Punës së Klasit të Tretë.
Në vitin 1953 jam martuar me Violeta Bakallin, e cila është anëtare e PPSH-së. Kam në ngarkim dy fëmijë, Yllka Bajram Fejzollari dhe Mira Bajram Fejzollari".

BAJRAMI për veten, BAJRAMIN :



Nuk ka më mirë kur shënimet mbi jetën lihen me dorën e vet personit. Në vitin 1980 Bajrami është munduar të shënoj diçka mbi jetën e tij, por ai nuk arriti këtë synim, sepse në 12 maj 1981 ai u nda nga jeta. Gjithsesi unë do të mundohem të pasqyroj me korrektësi atë çfarë ai shkroi dhe pasqyroi :
"Kam lindur në fshatin Bicaj të Krahinës së Lumës. Është një fshat i bukur, jo se e them unë. Kush nuk e do fshatin e vet. Edhe gurët janë të shenjtë, gur që të mbajnë ngrohtë, gurë që të mbrojnë nga çdo armik. Edhe kullat ndërtohen po me gurë të mëdhenj, e secila kullë është dhe një fortesë. Bicaj, ndryshe nga disa fshatra të tjerë të Malësisë është një fshat jo i vogël, i shtrirë në një pllajë. Nga lindja i rrethuar nga mali i Gjallicës, në krahun e djathtë Shkallë e Keqe dhe bjeshkët e Kolesjanit e të Lusnës në jug, e që ngrihen shkallë shkallë deri në Kalanë

e Dodës. Nga perëndimi, përtej malit të Gabricës është Drini i Zi e matanë Drinit, lart rrjedhës, fshati Arrën e më poshtë Surroj e fshatrat e tjerë. Në veri shtrihet rrafshi i Lumës, që fillon nga fshati Kolesjan e arrin deri në Shtiqën e në Lumë, fshat që është mu në breg të lumit të Lumës, prej të cilit ka marrë emrin e gjithë krahina.

Luma është një krahinë jo e vogël. Ajo shtrihet nga përroi Poslishtit në veri, përfshirë Qafën e Zhurit dhe arrin deri në Veleshicë, poshtë Kalasë së Dodës, që kufizon Lumën me Dibrën. Megjithë veçoritë specifike të çdo zone të saj, kjo krahinë ka zakone të përbashkëta, veshje të përafërt, lidhin krushqi me njëri tjetrin, kalojnë gëzime e hidhërime e për më tepër kurrë nuk kanë qenë ndarë në raste rreziku nga armiqtë e jashtëm. Në këto raste të gjithë lumjanët bashkoheshin në një. Bëhej "Mbledhja e Dheut", lidhej besa, pajtoheshin gjaqet e të gjithë, i madh e i vogël, 7 e 70, në mbrojtje të lirisë së Atdheut. Për vetë pozitën gjeografike, mundet edhe për arsye të tjera, Bicaj është caktuar qendër administrative e krahinës së Lumës. Më parë pushtuesit osmanë patën caktuar Kalanë e Dodës, për të zotëruar si Lumën edhe Dibrën, por Luma ishte një kockë e fortë. Ajo u nxori shumë telashe dhe u detyruan ta zhvendosin qendrën në Bicaj. Caktuan Kaimekan që varej nga Prizreni, ndërtuan Kushllonë (kështjellën) në kodër të Osmane dhe vendosën garnizonin e tyre. Por pushtuesit prapë se prapë nuk po e ndjenin veten aspak të qetë. Bicajt u bë një vatër, shkëndijat e së cilës përhapeshin në të katër anët e krahinës e rritën një zjarr të madh që digjte e përvëlonte pushtuesit. Historikisht dihen përleshjet e luftërat e shumta të njëpasnjëshme që kanë bërë lumjanët për të shporrë zaptuesit nga tokat e tyre. Për këto luftëra janë thurur shumë këngë që kanë kaluar nga brezi në brez deri në ditët tona.

Nga mesi i shekullit të 19-të u rrit rezistenca e malësorëve për të mos i paguar Sulltanit haraçe dhe për të mos i dhënë nizamë duke arritur deri në kryengritje të armatosur. Në njërën ndër këngët thuhet :

Çfarë kanë kodrat që gjëmojnë
Dy Zyberat po luftojnë
Zyber Tema e Zyber Fejza
Mos me vesh petkat e zeza".

Malësorët e revoltuar dëbuan nga Bicaj ushtarët turq dhe Kajmekani për të shpëtuar kokën u strehua në njërën nga shtëpitë e Shejlerëve të Nangve. Zyber Tema e Zyber Fejza u vranë, por trimat e tjerë duke vazhduar luftën asgjësuan të gjithë forcat pushtuese duke kapur edhe Kajmekanin të gjallë. Lidhur me këtë episod është kënga :

"Sul Sinani trim budallë
Msheli (mbylli) kajmekanin n'hambar".

Lëvizja për të mos i dhënë nizamë Sulltanit ishte ndër format e rezistencës, e luftës për liri e pavarësi, por edhe shërbimi në ushtri ishte në kushte shumë të rënda, aq i zgjatur e aq larg vendit sa shumë prej nizamëve nuk ktheheshin, por edhe ata që ktheheshin ishin shumë të dërmuar e të rraskapitur.

Shumë nuse të reja mplakeshin duke pritur tu ktheheshin burrat nga nizamllëku. Në një këngë thuhej :

O moj Dudi, e mjera Dudi
A e din që do të shkoj ushtar.
Hajt bre burrë se po vij me ty
S'është kjo punë për grani.

Kaluan shtatë vjet dhe i shoqi nuk po kthehej. Më në fund arritën në fshat dy shok të tij që ishin nisur së bashku nizamë. Dudia i pyet për të shoqin, por ata ia pritën :

Oh moj Dudi e mjera Dudi
Yt shoq ka ndreq një çifteli
Dhe emrin ia ka vënë Dudi
Tash shetit qarshi më qarshi.

Dudinë e pushtoi një zemërim i papërmbajtur që të shoqin e kishte pritur aq gjatë, duke qëndruar e vetme, duke i ruajtur shtëpi e gjallni e shpërthej :

Po s'ta dogja këtë shtëpi
Po s'ta shkretova atë gjallni
Po s'të martova atë kojshi
Mos më thënshin Dudi.

Po në këtë çast dëgjon një këngë dhe tingujt e çiftelisë. E njohu. Ishte i shoqi.

Shpejton, hap arkën e kërkon një kokërr mollë, por nuk ka e Dudia gjithë zemërim mallkon që të thahen të gjitha pemët e të mos bëjnë asnjë kokërr, kur nuk iu ndodh një kokërr për të gëzuar të shoqin.
Gjendja e malësorëve nën zgjedhën osmane ishte shumë e rëndë. Skamja, haraçet, grabitjet, marrja nizamë e djemve dhe burrave në moshën më të mirë, jo vetëm i ndante këta nga prindërit, gratë e fëmijët e tyre, por i linte edhe tokat shkretë.
Të gjitha këto që po i shkruaj mi ka treguar xhaxhai, mixha Zyber. Ai gjithnjë më thoshte : "Shkruaj bir këto që po të tregoj se harrohen e duhet ti dish ti dhe ato që vijnë pas teje". Unë nuk shkruaja, por e dëgjoja me kureshtje e vëmendje të madhe. Më pëlqenin këto tregime të xhaxhait e në shtëpi kur ishim vetëm të dy, aty pranë vatrës, i lutesha të më tregonte përsëri nga ato që kishte përjetuar.
Një mbrëmje më thotë : "Ti mor bir nuk e di dhe në shkollë hala nuk u kanë fol për Luftën e Kaçanikut". Kjo ka qenë një luftë e madhe dhe nisja është nga Luma, e ma mirë me thanë, nga Bicajt. Ja si ka ndodh – e vazhdoi - Turqit arrestojnë e mbyllin në kushlla Avdi Sadikun, që njihej si kundërshtar i tyre. Shtëpinë ti e di ku e ka. Poshtë kushllasë e nga shtëpia e tij nuk të shpëton asnjë lëvizje në katund. Shtëpia është e ndërtuar me gur, mur të trashë dhe e rrethuar me avlli. Në shtëpi, pas arrestimit të Avdisë, mbeti vetëm motra e tij. Ajo priste t'i lirohej vëllai, por nga dita në ditë shpresa po i fikej. Atëherë kjo vajzë trime vendosi atë që vetëm një burrë mund ta bënte. Mbushi pushkën, doli në frëngji dhe shtinte mbi ushtarët turq që kalonin rrugëve të katundit. Fshatarët hala nuk po përmendeshin. Ky qëndrim e zemëroi shumë vajzën dhe u dërgoi fjalë burrave të fshatit se do të shtinte mbi ata nëse nuk kapnin pushkët. Turqit në fillim nuk e vlerësuan këtë që po bënte vajza, i dërguan asaj fjalë që të ndërpriste të shtimet se pastaj do të qëllonin me top shtëpinë e saj. E në të vërtetë kështu bënë. Qëlluan me top, por krisma e topit qe si kushtrim për fshatarët e Bicaj. Të gjithë burrat, të gjithë ata që kishin vënë pushkën krahut u sulën drejt Kushllosë. Nuk u bë ndonjë luftë e madhe se shumë shpejt u çarmatosën ushtarët turq. Kushllaja u mor. Ky lajm u përhap në të gjithë Lumën. Qindra vetë morën armët dhe u mblodhën në Bicaj e prej këtu në Kosovë e në Kaçanik, ku mor bir është

bërë një luftë shumë e madhe kundër Turgut Pashës, që donte të shtronte shqiptarët e që thoshin se edhe mbas atij kuvendi që u bë në Prizren, Sulltani donte me i dhanë tokat tona serbit. Unë atëherë nuk mund të kuptoja se ku ishin shkaqet e kësaj lëvizje, se Avdi Sadiku dhe qëndresa e së motrës ishin vetëm sebepe e po ziente kazani jo vetëm në Lumë, Kosovë e Dibër, po në të gjithë Shqipërinë.
Si çdo fëmijë dhe unë isha kureshtar. Në shtëpinë tonë prej tre katesh nuk lija qoshe pa parë e pa shkelë, që nga oda e zjarrit në katin e parë, te oda e nënës Dullës në katin e tretë e deri në tavan. Në tavan gjeta shumë gjëra, si këpucë ushtarësh, çizme, çanta, rripa, por ajo që më tërhoqi më shumë vëmendjen ishte një shpatë e futur në këllëf. Ishte një shpatë e madhe dhe shumë e rëndë për mua. Me shumë mundim e nxora nga këllëfi, por me njërën dorë nuk e ngrija dot, por me të dyja me zor. E lashë shpatën aty ku e gjeta dhe zbrita poshtë, por më zuri syri në njërën nga dhomat se mbi trarë të djegur ishin vënë trarë të tjerë. Xhaxhait nuk i thashë për shpatën, por e pyeta për trarët. “Mor bir – më tha ai – jo vetëm shtëpia jonë, por shtëpitë e gjithë katundit janë djegë shumë herë nga turqit e serbët. Vetëm nga serbët shtëpia jonë është djegë tre herë. Kur vinin serbët në Lumë ata vinin me aq shumë forca sa ishte e pamundur tu bëje ballë në fushë të hapët. Duhesh me vepru me mend. E vetmja rrugë ishte tërheqja, tërheqja e grave, fëmijëve, pleqve e gjësë së gjallë dhe bereqetit. Strehoheshin të gjithë në katundet e Anës së Eperme, deri në Reç, Dardhë e Lurë. Burrat e djemtë lumjanë e tërhiqnin hasmin në gryka, nga fillonte dhe shfarosja e tyre. Kështu ka ndodhur edhe atëherë kur ishte lufta në Ballkan. Kur ndodhi ajo kasaphanë te Ura e Shejës. Serbët nuk patën mundësi as të çanin përpara e as të ktheheshin prapa. Dhe kënga ka përjetësuar e ka ardhur deri në ditët tona :

Djemtë e Lumës hiq s’kanë dert
Nga një luftë e bëjnë përvjet
Luftë me kral e luftë me mbret.

Kuptohet përse Luma qëndroi gjithnjë në krahun e forcave demokratike e përparimtare. Nën drejtimin e patriotëve të njohur si Islam Spahia, etj u bashkuan kundër forcave reaksionare e tradhtare si Esat Toptani, Ahmet

Zogolli e kundër parisë reaksionare të krahinës. Në Lumë gjeti mbështetje të fuqishme Bajram Curri. Në Lumë me kërkesën e forcave përparimtare e të popullit, pranoi të vërë kandidaturën e tij për deputet Avni Rustemi, duke u zgjedhur deputet i Prefekturës së Kosovës. Malësorët kishin thënë: "Duam deputet atë djalin që ka vra në Paris tradhtarin Esat Toptani. Dhe për Avni Rustemin në Lumë këndohej kënga :

O Avni Rustemi
Lumi na që t'kemi.

Ja pse Luma edhe gjatë viteve të luftës nacionalçlirimtare rroku armët kundër pushtuesve nazistë e tradhtarëve të vendit. Tradita kaloi nga një brez në tjetrin. Bicaj ishte dhe mbeti vatra e luftërave për liri në krahinë. Ky ishte fshati ku linda dhe kalova vitet e fëmijërisë.

Vitet e shkollës në fshat. Babën nuk e mbaj mend, ose të themi fare pak, ashtu si hije, të shtrirë në shtrat ku dergjej nga një sëmundje e rëndë. Për jetën e babait mësova jo aq nga nëna sa nga xhaxhai e nëna e Dullës, e cila për mua mbeti nënë e gjyshe.
Babai gjithë jetën e tij e kishte kaluar si bari e bujk. Për të siguruar bukën e gojës ai ishte detyruar në moshë relativisht të re të linte gruan e dy fëmijët e parë e të pajtohet si bari dhensh tek një pronar që zotëronte jo qindra por mijëra krerë dhen. Sipas marrëveshjes bariu i pajtuar do të punonte pesë apo dhjetë vjet. Si shpërblim do të kishte ushqimin për vete, një sasi leshi, gjalpi, gjize e djathi. Kjo ishte gjithë paga e tij. Vetëm në mbarim të kohës së pajtimit bariu kishte të drejtë të merrte disa kokë dele, sipas kohës që kishte punuar. Puna dhe jeta e bariut ishte shumë e rëndë. Në shi e në borë, kurdoherë pranë deleve. Verës i kullosnin në bjeshkë, por dimrit kur bjeshka mbulohej me borë, detyroheshin të shtegtonin. Dhe kështu nga Fusha e Korabit barinjtë i shtegtonin ato deri në Fushat e Selanikut dhe vetëm kur shkrinte bora i sillnin prapë. Vuajtjet më të mëdha i kishte gruaja te shtëpia e bariut. Ajo do të mbante shtëpinë, do të administronte atë ekonomi që kishte dhe do të rriste fëmijët. Jeta e saj ishte gjithë lot dhe ja si shprehet gjendja e saj shpirtërore në këngë :

Moj fusha e Korabit
Qysh na erdhe hakut
.....
Kur po shkoj me ra
Unë plasi tuj qa.

Por ajo e di edhe jetën e vështirë të të shoqit, që në shi e në borë rri me delet :

Kjo ferexhe e gjatë
Qysh ti kputi krahtë
Kjo ferexhe shkurtër
Qysh ti kalbi gjunjët

dhe më tej :

Mblidhe një krah krande
bëje darkën tande.

Kështu pas 10 vjetësh si bari babai ishte kthyer më në fund në fshat, e si tregonte xhaxhai, kishte sjellë 30 krerë dele. Kjo ishte pasuri e vogël, megjithëse e fituar për shumë vjet e me shumë mund. Tani do të kishte qumësht për të nxjerrë pak gjalpë, por së paku do të kishte dhallë e shëllirë të bardhë. Do të kishte disa kile lesh për triko e ndonjë shtrojë. Jetesa e familjes do të bëhej më e mirë. Por duhej bukë. Bukë! E buka bëhej në arë e ara do punuar. Ja pse babai ishte larguar diçka nga delet dhe i ishte vënë punës së bujkut në ato copë ara që kishte. Delet i kishte thënë xhaxhait t'i kishte kujdes, për t'i ruajtur t'i ruai djali. Djali, vëllai im i madh në atë kohë ishte 12 vjeç dhe ishte një bari i vogël, një bari i mirë. Po ja, në fshatin tonë kishte shumë vite që ishte hapur shkolla fillore dhe atë e ndiqnin mjaft fëmijë, por jo të gjithë fëmijët e fshatit. Shumë baballarë nuk e vlerësonin shkollën, mendonin se nuk del gjë prej saj dhe kryesorja në jetë ishte kujdesi për ekonominë e shtëpisë, për delet e tokën. "Të kemi për të ngrënë. Të mos vdesim urie" – ky ishte shqetësimi. Babai nuk e linte vëllain të shkonte në shkollë, megjithëse xhaxhai i kishte thënë : "Me delet do të shkoj unë, djali të shkoj në shkollë". Por ai nuk bindej. Me sa mund i kishte vënë ato dele e nuk mund t'i linte shkretë. Por punët rrodhën kundër mendimit, dëshirës dhe vullnetit të tij.

Shteti shqiptar, ndonëse mbante karakter klasor, kishte nevojë për njerëz të shkolluar në administratë e në fusha të ndryshme të veprimtarisë. Aty ku ishin hapur shkolla fëmijët ishin të detyruar t'i ndiqnin ato. Babanë e kishin gjobitur disa herë e burgosur 3 ditë. Ja këto ishin rrethanat që vëllai arriti të ndjekë shkollën. Nga mosha, për më tepër nga etja për dije ai e mbaroj shkollën me rezultate të shkëlqyera.
Si disa të rinj të tjerë edhe ky pati fatin të futet në punë shteti. U caktua në PTT Bicaj si shpërndarës. Punë shumë e mirë. Rroga jo e keqe. Tani me rrogën e vëllait dhe me atë pak bereqet që do të merrej nga toka buka e vitit do të sigurohej për të gjithë familjen, e cila përbëhej nga 8 veta. Do të kishte edhe kripë, vajguri e sapun. Edhe ndonjë copë beze mund të blihej. Çfarë kthese në jetë!
E gjithë kjo ishte një kthesë edhe në mentalitetin e babait. Nisi ta vlerësoj ndryshe shkollën, por prej tokës e deleve nuk u nda dhe nuk lejoi të ndahet asnjë prej fëmijëve. "Punës së shtetit nuk i dihet – thoshte – toka të mban".
Vëllain e morën ushtar. Rroga që merrte ai tani nuk ishte më. Duhej përballuar jetesa me atë pak bereqet që merrej duke punuar ato copë ara që kishim dhe nga ato krerë dele. Jetesa prapë u bë e vështirë. As për 6 muaj nuk bëhej buka për familjen. Prodhimet që merrnim nga delet dhe një lopë nuk t'i merrte kush. Buka! Buka ishte problemi kryesor e ne vuanim për bukë. Por gjendja u bë edhe më e rëndë me vdekjen e papritur të babait. Vëllait që ishte ushtar i dhanë leje për vdekjen e babait dhe pas dy muajsh e liruan fare si për "pa ndihmës". Tani në shtëpi kishin mbetur dy pleqtë, nëna e sëmurë, dy motrat dhe unë.
Erdhi vëllai në fshat. Vendi i punës në PTT ishte zënë. Me bujqësi nuk ishte marrë që kur kishte mbaruar shkollën fillore. Nuk kish as ndonjë që të ndërhynte e ta rregullonte. Megjithatë u gjet zgjidhja.
Sekretari i Komunës, Hilë Rasku, i propozon të bëhej sekretar privat i tij dhe si shpërblim do t'i jepte një gjysmë napoloni në muaj. Vëllai pranoj. Do të sigurohej së paku buka. Sekretari Hilë qëndronte me muaj në Shkodër dhe gjithë punën e zyrës e bënte vëllai, Kamberi. Edhe rrogën ia dërgonte me postë. Kur vinte në Bicaj, ai vinte sa për "kontroll" e për të rënë në sy.

Në këto rrethana e në këtë gjendje familjare unë shkova në shkollë. Edhe babai para se të vdiste kishte pas thënë : "Këtë të voglin mos ma lini pa shkollë". Shkollën e mora me gëzim si të gjithë fëmijët. Nëna e sëmurë më rregulloi një çantë me beze për abetaren dhe dërrasën e zezë dhe dy fletore që mi bleu vëllai. Me mësime nisa të shkoj mirë. Në tabelën e zezë mësuesi gjithnjë më vinte njësh e rrallëherë dysh. Edhe nëna mësoi se njëshi ishte nota më e mirë, por ajo nuk e njihte si njësh, por si kërrabë. Kur e shikonte "kërrabën" në tabelë, asaj i shkëlqenin sytë nga gëzimi. Më merrte afër, më përkëdhelte, më puthte e ashtu e sëmurë hiqej me zor deri te arka e rrobave të saj e merrte andej një kokërr sheqer dhe ma jepte. Sheqer! Çfarë gëzimi!

Shkolla më hapi një botë të re, krejt të panjohur. Shikoja klasën ku bënim mësim. Sa e bukur! Në mur ishin varur shumë harta. Harta e Shqipërisë dhe e botës, por atëherë i shikoja pa i kuptuar. Më tepër më pëlqenin kafshët e egra, peshqit, shpendët – të gjitha me ngjyra të shumëllojshme. Mësuesi më kishte vënë në bankë të parë. Isha i imët. E shikoja mësuesin kur bënte apelin, kur vinte mungesat ose kur pyeste në mësim e na vinte notat. Unë zgjasja kokën e përpiqesha të shihja. Sa dëshiroja të bëhesha mësues.

Shpesh shkoja te shtëpia e nunit, atij që më kishte marrë flokët. E shoqja e nunit ishte një plakë e shëndoshë, e ashpër por e dhimbshme, zemërmirë, si një nënë e vërtetë. Më dërgonte te dhoma e zjarrit, merrte kusinë e qumështit, më bënte përshesh dhe më thoshte : "Ha bir, haje krejt". Pasi haja dilja në kopsht. Nuni kishte një kopsht të mirë me pemë e zarzavate. Mana kishim edhe në shtëpinë tonë, por unë merrja kumbulla e ngaqë nuk më durohej, këpusja edhe ndonjë kastravec. Futesha në dhomë, aty ku ishte nuni, i cili në të shumtën grinte duhan. Një ditë më mori e më dërgojë afër murit ku nxori një kuti. E hapi e prej saj nxori një tufë flokësh e më tha : "Ja këto janë flokët e tua. Ti ka prerë nuni kur ke qenë 3 vjeç. I sheh sa të bardha dhe sa të buta. Edhe tani që po rritesh kështu i ke. Të shkëlqejnë". Unë e doja shumë nunin Rasim Ram Ramollarin. Nuni kishte gjendje të mirë ekonomike. Kishte tokë të mjaftueshme e pjesën më të madhe nënujë. Me bereqetin që merrte siguronte pa frikë bukën e vitit. Veç bujqësisë ai merrej edhe me farkëtari

ku rregullonte vegla bujqësore e gjëra të tjera shtëpiake për fshatarët. Haku kryesisht ishte në natyrë e shpesh merrej pas të vjelave".
Këtu ndërpriten shënimet e tij për veten dhe familjen. Më 12 maj 1981 u shuajt edhe vetë fizikisht duke lënë prapa dhimbje, pikëllim e boshllëk të madh.
Me mbarimin e shkollës fillore në fshatin e tij Bicaj, me ndihmesën e xhaxhait Zyber, Bajrami konkurroi dhe fitoi bursë për tu arsimuar ne Shkollën normale të Elbasanit. Bursë me këtë rast fituan dhe Zylfi Saliu nga Shtiqni dhe Maliq Gashi nga fshati Nangë. Vëllai i Bajramit, Kamberi, i shoqëroi të tre në Elbasan, ku bëri një fotografi mes tyre i veshur me rroba tradicionale lumjane. Kamberi e kujtonte shpesh këtë fotografi të humbur, të cilën ia kishte dhënë përkohësisht Maliq Gashit dhe i kishte mbetur shumë merak. Unë jam interesuar te shoqja dhe vajza e tij, por pa rezultat.
Shkollën Normale e filloi në vitin 1938. Këtu filloj një jetë të re studentore dhe politike. Pas pushtimit të vendit nga Italia fashiste u njoh dhe u lidh me lëvizjen komuniste e çlirimtare duke u përfshirë me grupe të rinjsh përparimtarë të kohës.
Në Normale të Elbasanit ka pasur rezultate shumë të mira. Ai jo vetëm studionte por nuk i humbi kurrë lidhjet me njerëzit e tij, me vendlindjen e shtrenjtë, fshatin Bicaj e krahinën e Lumës.



Bajrami në Normale të Elbasanit.
Këtu filloj të formohej si i ri revolucionar, me bindje përparimtare.
Këtu filloj ta urrej fashizmin dhe kauza kryesore e tij ishte dhe mbeti çlirimi i vendit nga okupatorët.
Këtu u zgjuan instinktet patriotike të Zyber Fezës së "Reformave të Tanzimatit" e Zyber Bajramit të "Luftës së Kaçanikut'.
Këtu i lindi dëshira çlirimtare për tu bashkuar me "Fejzallarët" Rushit e Ibish Milaimi dhe babës tyre patriot Milaim Rushiti.
Këtu filloi jeta e tij e vërtetë.

Bajrami nxënës në Shkollën Normale, Elbasan, 1938-1943

MINISTRIA E ARSIMIT

SHKOLLA NORMALE — ELBASAN

Nr. i rendit 1021
Klasa I e ulët

Vjeti shkollorë 1938-1939

LIBREZE SHKOLLORE

nxënësit Bajram Abdin
i bërë i Oldedut lindur në Elbasan
(prefek.) me 27/I/1922 mbushurse për herë të parë në
klasën e parë të kursit të ulët në mbështetje
të Vendimit
Elbasan, me 11/VIII/1938

DREJTORI:

Tekstet e paguarat (1)	Çfytë ku ashtë kryer pagesa	Nr. i dorës	Data	Shuma	Nënshkrimi i Drejtorit
Nëndrëmje					
Nëpërjashtë	Kat. I				
	Kat. II				

(1) Me rast pezullimesh tekstesh e pagesash tregohen arsyet.



VJETI SHKOLLUER 1938-1939

LËNDËT E MËSIMIT	NOTAT E TRIMUJSHIT I	NOTAT E TRIMUJSHIT II	NOTAT E TRIMUJSHIT III DHE AT O VJETORE
Gjuhë shqipe	(8) tetë	(8) tetë	(8) tetë
Gjuhë latine	–	–	–
Gjuhë italiane	(3) shtatë	(9) nëntë	(9) nëntë
Gjuhë	–	–	–
Histori	(7) tetë	(8) tetë	(8) tetë
Gjeografi	(8) tetë	(9) tetë	(8) tetë
Matematikë	(6) gjashtë	(6) gjashtë	(8) tetë
Fizikë e kimi	–	–	–
Shkencat natyrore	–	–	–
Higjenë	–	–	–
Edukatë morale e qytetare	(8) tetë	(9) nëntë	(9) nëntë
Mësimi i mësimit sociologjisë	–	–	–
Pedagogji	–	–	–
Praktikë pedagogjike	–	–	–
Dokumentim e praktikë	–	–	–
Vizatim	(7) shtatë	(9) nëntë	(9) nëntë
Bukurshkrim	–	–	–
Punë dore	–	–	–
Muzikë e kongë	(4) katër	(5) pesë	(5) pesë
Vepër muzikore	–	–	–
Edukatë fizike	–	(7) shtatë	(9) shtatë
Sjellja	(10) dhjetë	(10) dhjetë	(8) tetë
Mungesa: e mësimit	–	–	(3) tre
e punës	–	–	–
Nëndrëmjet: i Drejtorit			
i profesorëve			
i Këshillit			

Në mbështetje të natës se mësimit vendosi Bajram Abdin

Elbasan, me 11/VIII/1939

Anëtar

Librezë notash në Shkollën Normale Elbasan, viti i I-re, 1938 – 1939

Me mbylljen e Shkollës Normale të Elbasanit, pas demonstratës së madhe studentore më 1943 ai largohet në vendlindje dhe shtrin aktivitetin e tij në fillim në Prizren, aty ku banonte e punonte familjarisht vëllai i tij Kamberi dhe pastaj në krahinën e Lumës, duke u inkuadruar partizan i Çetës së Lumës që në shtator të vitit 1943.

Vëllai i tij Kamberi, në shënimet e tij, që mund t'i lexojmë më sipër, thekson se si në shtëpinë e tyre filluan të vijnë shokë ilegal të Bajramit, se si u njoh ai me lëvizjen komuniste e çlirimtare nëpërmjet Bajramit, si

arriti të krijojë besimin tek Ushtria e Kuqe e Stalinit dhe te partizanët që kishin rrokur armët dhe si i ndihmoi familjarisht ata që të kryenin me sukses misionin e tyre sublim.
Pas veprimtarisë në qytetin e Prizrenit, Bajrami e shtriu aktivitetin kryesor në krahinën e Lumës. Menjëherë u rreshtua në Çetën e Lumës dhe mori përsipër detyrën e Përgjegjësit të Rinisë në Çetë. Në këtë kohë ishin mobilizuar në luftë, po në këtë çetë partizane edhe dy kushërinjtë e tij vëllezër, Rushit dhe Ibish Milaim Fejzallari.
Rënia heroike e Ibishit në rrethim me mercenarët e Zyber Litës e hidhëroi pa masë, por i shtoi edhe më shumë urrejtjen për okupatorin dhe forcat për të mos e ndalur kurrë luftën çlirimtare.

Me shokët e Çetë së Lumës, 1943

Bajram Avdia me partizanët e Çetës së Lumës në vitet e luftës çlirimtare



Seria «B»

BILETA USHTARAKE
E OFICERIT NË REZERVË

Grada N/toger Lindur më 1926
Emri Bajram Në kat. (lagje) Bicaj
Atsija Abdi Rrethi (qyteti) Kukës
Mbiemri FEJZOLLARI Banues Tiranë
Kombësia Shqiptare Në kat. (lagja) Nr. 4
Nënshtetësia Rrethi (qyteti) Tiranë
Gjatësia e shtatit 1.65
Ngjyra e flokëve gështenjë
Ngjyra e syve gështenjë
Shenjë të veçantaSka
Shefi i Degës Ushtarake
Kol. Sami Selaci

Tiranë më 16-XI-1965

Kryerja e shërbimit ushtarak në ushtëritë e vjetra e të huaja, në Lëvizjen Nac. Çl dhe Ushtrinë Popullore

Në cilin repart ka shërbyer dhe me çfarë përgjegjësie	Koha Dita, muaji, viti
Në çetën e Lumës	Shtator 1943
Nëng. Rinis çetës	
Oficer ne Ushtri	Nëntor 1944

Bileta Ushtarake, ku vërteton se **Bajram Abdiu** ka qenë pjesëmarrës në Çetën e Lumës në Shtator 1943, si Përgjegjës Rinie i Çetës, me gradën N/toger dhe është larguar nga ushtria në Nëntor 1944.

Pas çlirimit të vendit nga pushtuesit antifashistë, për kontributin e dhënë në rreshtat e ushtrisë nacionalçlirimtare dhe për pjesëmarrjen me armë në dorë deri në çlirimin e plotë të vendit është nderuar me “Medaljen e Kujtimit” dhe me “Medaljen e Çlirimit”, të cilat i mban me nder edhe sot familja e tij.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Tiranë, më 8 Maj 1946

Nr. 1910

Certifikatë

2. BAJRAM ABDIU

Dekorohet me "Medaljen e Kujtimit"

me këtë motivacion:

"Zgjidh para datës 10 Korrik 1943 qe shënon formimin e Ushtërisë të Çlirimit Nacional-Çlirimtar Shqiptar, ka marrë pjesë pa ndërprerje deri në fund, me armë në ne aktivitet politik e organizimin në luftën kundër okupatorit dhe bashkëpunëtorëve për çlirimin e vendlindjes dhe të Popullit Shqiptar"

SEKRETARI: Sabolli

KRYETARI: Omeri

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

Tiranë, më 8 Maj 1946

Nr. 970

Certifikatë

Z. BAJRAM ABDIU

Dekorohet me „Medaljen e Çlirimit" me këtë motivacion:

"Ka marrë pjesë në ushtat e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare dhe me armë në dorë ka luftuar kundër okupatorit dhe bashkëpunëtorëve deri në çlirimin e plotë i Atdheut dhe te Popullit Shqiptar."

SEKRETARI (Sami Sabolli) Sabolli

PRESIDENTI (Dr. Omer Nishani) Dr. Nishani

Dekorimet mbi pjesëmarrjen në Luftën Antifashiste N-Çlirimtare me armë në dorë deri në çlirimin e plotë të vendit.

Siç është theksuar shkurtimisht mbi jetën e veprimtarisë së tij, në maj 1943 mbyllet Shkolla Normale e Elbasanit, duke i lënë në mes studimet e tij. Kështu që kërkoi leje për të mbaruar studimet dhe i rifilloi ato në gjimnazin e qytetit të Gjirokastrës.
Këtë shkollë e vazhdoi duke e ndërprerë punën si Përgjegjës Rinie në Krahinën e Lumës në Kukës.

Studentë në Gjirokastër

Bajram Avdia, i pari djathtas, nga aktiviteti politik në Gjirokastër, 1947

Me fillimin e studimeve në gjimnazin e Gjirokastrës në vitin 1946 të cilat i përfundoi në vitin 1947, ai vazhdoi dhe nuk e ndali veprimtarinë politike. Këtu u emërua si Sekretar Rinie i Qarkut të Gjirokastrës. Punoi me ndershmëri e përkushtim duke lënë mbresat më të mira.
Me mbarimin e studimeve në Gjirokastër i doli bursa për vazhdimin e tyre në Leningrad, në Universitetin Shtetëror, fakultetin e filozofisë. Atë e përfundoj me rezultate të shkëlqyera në vitin 1952.

Bajram Avdia, vitet e studimit në Universitet, Leningrad

ДИПЛОМ
С ОТЛИЧИЕМ
Ж № 503299

Настоящий диплом выдан Абдиу Байрам в том, что он в 1947 году поступил в Ленинградский Государственный орден Ленина Университет имени А.А. Жданова и в 1952 году окончил полный курс названного университета по специальности философия.

Решением Государственной экзаменационной комиссии от 30 июня 1952 г. Абдиу Байрам присвоена квалификация преподавателя диалектики и истории материализма и истории философии.

Ректор Университета Ленинград 1952 г.

Регистрационный № 1951



DIPLOMË
SHKËLQYESHËM

Nr. 5052 99

Kjo diplomë i jepet Abdiut Bajram ubi bashk se si m vitin 1947 hyri m Universitetin Shtetëror t Leningradit i drejtuar me Urdhërin e Lenintë dhe q ka mbaruar n A.A.Zhdanovit dhe m vitin 1952 mbaroi kursin e plotë t Shkëlqyeshëm m specialitetin Filozofi.

Me vendim t Komisionit shtetëror t provimeve datë 30 Qershor 1952 Abdiut Bajram i jepet shkalla e kualifikimit pedagog i materializmit dialektik dhe historik dhe i historisë s filozofisë.

Kryetari i Komisionit shtetëror t provimeve (Firma)

Rektori (Firma)

Vula Sekretari (Firma)

Leningrad 1952

Nr. regjistrimi 1951

Vërtetohet njësia m origjinalin
Drejtori Filialit t UT - Durrës
(Dorëshkrimi)

Diploma e Universitetit Shtetëror të Leningradit, kursi Filozofi, 1947 – 1952

Дипломную работу на тему: "Классовая борьба в Албании в период строительства социализма" защитил с оценкой - отлично.

Декан философского факультета Ленинградского Государственного ордена Ленина Университета имени А.А.Жданова
/ проф. А.Д.Александров /

Декан философского факультета
/ проф. В.П.Тугаринов /

Секретарь ф-та

г. Ленинград "7" III 1952 г.

Регистрационный лист № 1951

Приложение к диплому № 503299
ВЫПИСКА ИЗ ЗАЧЕТНОЙ ВЕДОМОСТИ
(без диплома недействительна)

Товарищ АБДИУ БАЙРАМ за время пребывания в Ленинградском Государственном ордена Ленина Университете им. А.А.Жданова на философском факультете сдал следующие дисциплины:

1. Основы марксизма-ленинизма - отлично.
2. Политическая экономия - отлично.
3. Диалектический и исторический материализм - отлично.
4. История философии - отлично.
5. Русский язык - отлично.
6. Древний язык (латинский) - отлично.
7. Физкультура - зачет.
8. Логика - отлично.
9. Психология - отлично.
10. Педагогика - отлично.
11. Теория и история эстетики - отлично.
12. Всеобщая история - отлично.
13. История СССР - отлично.
14. Основы современной физики - хорошо.
15. Основы современной математики - хорошо.
16. Биология и дарвинизм - отлично.
17. История русской литературы - отлично.
18. Спецсеминар по логике - зачет.
19. Спецсеминар по диалектическому и историческому материализму - зачет.

Товарищ АБДИУ БАЙРАМ сдал государственные экзамены по следующим дисциплинам:

1. Основы марксизма-ленинизма - отлично.
2. Диалектический и исторический материализм - отлично.
3. История философии - отлично.

Librezë notash e Universitetit Shtetëror të Leningradit, vetëm "Otliçno – shkëlqyeshëm" Kursi Filozofi, 1947 - 1952

ЛЕНИНГРАДСКИЙ УНИВЕРСИТЕТ № 3 (74)

Посланцы стран народной демократии

Зарубежные студенты в наших университетах

О пятерках и спорте

В ГОРЯЧИЕ ДНИ ЭКЗАМЕНОВ НЕ ЗАБЫВАЙТЕ О ФИЗИЧЕСКОЙ КУЛЬТУРЕ!

Изучая опыт производства

Студенты-механики работают в цехах с мастерами и рабочими

Gazeta e Universitetit Leningrad

Përkthimi shqip :

Gjatë netëve nuk shuhet drita në dhomën ku jeton studenti shqiptar Bajram Abdiu. Abdiu nuk kishte mbushur akoma 16 vjeç kur doli partizan. Djaloshi mori pjesë në shumë beteja kundër fashistëve italianë e gjermanë. Tani Abdiu studion në kursin e katërt filozofik. Në librezën e notave ka vetëm pesa. Mund të themi me bindje që edhe në këtë sezon do të marrë vetëm "shkëlqyeshëm".

Edhe pse ishte me studime në Leningrad ai mendonte për fuqizimin e Atdheut dhe kontributin material modest që duhet të japin të gjithë, pa përjashtim. Kjo përcillet edhe në një letër që i shkruante vëllait të tij Kamberit, bisedë e kryer edhe me kushëririn Rushit Milaim Fejzallari:



"Sot është një nder e një detyrë me shkri gjithshka kemi për Partinë. Unë kam mendue që t'i japim ndonjë copë arë , nga arat tona që kemi. Për këtë i kam shkrue edhe Rushitit. Kjo nuk është pale çka, por ashtë një shembull i mirë si për ty, ashtë edhe për ne të gjithë që kemi ndimue në këtë luftë. Prandaj bisedo dhe me Rushitin dhe më shkruej".

Me mbarimin me sukses të studimeve në fakultetin e Filozofisë së Universitetit Shtetëror të Leningradit, Bajrami u emërua në punë si pedagog dhe më vonë si zv/drejtor i Shkollës së Partisë "Vladimir Lenin", Tiranë.

Studentët e Shkollës së Partisë ku ishte pedagog dhe nëndrejtor Bajrami ruajnë kujtimet më të mira, jo vetëm si edukator e mësimdhënës model, por si një njeri të zgjuar, me vizion dhe i guximshëm në shfaqjen e pikëpamjeve të tija në të gjithë fushat ku ata ishin të interesuar.

Bajrami punoi më vonë si Instruktor i Agit – Propit të KQ-rë së PPSH-së.

Në vazhdim nga viti 1956 punoi si zv/kryeredaktor dhe kryeredaktor në revistën politike "Rruga e Partisë".

Një periudhe shume të gjatë punoi pranë aparatit të KQ-rë së PPSH, në Institutin e Studimeve marksiste – leniniste.

Në vitin 1953 ai u martua dhe krijoj familje me Violeta Bakallin nga Fieri. Familja e tyre ishte e shëndoshë, me tradita atdhetare dhe me vizion, kulturë e moral të lartë.

Violeta ishte vajza e madhe e Jani Bakallit, dëshmor i luftës nacional çlirimtare. Ajo së bashku me familjen jetonte në Fier. Me Violetën, Bajrami u njoh dhe u dashurua kur ishte student. Në atë kohë ajo ishte arsimtare në Zharrëz të Fierit. Halla e Violetës, Lenka, ishte bashkëshortja e kushëririt, Rushit Fejzallarit, gjë që ndikoi në njohjen dhe lidhjen e tyre. Ata u martuan në 11 janar 1953 dhe jetuan në Tiranë deri në 1974, kur Bajrami familjarisht u transferua në Durrës. Violeta punoi si arsimtare dhe drejtore në disa shkolla të Tiranës dhe më pas në Komitetin e Partisë dhe Komitetin Ekzekutiv në Tiranë dhe Durrës. Në gjithë institucionet ku ka punuar, ka lënë shembullin e mirë të një njeriu të zgjuar, të papërtuar dhe të ndershëm. Ajo është dekoruar me medalje dhe urdhra pune.

Violeta ka qenë një grua e qetë dhe e përmbajtur. Të krijonte përshtypjen e një gruaje të fortë dhe një plotësim për Bajramin. Kishte shumë energji dhe mprehtësi. Ishte sa e vendosur aq dhe e duruar. Asnjëherë nuk e ngrinte zërin, gjithmonë mundohej t'i zgjidhte problemet me qetësi. Ndjehej mirë kur vinin njerëz në shtëpi dhe mundohej t'i kënaqte të gjithë. Ajo të respektonte pa bujë dhe të bënte të ndiheshe mirë e rehat.

Violeta i donte dhe respektonte njerëzit e Bajramit dhe kështu i edukoi dhe vajzat. Bashkimi, djali i madh i Kamberit, jetoi disa vjet në shtëpinë e Bajramit, pasi ndiqte shkollën shtatëvjeçare në Tiranë. Edhe shkollimin e mëtejshëm ai e kreu në Tiranë. Violeta e quante Bashkimin djalin e saj dhe humbja e tij e trishtoi pa masë.

Bajrami në gjithçka që bëri dhe arriti, pati mbështetje në të gjitha drejtimet nga Violeta. Ajo i fali atij dashuri e kujdes gjatë gjithë jetës, fakt të cilin ai e vlerësonte shumë. Ajo ndërroi jetë në Tiranë më 5 mars 1995.

Bajram Avdiu, familjar shembullor. Në familje dhe nipi Bashkim Avdia

Fisi i Fejzollarëve ka qenë shumë i lidhur me njëri-tjetrin. Këtë nuk e vije re vetëm në rastet e nevojave apo detyrimeve ndaj njëri-tjetrit, në ngjarjet apo ditët e mira ose të trishtuara, por edhe në përditshmëri. Shpesh familjet kalonin pushimet bashkë, shkonin e vinin tek njëra-tjetra për qejf, organizonin dreka dhe darka, duke mbajtur gjallë dhe ushqyer lidhjen.
Fisi i Fejzollarëve në Tiranë, familjet e Bajramit, Rushitit, Rrahimit, mbanin kontakte shumë të shpeshta, marrëdhënie që është trashëguar edhe tek fëmijët e tyre. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për lidhjet e tyre me Fejzallarët e Kukësit pavarësisht largësisë në banim. Lidhja shpirtërore dhe jo vetëm e gjakut është e fuqishme dhe është ajo që e forcon atë. Letërkëmbimi i Kamberit me vajzat e Bajramit, Yllkën dhe Mirën, dhe lidhjet e takimet e shpeshta sot janë shembulli më i mirë i qëndrueshmërisë dhe trashëgimisë së një fisi.

Me familjen e të vëllait, Kamberit

Bajrami vinte shpesh në Kukës dhe kishte një mall të veçantë. Ai takonte shumë shokë e miq, bashkëluftëtarët e kohës së luftës çlirimtare dhe familje të shokëve dëshmorë. Kur vinte ai shumë shokë të Partisë e pushtetit në rreth kërkonin të qëndronin me atë dhe e respektonin pa masë. Ata e shoqëronin kudo ku ai shkonte dhe vizitat që kryente. Të gjithë kishin respekt për atë dhe ndjeheshin krenar në shoqërinë e tij. Ai ishte shumë i thjeshtë dhe kujdesej shumë që emri i tij dhe veprimtaria që kishte kryer të mos pasqyrohej në muze, stenda apo vende të hapura. “Me shumë urtësi e modesti më porositi : - Kujdes për ne që jemi. As emër as foto të mos ekspozohet, pasi kemi kohë”. (nga kujtimet e mësuesit të merituar Shuaip Halili).

Me Fitimtarët e Çlirimtarët në përvjetorë
Bajrami në foton e majtë i pari majtas. Në foton djathtas, Lenka është e dyta majtas, ulur.

Ditët më të këndshme të tij ishin ditët përkujtimore të datave historike, krijimi i çetës së Lumës apo Br24S. Në këto ditë takohej e çmallej me shokët e luftës dhe zhytej në kujtimet e asaj kohe. Asnjëherë në këto

raste nga ai nuk ndahej Lenka, si një “burrneshë lumjane” e jo thjeshtë si luftëtare e lirisë.



Bajrami me kolegët në aktivitete politiko – shoqërore

Me studentet e filialit Durrës

Në vitin 1974 Bajrami u transferua në Filialin e Shkollës së Partisë në qytetin e Durrësit. Atje u dallua si një mësimdhënës i mirë. Ai vazhdonte ta donte punën dhe t’i shërbente asaj me devotshmëri, kudo që ishte. Moto e tij ishte ndershmëria, korrektesa dhe përkushtimi.

Për rezultate të larta në punë në realizimin e treguesve të kohës dhe për përkushtimin në realizimin e detyrave, Bajrami disa herë është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH.

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Dekoron

Sh. BAJRAM ABDI FEJZOLLARI

Me UDHËRIN E PUNËS TË KL.III-të

PËR PUNË TË PALODHUR E TË MËRGOJSHËM NË KRYESIMIN E DISTRITIT SË GJIROKASTRËS PËR FORCIMIN E ORGANIZATAVE TË PARTISË.-

Tiranë me 25/4/1955

Dekoret Nr. 2041

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI KRYETARI



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË

PRESIDIUMI I KUVËNDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Lehoron

SHOKUN BAJRAM ABDI FEJZOLLARI

ME UDHËRIN "PËR SHËNIMIN TË SHQIPTARËVE GJYSËMËRAM DHE SHQIPËRIMIT" TË KLASËS II-të

PËR KONTRIBUTIN QË KA DHËNË NË LUFTËN PËR NDËRTIMIN SOCIALISHT TË VENDIT DHE PËR REALIZIMIN ME SUKSES TË DETYRAVE QË I JANË NGARKUAR.

Tiranë, më 9/5/1966

Dekoret Nr. 4143

PËR PRESIDIUMIN E KUVËNDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI KRYETARI

Dekorimet për devotshmëri në punë dhe rezultate të mira në realizimin e detyrave.

Duke vlerësuar lart punën e tij kërkimore – shkencore në shërbim të zhvillimit e përparimit të vendit, inteligjencën e rezultatet e punës disa vjeçare, Këshilli i Ministrave i RSH-së i jep me 26 shtator 1971 titullin shkencor "Profesor" në Filozofi.



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PËR TITULLIN SHKENCOR

PROFESOR

Nr. 134

Tiranë, 25. 9. 1971

KOMISIONI I LARTË I ATESTIMIT

ME VENDIM Nr. 16 DT. 27.4.1970

I JEP

SH. Bajram Avdi Avdia

TITULLIN SHKENCOR Profesor

KRYETARI I KOMISIONIT
(THOMA DELIANA)

Marrja nga Bajrami i titullit shkencor "**Profesor**" në Filozofi.

Gjendja e tij shëndetësore në fund të viteve '70 ishte jo e mirë. Ai u diagnostikua dhe vazhdoj kurimin në klinikat më të mira të vendit. Kujdesi si i personelit shëndetësor ashtu dhe i drejtuesve të Partisë e Pushtetit ishte në shkallë shumë të lartë, por ishte e pamundur të shmangeshin

pasojat fatale të sëmundjes. Kështu më 12 Maj 1981 ai u nda përgjithnjë nga familja, të afërmit dhe bashkëpunëtorët.

Në përcjellje për në banesën e fundit kishte një pjesëmarrje të paparë të popullit të rrethit të Durrësit, institucioneve të tij arsimore, organeve drejtuese të Partisë e Pushtetit në rreth, kolegë, shok e bashkëpunëtor të tij nga Tirana, miq shokë e të afërm nga rrethi i tij, Kukësi.

Qindra telegrame në familje nga të gjitha anët e vendit. Ditën e ndarjes arriti telegrami nga Nexhmije Hoxha, bashkëshorte e Enver Hoxhës, drejtoreshë e Institutit të Studimeve ML, ku Bajrami pati punuar si z/vëndës. Të nesërmen arriti në familje telegrami i Enver Hoxhës. Një vlerësim i madh për momentin.

Shumë telegrame, mbetet për tu theksuar, kishte nga Kukësi, çfarë tregonte sa dashuri e dhembshuri kishte ai për birin e vet të shtrenjtë, për atë që Kukësin nuk e ndante asnjëherë nga goja e mendja.

TELEGRAM

118- durres tirana / i 053 61 13/5 1445

shoqes violeta abdiu
durres

juve dhe familjve ju dergoj ngushëllimet me te thella per vdekjen e parakohshme te njëriut tuaj me te dashur shokut tone dhe anetar i devotshem i partise gjithe aftesite e tij i vuri ne sherbim te studimeve shoqerore e te pergatitjes ideopolitike te kuadrove te rinj.

enver hoxha

kl.-



TELEGRAM

198- durres tirana /8 344 202 12/5 1630-

violeta ibalia
lagje 6- rr maliq muca
nr 783- durres

e dashur violeta yllka e mira me hidherim te math moren vesh per vdekjen e babajt tuaj te shtrenjte shokut tone te dashur bajram ibalia ne shokut e shoqërt qe per shume vjet punuam bashk e per te do te ruajme kujtimet me te mira per bajramin si biri i popullit si antar i vjetër i devotshem i partise si komunist me zemer dhe botkuptim marksist-leninist kundohemi i dashur me shoke dhe i thjeshte ne jete kujtimi i tijë do te jete i paharuar nga te gjithe ata qe e kane njohur bajrami gjithe jeten e tije luftoi e punoi per triumfin e ideatove te partise e te popullit per ndertimin e shoqerise socialiste per edukimin e tufës stafrore te rinj te kesaj shoqërie jemi me te zisë te dhimbshme perpin gjithe kolektivin i institutit te studimeve marksiste - leniniste dhe una personalisht jemi ne zemer e mendje prane juve dhe keshtu do te jemi edhe ne te ardhmen per t'ju ndihmuar sa do pak dhimbjen per mungesen e bajramit njeriut me te dashur te familjes tuaj dua te shprehë bindjen se do te kaperceni kete humbje me durim e kurajo si familje komuniste-

ju perqafoj-
nexhmije hoxha-

kl783-

6-

Telegram ngushëllimi nga ENVER HOXHA

Telegram ngushëllimi nga NEXHMIJE HOXHA


12 TIRANE KUKES 01750 SI 28,4 910

SHOQES VIOLETA ABDIU
LAGJE NR 4 RUGA HAMID SHIJAKU
FALL NR 6 AP 10
TIRANE .

ME 5 MAJE NE OREN 10.00 NE KUKES ORGANIZOHET JUBILAR KUSHTUAR 60 VJETORIT TE LINDJES PROFESOR BAJRAM ABDIUT JU FTOJME FAMILJARSHTE JU DHE DY VAJZAT TUAJA .

SHOQATA E HISTORIANEVE DHE MUZEU HISTORIKE
KUKES .

KL4 6 10 3 10.00

Telegram nga Shoqata Historianëve, dhe Muzeu HistorikKukës

Telegrame të shumta nga shokë, miq e të afërm.

Kukësi dhe Bicajt nuk i harrojnë kurrë bijtë e tij, veçanërisht kur i shërbejnë me shpirt e devotshmëri. Me rastin e 60-vjetorit të lindjes dhe 6 vjetorit të vdekjes, Shoqata e Historianëve dhe Muzeu Historik i Rrethit Kukës menduan të organizojnë në kujtim të Bajram Abdiut një Sesion Jubilar. Organizator dhe drejtues i tij ishte mësuesi dhe historiani nderuar, Zoti Isa Halilaj. Vëllai Kamberi dha një ndihmesë të konsiderueshme në pasurimin e sesionit me materiale arkivore të Bajramit.

Më datë 16.7.1985 Shoqata Historianëve dhe Muzeu Historik i Rrethit Kukës, me iniciativën e Zotit Isa Halilaj, i drejtohen me kërkesën me shkrim Komitetit të Partisë së Rrethit Kukës dhe Komitetit të Veteranëve te Rrethit Kukës me dy propozime konkrete :

1. Të organizohet një Sesion Jubilar, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve M-L, Shkollën e Lartë të Partisë Tiranë, kushtuar 60 vjetorit të lindjes së Profesor Bajram Abdiut.
2. Shkollës së Mesme të Bashkuar Bicaj t'i jepet emri i Profesor Bajram Abdiut.

Këto kërkesa u miratuan dhe Sesioni Jubilar u organizua më 3 Maj 1986, ora 10.00



SHOQATA E HISTORIANËVE
MUZEU HISTORIK I RRETHIT
KUKËS

SESION JUBILAR

Kushtuar 60-Vjetorit të lindjes së Profesor Bajram Abdia

FTESË

Kukës, 1986



«Bajram Abdiu... bir besnik i popullit dhe anëtar i devotshëm i Partisë, gjithë aftësitë e tij i vuri në shërbim të studimeve shoqërore e të përgatitjes ideologjike të kuadrove të rinj».

ENVER HOXHA

Tiranë, 13 Maj 1981

Sh. Yllka Abolin
Tiranë

Me rastin e 60-vjetorit të lindjes të Profesor Bajram Abdiut, me datën 3.5.86 ora 10⁰⁰ në sallën e Kom. Ekz. KP. Rrethit organizojmë një sesion jubilar.

Ju ftojmë të merrni pjesë.

Shoqata e Historianëve
Muzeu Historik i Rrethit Kukës

Ftesë për Sesionin Jubilar kushtuar 60-vjetorit të Profesor Bajram Abdiut

Materialet që u paraqitën atëkohë në Session Jubilar m'i vuri në dispozicion të shkrimit studiuesi pasionant dhe historiani Isa Halilaj. Ai përveçse kontribuoi që të ngrinte në lartësinë e duhur figurën e Bajramit, është treguar një koleksionist i kujdesshëm në ruajtjen e dokumentacionit, i cili për ne merr një rëndësi të pamatë.





Krahas kësaj mendojmë që kjo figurë shkencore dhe militant i
tisë sonë te behet i njehur e te popullarizohet edhe ne shtyp,
veprimtari te tjera shoqerusse si emision ne radio, televizion,
koekspozitë mbi botimet dhe veprimtarinë e tijë e tj.

Propozojmë qe Shkollës së Mesme te Rashkumar Bicaj t'i jepet
ri i Profesor Bajram Abdiut me që ndahet nga shkolla 8 Vjeçare e cila
mbaj emrin që ka sot të dëshmorit Vehbi Shehu ose te gjykohet për
nje institucion tjeter.

Miratimi i juaj ne kohë për kete problem do të na shtynte t'ia
lonim me kohë përgaditjes dhe veçanerisht lidhjes sonë me institu-
onet që permendem me larte.

Njëitur po u dergojmë edhe disa te dhena biografike shumë të
ëtëra.

P/ SHOQATËN SHKENCORE TË HISTORIANËV
K r y e t a r i
Isa Halilaj

Djathtas propozimi për t'I dhënë shkollës së mesme emrin "Bajram Abdiu e propozimi për organizimin e Sesionit Jubilar", kurse majtas materialet e përgatitura për organizimin e Sesionit Jubilar me rastin e 60 vjetorit të lindjes së Bajramit.

Pjesëmarrja dhe organizimi ka qenë shumë i mirë. Morën pjesë figurat më të rëndësishme politike, administrative dhe studiues e historian nga rrethi Kukësit, pjestarë të familjes dhe të afërm, gazetarë të shtypit dhe të radios.

Në fjalën e hapjes dhe në diskutime përshkruhet "Profesor Bajram Abdiu i përket atij brezi luftëtarësh dhe kuadrosh që dalin nga vegjëlia, nga shtresat më të thjeshta të popullit, që u përgatitën, u edukuan, u kalitën dhe u ngritën në nivelin e tyre ideor e shkencor, me titujt e nderit e të meritës. Ai mbeti shembull frymëzimi për brezin e ri, si luftëtar e punëtor i palodhur në frontin ideologjik e kuadër me autoritet e kompetencë shkencore".

Fjalën kryesore e mbajti Zoti Isa Halilaj, Kryetar i Shoqatës së Historianëve të Rrethit Kukës. Ai vlerësoi origjinën dhe familjen e Bajramit, kontributin e saj në luftërat për liri e pavarësi. Jetën e Bajramit si fëmijë i zgjuar, shkollimin në Normale dhe lidhjen me lëvizjen çlirimtare. U ndal në detyrat që ka kryer Bajrami dhe kontributi me armë në dorë deri në çlirimin e vendit. Përshkroi me detaje vitet e studimit në Gjirokastër e Leningrad, vitet e punës plot pasion e devotshmëri dhe vlerësimin e gjithë kolegëve e bashkëpunëtorëve në vite.

Nazif Dokle në diskutimin e tij vlerësoi punën titanike 20 vjeçare të Prof. Bajram Abdiut. Ai analizoi me kujdes të gjitha veprat dhe shkrimet e tij dhe arriti në përfundimin se "vetëm sa filluam të cekim veprimtarinë shkencore të Prof. Bajram Abdiut, madje vetëm në shtrirje, duke u ndalur vetëm në një pjesë të saj. Ajo është e gjërë dhe pjesë përbërese e denjë e shkencave tona shoqërore. Vepra e tij do të jetë shembull për inteligjencën e rrethit tonë, veçanërisht për grupet e studiuesve të fushave të ndryshme".

Jaho Rrahmani, shok i fëmijërisë së Bajramit u ndal në figurën e Bajramit si fëmijë dhe i ri. Ai kujtoi Bajramin si nxënës të shkëlqyer, si merrte vetëm notën "1", si jepte mësim në vend të mësuesit, si i ndihmonte shokët, etj. Pastaj u ndal te kujtimet për lëvizjen çlirimtare dhe takimet e tyre asaj kohe të vështirë, por të lavdishme.

Dem Morina, student në Shkollën e Partisë në vitet 1964 - 67, kohë kur Bajrami jepte mësim në atë shkollë. Ai u ndal në marrëdhëniet e Bajramit

si edukator e mësimdhënës. Ai e quajti jo vetëm "kuadër drejtues dhe me autoritet, por të përpiktë në kryerjen e detyrave, edukator i palodhur e transmetues i mësimeve me kompetencë shkencore. Mësues i talentuar e i duruar, pedagog dhe shok i yni. I qetë në të folur, por logjik e bindës. Ishte një njohës i thellë i realitetit dhe situatave politiko – ekonomike. I afërt, i dashur e familjar me të gjithë kuksianët".

Foto majtas e pjesëmarrësve dhe foto djathtas e familjes dhe të afërmve në Sesionin Jubilar kushtuar Profesor Bajram Abdiut.

Jo shumë vonë propozimit, Komiteti Partisë Rrethit Kukës dhe Ministria e Arsimit e Kulturës e morën parasysh atë.
Në fshatin e lindjes së tij në Bicaj, në nderim të birit të saj Bajramit, shkollës së mesme të përgjithshme i vendosën emrin shkolla e mesme e përgjithshme "Bajram Abdiu".
Ishte një ditë festive përkujtimore, ku në Kukës ndodheshin me këtë rast dhe udhëheqës të lartë të Partisë e Pushtetit të asaj kohe, të cilët morën pjesë si në ceremoninë festive të emërtimit të shkollës, ashtu edhe në drekën e organizuar me këtë rast. Në ceremoni morën pjesë dhe anëtarë të familjes, të cilët u respektuan nga të gjithë të pranishmit.

Momente nga emërtimi i Shkollës Mesme Bicaj me emrin "**Bajram Abdiu**"

- Në foton majtas : Drejtori shkollës **Petrit Palushi**, Ministri Mbrojtjes **Prokop Murra**, Ministri Arsimit **Skënder Gjinushi**, Sekretari parë i K.P. të Rrethit Kukës **Miti Nito** dhe vëllai Bajramit **Kamber Avdia**.
- Në foton djathtas : Adem Avdia, Rrahim Milaim Fejzallari, Flora Alia (Avdia), Sherif Alia, Adem Halili.

VËLLAI MADH PËR TË VOGLIN, KAMBERI PËR BAJRAMIN :



1) [Të dhana biografike për]

Bajram Abdi (Abdiu) Fejzallari

= Bajram Abdiu ka lindë në Katundin Bicaj e Canaj të Kukësit me 6 Maj 1926 prej prindërve: Abdi Bajrami e Rahime Hallaçi. Ka prej familjare fshatar i varfër. Prindërit e tij rrjedhin nga fisi Fejzallar, fis i cili nuk ka pasë pasuri të madhe, por ka qenë i respektuar për besë e zgjuarsi dhe karakter të vendosur me moral të pastër. Nga fisi Fejzallar ka pasë që kanë luftuar kundra ushtrisë turke dhe janë vrarë (Rasti Zyber Fejzës dhe Zyber Temës, vra në Kryqe të Nangëve), po ashtu dhe gjatë luftës nacionale ka pasë dëshmor" (Sëq. ush. Ibish Mehmi, i c'li u vra në Canaj me Korrik 1944 me luftë me forcat e Zyber Litës Komandës, i forcave mercenare).

Bajrami gjatë i vogël paraqitjë me shoqë zgjuarësi, pastërtia dhe i shkathët. Nga zgjuarsia, kërdia tipërit e axhës – Zyber Bajramit, i cili pa shkelë —

%

Bajram Abdi (Abdiu) Fejzallari ka lind në katundin Bicaj, Canaj të Kukësit më 6 Maj 1926 prej prindërve Abdi Bajrami e Rrahime Hallaçi. Ka prejardhje familjare fshatar i varfër. Prindërit e tij rrjedhin nga fisi Fejzallar, fis i cili nuk ka pasë pasuri të madhe por ka qenë i respektuar për besë e zgjuarsi dhe karakter të vendosur me moral të pastër. Nga fisi Fejzallar ka pasur persona që kanë luftuar kundra ushtrisë turke dhe janë vrarë (rasti Zyber Fejzës e Zyber Temës, vra në Kryqe të Nangëve). Po ashtu dhe gjatë luftës nacionalçlirimtare ka pasur

dëshmorë (siç është Ibish Milaim Fejzallari, i cili u vra në Canaj në përpjekje me forcat kuislinge të Zyber Litës).
Bajrami që i vogël paraqitej me shenja zgjuarsie, pastërtie dhe i shkathët. Nga zgjuarsia kishte tiparet e axhës Zyber Bajrami, i cili duke qenë pa shkollë zgjidhte probleme gjeometrike të ndërlikuara.
Ai mbaroi shkollën fillore me nota të mira e rezultat shembullor, kështu ishte e nevojshme t'i jepej rrugë e lirë për të vazhduar shkollën. Me interesimin e axhës Zyber u fut në provim për bursë. Mori provimin e fitoi të drejtën e bursës për në Normale të Elbasanit. Kështu, në shtator 1938, i shoqëruar nga i vëllai Kamber, u regjistrua si konviktor në Normalen e Elbasanit.
Gjatë studimeve në Normale, si tip inteligjent, fiton zemrat e pedagogëve e shokëve proletar, duke u lidhur me shokë e aktivist komunist, të cilët e aktivizuan në lëvizjen çlirimtare kundër fashizmit. Në prill 1942 në Shkollën Normale u bë një demonstratë e madhe kundër autoriteteve të vendit duke u përleshur me forcat e xhandarmërisë. Mbas kësaj demonstrate shkolla u mbyll për shumë kohë dhe shumica e studentëve dolën në ilegalitet me partizanët. Bajrami, meqenëse ishte aktivizuar me lëvizjen çlirimtare, iku nga Shkolla Normale për të mos u kthyer më.
Me largimin nga shkolla, shokët që ishin më të vjetër e kishin rekomanduar te komunistë kosovarë, të vendosur dhe që kishin bërë Shkollën Normale. Meqenëse vëllai i tij, Kamber Abdiu, ishte vendosur familjarisht në Prizren edhe Bajrami erdhi në Prizren. Mori kontakt me celulën e atjeshme dhe u lidh me atë të Lumës, duke u bërë bazë e ilegalëve. Aktivitetin më të madh e ka kryer me Nesin Jonuz Shehun nga Bicaj, por kanë dijeni të plotë Sinan Hajdar Sinamati, Abedin Shehu etj.
Me zgjerimin e veprimtarisë së Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Lumë, Bajram Abdiu është inkuadruar në çetën e Lumës që më 1942 dhe partizan me armë në shtator 1943, ku u pranua si komunist e më vonë aktivitetin e shtriu në Br24S si përgjegjës rinie, komisar kompanie me komandant Vehbi Shehu, rënë dëshmorë në çlirimin e Tiranës, e pastaj si përgjegjës rinie batalioni.
Bajram Abdiu me inkuadrimin në ushtrinë nacionalçlirimtare ka marrë pjesë në çlirimin e Tiranës, ka marrë pjesë në luftime me kompaninë e tij

në ndjekje të forcave gjermane deri në Milot e pastaj me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm është kthyer në Kukës deri në fund të vitit 1945 e më vonë është tërhequr në Komitetin Qendror të Rinisë si redaktor i gazetës "Zëri i Rinisë".
Duke qenë se kishte prirje për studime, por shkollën e mesme nuk e kishte kryer, u desh të kërkonte leje për bursë dhe të vazhdonte shkollën e mesme të përgjithshme. Në shtator 1945 vazhdoj studimet në Liceun e Gjirokastrës. Atje ju ngarkua dhe detyra e sekretarit të partisë së shkollës. Ka marrë pjesë në Kongresin e 2-të të BRPSH-së. Mbas përfundimit të shkollës së mesme i doli bursa për studime në Bashkimin Sovjetik, në Fakultetin e Filozofisë në Leningrad.
Pasi kreu studimet për filozofi me rezultate shumë të mira në vitin 1951 (nga 12.000 studentë Bajrami është klasifikuar i treti si komb dhe i pari si shqiptar) u kthye në atdhe.
Që në fillim është vendosur në punë në dikastere të Aparatit të KQ-rë së PPSH-së, në Shkollën e Partisë Tiranë e Durrës.
Ka marrë titullin shkencor "Profesor" në filozofi në vitin 1971.
Bajrami ka krijuar familje në vitin 1953 me Violeta Bakallin dhe kanë dy vajza të martuara dhe të arsimuara.
Që nga fillimi i marrëdhënieve të punës ka dhënë ndihmesë dhe ka kontribuar në përkthime, redaktime, broshura e artikuj në gazeta, të cilët janë vlerësuar nga udhëheqja e kohës dhe punonjës së institucioneve që kanë pasur lidhje me shkrimet e tij.
Ndër botimet e shumta mund të përmendim : broshura, referate : "Krijimi dhe kalitja proletare e inteligjencës socialiste", qershor 1972. "Idetë dhe veprat e Tetorit të madh janë të pavdekshme", Rruga e Partisë 11/1962. "Analiza klasore e çështjeve dhe edukimi klasor revolucionar" Rruga e Partisë 8/1965. "Mbi natyrën klasore të inteligjencës dhe roli i saj në kushtet e sotme" Rruga e Partisë 1/1972. "Krijimi dhe kalitja proletare e inteligjencës socialiste" Rruga e Partisë 6/1972. Ka botuar artikuj të shumtë në gazetën "Zëri i Popullit" dhe në shumë organe të shtypit periodik.

Ka pasur mprehtësi në të shkruar, ka qenë i dashur, i urtë, i pastër, inteligjent në veshje e paraqitje, korrekt, i matur dhe i qeshur në bisedime dhe konsultor i papërtueshëm.
Në fillim të vitit shkollor 1974 – 75 është dërguar për të dhënë mësim si profesor filozofie në Filialin e Shkollës së Partisë në Durrës. Në fillim të vitit 1981 ju rëndua shumë sëmundja duke u ndarë nga jeta më 12 Maj 1981. Në përcjelljen e tij morën pjesë një masë e madhe e popullit të Durrësit, shokë e bashkëpunetorë të, përfaqësues nga udhëheqja e lartë e Partisë dhe pushtetit. Në nekrologjinë e njoftimit të vdekjes tij, botuar në gazetën "Zëri i Popullit", 13 maj 1981, ku kryetare komisionit ishte Nexhmije Hoxha, drejtore e ISML në KQ të PPSH, kolege me Bajramin për shumë vite.
Një ditë pas vdekjes arriti në familjen e tij telegrami i ngushëllimit nga shoku Enver Hoxha, me letër të posaçme të firmosur nga dora e tij, në të cilën shpreh keqardhjen për humbjen e një kuadri të tillë siç ishte Bajrami.
Puna e tij është vlerësuar, duke u dekoruar ma disa medalje e urdhra nga Kuvendi Popullor

Mësuesi Merituar SHUAIP HALILAJ PËR BAJRAMIN :


E kam njohur për nder të flasë për figurën e Prof. Bajram Abdiut, por njëhorë dhe shumë të vështirë, kundër disa njerëzve të thjeshtë, por ai arritu vetë e ne për ato bëjnë dukët te "bëj me" me shumë.

I sh. fjalëpërshëndetjen i mbrëmës me Bicaj.
"Mësuesi i Meritëuar"
Shuaip Halilaj

Bicaj, 10 shtator 2002

E kam njohur për herë të parë në pranverën e vitit 1943. Atë vit ishim në klasë të tretë të shkollës fillore në Bicaj. Ai erdhi dhe na bëri një orë mësimi – "Këngë për dallëndyshen". Së pari, vjershën e tha para nesh përmendësh e pastaj ne e mësuam strofa strofa. Së fundi melodinë e shoqëroi me violinë, të cilën ia mori Z. Xhafer Korbi, ish kryemësues. Në pushim të orës u përfol nga mësuesit që thoshin: "Shumë shpejt e paska mësu violinën!". Atë ditë

mësova se vazhdonte Normalen e Elbasanit dhe ishte i shkëlqyer me mësime. Më vonë u njoha nëpërmjet të regjistrave, se nga klasa e parë e deri në përfundim të fillores, klasës së pestë, e në të gjitha lëndët vlerësohej me notën njish (1).
Vitet kaluan e prapë u njoha më 1952 në përvjetorin e Çetës së Lumës, i cili u kremtua para sheshit të "Xhamisë Halile". Ai dhe disa shokë të tij të luftës shoqëroheshin nga Ramadan Halilaj. Në mes tyre ishte Peço Filli. Bajrami kishte mbaruar studimet në Leningrad. Ai bisedonte e gjatë bisedës dolën dhe aftësitë e tij të rralla intelektuale. Tregonte se studionte shumë dhe mori rastin kur "Byroja e Komitetit të Partisë së Universitetit mori vendim që Bajram Avdiu të mos studionte mbi 3 orë në ditë", por ku rrinte ai pa studiuar.
Për herë të fundit e kam takuar në Tiranë në vitin 1968. Kishim marrë një udhëtim për të takuar partizanët lumjanë në vijim të punës për pasurimin e muzeut, të cilin sapo e kishim ngritur. Në pallatin e kulturës, në prezencë të një shoku tjetër, duke pirë kafe e bëra prezent qëllimin e punës time. Me shumë modesti e urtësi më porositi : "Kujdes për ne që jemi, as emër e as foto të mos ekspozohet, pasi kemi kohë". Më gjatë nuk foli. Kur u ndamë më premtoi se do të më dërgoj një material lidhur me vitet e luftës, por mbeti premtim.
Më kanë rënë në dorë një fotografi ku ishte partizan, një në Gjirokastër dhe leksioni "Shkaku e pasoja", fletushka të vogla. Fatkeqësisht ato janë djegur së bashku me muzeumin. Në shtresa intelektualësh diskutohej aftësia, mençuria, personaliteti, puna shkencore, etj.
Njëherë në bisedë me Kudusi Shehun, i cili kishte mbaruar Shkollën e Partisë, më tha :"Pasi na shpjegoi temën "Shkaku dhe pasoja" në filozofi, njëri nga ne tha se nuk e kuptova. Ai nuk u përgjigj. U afrua pranë katedrës, mori karrigen dhe e përplasi për pllaka. Ajo u bë copë copë. Ne heshtëm e ai doli nga leksioni.
Meqenëse kam punuar për një kohë të gjatë me muzetë në Bicaj kam pasur mundësinë të takohem me shumë historianë, pedagogë, shkrimtarë, poetë, piktorë e politikanë, nga qendra e rrethe. Secili më ka folur me konsideratë e vlerësim maksimal, kur lexonin emrin e tij në stenda dhe fotot e ekspozuara në vitrinë.

E kam për nder të flas për figurën e Profesor Bajram Abdiut, por njëherë dhe shumë të vështirë. Rendita disa kujtime të thjeshta, por ai ashtu ishte e ne për atë bicjan duhet të bëjmë më shumë.

RESPEKT E MIRËNJOHJE PËR BAJRAMIN

Duke qenë se Bajrami ka punuar në të shumtën e kohës në/pranë KQ të PPSH, shumë bicjanë dhe banorë të Kukësit i drejtoheshin atij për halle e probleme, me shpresë se do t'i ndihmonte apo do të ndërhynte në instancat përkatëse. Për këtë ai ishte i papërtueshëm dhe kishte fituar besimin e tyre. Më poshtë po japim për ilustrim nga arshiva tij familjare pjesë të letrave, nga të shumtat që i kishte drejtuar mësuesi Qamil Hoxha, për ta ndihmuar në problemet e komplikuara të cilat ai ka kaluar.



Shokun Bajrom!
Këtë leter ma drejtova ju se jeni Profesor - je nji burrë shkeli me kërshnin të naltë filozofik që i gjykoni e i trajtoni rrjedhjet dashuri janë - por nuk kërkoi mëshirë se janë i pastër.
Ti falë
Bicaj - 28-x-1972 (Qamil Hoxha)



Kërkoi frej jashtë pës kërë ~~njerëzve~~ njerëzore, shoqnore, ndoshta edhe me shpi, ndash si kasandar të ma plotesojshe kërkesën time se janë pendue e nuk dua me i përsërit ma ato rrjedhje të kalrëme - Unë çdo dëtë jam tue pritë vdekjen se s'kam mbrësh mosbesim.
Më shkruej qi të sigurohem e të krijo i zëtë - Kaq më thuej: u dëshëroftë ta plotësova"
Ju nuovr ngrykë - ma
Bicaj - 5-III.1973 Keni hatrin -
Ti falë
(Qamil Hoxha)

Në letër bie në sy theksimi plot besim në zgjidhjen e problemit e në aftësitë e tij : "Këtë letër ua drejtova Ju si Profesor – je një burrë shteti me arsim të naltë filozofik, që i gjykon dhe i trajton ngjarjet ashtu si janë" ose "Kërkoj prej jush, për hir njerëzore, shoqnore, ndoshta edhe me shpi, ndash si katunar, të ma plotësosh lutjen time... Më shkruj që të sigurohem e të rrij i qetë. Kaq më thuej. Dëshirën ta plotësova".

Bajrami ishte një njeri që priste këdo e jepte konsulta e mendime të qarta dhe të paanshme. Dallohej për guximin dhe sqarimet pa komplekse, pavarësisht nëse ato përkojnë plotësisht me vijën politike të momentit.

Kur unë isha në shkollë ushtarake në Tiranë, përkoi me daljen në organet e shtypit të disa artikujve politikë e specifikë, ku sqarohej situata politike me terma të papërdorura më parë, si "Teoria e tri botëve", "Teoria e praktika e revolucionit", etj. Në këto raste shkoja tek shtëpia e tij dhe kur të tjerët pushonin unë merrja sqarimet e duhura. Ngrihej ngadalë, shkonte te biblioteka stërmadhe, merrte një libër me kapak të trashë dhe më lexonte nga rusishtja. "Ja, lalë, si ka biseduar Stalini me Mao Ce Dunin për këtë problem". Unë, që e mbaja veten se kisha lexuar, i drejtohesha : - Lala Bam, kam lexuar shumë vepra të Stalinit, por këtë nuk e kam hasur! – Nuk e ke hasur, lalë, se kjo nuk është botuar, nuk përkon me vijën tonë marksiste – leniniste, me ideologjinë e partisë sonë".

Në bisedë me vajzën e madhe të Bajramit, Yllkën, ajo shprehet për të atin, duke plotësuar ndjeshëm figurën e tij njerëzore, familjare dhe intelektuale :

"*Dëshira e Bajramit ishte të bëhej agronom, ndërsa filozofia ishte një zgjedhje e detyruar. Ai tregonte një kujdes të veçantë për lulet dhe ballkoni i shtëpisë ishte një kopsht shumë i bukur, që shpesh shërbente si pikë orientimi në "Rrugën e Durrësit" në Tiranë.

* Bajrami i donte njerëzit dhe i pranonte ashtu siç ishin, pa i paragjykuar. Ishte mendjehapur dhe tolerant në marrëdhëniet me ta. Ai bisedonte lirshëm e me kënaqësi me kolegët dhe me bashkëfshatarët, me miqtë dhe të afërmit, me të moshuarit dhe me fëmijët. Thoshte se kushdo ka botën e tij, prej së cilës mësoje dhe përfitoje diçka.

* Me babin mund të bëje biseda nga të gjitha fushat dhe të kënaqeshe pa masë. Ato që kam mësuar nga ai kanë qenë shumë më tepër se ato që kam mësuar nga studimet dhe të gjithë librat e lexuar. Ishte një enciklopedi e gjallë, që të fuste në labirintet e shkencës, artit, kulturës, filozofisë e politikës. Koleksiononte libra, piktura, pulla dhe çdo gjë që kishte të bënte me trashëgiminë. Shpesh organizonte konkurse nga fusha të ndryshme për ne, një mënyrë shumë e mirë për të na rritur dëshirën për të mësuar.
* Ishte romantik dhe e donte artin. Shumë shpesh organizonte pasdite letrare në shtëpi, ku ftonte shokë, miq dhe të afërm. Diskutonin për libra, tema artistike dhe recitonin pjesë nga autorë të ndryshëm. Po ashtu, për ne fëmijët organizonte shfaqje filmash dhe teatër kukullash. Filmat i shfaqte me aparat filmash diapozitiv, që e kishte sjellë nga Bashkimi Sovjetik. Ato i ndiqnim ne dhe kushërinjtë, fëmijët e fqinjëve dhe shokët e shoqet tona. Në shfaqjet me kukulla interpretonim të gjithë, dhe kjo i bënte ato shumë të dashura për ne.
*Në Tiranë funksiononin gjashtë kinema dhe ne shkonim shpesh për të parë filma. Pa dyshim, kjo ishte një mënyrë e veçantë edukimi artistik dhe kalimi kohe.
*I pëlqente të bënte dhurata dhe bënte të tilla për çdo ditëlindje apo datë të shënuar. Kartolinat për mamanë, ne dhe miqtë i vizatonte vetë dhe i shoqëronte me poezi. Ato janë vërtet shumë të bukura dhe të ngrohta.
Bajrami dhe Violeta kanë lënë si pasardhëse dy vajza, Yllkën dhe Mirën.

Yllka, vajza e madhe, është diplomuar fizikante në Universitetin e Tiranës. Ajo ka punuar fizikane në Uzinën Elektromekanike në Durrës, arsimtare në Tiranë, pedagoge në universitete shtetërore dhe private si dhe specialiste e arsimit në Institutin e Zhvillimit të Arsimit, nga ku doli në pension. Yllka është martuar me Bashkim Spahiun, profesor i shkencave hidroenergjetike, dhe kanë një djalë, Edrinin. Ata jetojnë në Tiranë.

Mira është diplomuar ekonomiste në Universitetin e Tiranës dhe ka punuar ekonomiste në disa ndërmarrje të qytetit të Durrësit, si në Ndërmarrjen Kimike, NISH Goma dhe Radiostacionin e Portit Detar. Mira është martuar me Reshit Lalën, regjisor në teatrin Rinia në Durrës. Ata kanë një djalë, Ilirin dhe jetojnë në Athinë, Greqi, që prej vitit 1991.



IBISH FEJZALLARI

Është martuar me një vajzë nga Gostili, Kukës, të fisit Mezhdun, sot fisi Sopaj. Nga kjo lidhje lindën djemtë Ramadani dhe Rushiti.

RUSHIT IBISH FEJZALLARI

Rushiti ka pasur vetëm një djalë, Milaimin.
Momentalisht nuk kam asnjë të dhënë për Rushitin dhe për familjen e tij.

RAMADAN IBISH FEJZALLARI

Ramadani ka qenë djali i parë i Ibish Fejzallarit.
Ai ka qenë i martuar me një grua nga fshati Ramhas, fshat në mes të Kukësit të ri dhe të vjetër. Me këtë grua ai pati dy fëmijë, djalin Selam dhe vajzën Hanife.
Në vitin 1915 Ramadani me gruan janë ndarë nga jeta si shkak i sëmundjes së kolerës, e cila u përhap në atë kohë në të gjithë krahinën e Lumës e më gjerë. Bashkë me sëmundjen ishte shoqëruese dhe zija e bukës.
Ishte koha kur Bicaj dhe krahina e Lumës ishte nën pushtimin Austro – Hungarez.
Vdekja e prindërve solli që djali Selam të mbetet jetim dhe të endet rrugëve. Jetën e peripecitë e Selamit do t'i trajtojmë më poshtë.

SELAM RAMADAN FEJZALLARI (BILALI)



Selam Ramadan Fejzallari ishte djali i vetëm i Ramadanit. Lindi në vitin 1909 në fshatin Canaj, Bicaj. Ai kishte dhe një motër, Hanifen, ose siç e thërrisnin më vonë Dada e Madhe, me të cilën nuk e gëzoj fëmijërinë e tij të vetmuar. Për shkak të fatkeqësive të ndodhura Selami nuk pati fat të bëj dhe as të gëzoj jetë normale familjare. Në moshë gjashtë vjeç, në vitin 1915, babai dhe nëna u ndanë nga jeta për shkak të sëmindjes së kolerës, rënë në masë në krahinën e Lumës, duke lenë shumë jetë të humbura.

Në mungesë të fotografisë, ky vizatim në skicë i Selamit është realizuar nga djali i tij Kujtimi.

I mbetur jetim pas vdekjes së prindërve, ai filloi të endej rrugëve të fshatit pa asnjë përkrahje. Në vitet 1917 ushtria austriake ishte vendosur në Kukës me kazerma të rregullta. Komandën e saj e kishte te Kulla e Lumës. Selami ishte afruar shumë me ushtarakët austro – hungarezë dhe qëndronte shpesh në gazermë. Aty e ushqenin edhe kujdeseshin për atë. Në tërheqje nga Shqipëria, oficerët austriakë e marrin me vete dhe e përcjellin njëri pas tjetrit deri në Beograd. Aty e rregjistrojnë në një konvikt për jetima dhe i krijojnë mundësi të vazhdoj edhe shkollën fillore. Filloi të mësonte gjuhën dhe të nxirrte bukën e gojës.
Rininë ë tij e kaloj në ato anë dhe pa ndonjë drejtim të përcaktuar.

Në qytetin e Pejës u njoh me Milica Krësto Jovanoviç (Bebin) me origjinë nga Peja, njohje e cila u kurorëzua me martesë.
Pas luftës së II-re Botërore u kthye në vendin e lindjes në Bicaj.
Me kthimin në Bicaj nuk u afrua me djalin e xhaxhait, Milaimin dhe ashtu mbeti pa shtëpi e katandi.
Merrej me punë të gjithfarëllojshme, si : polak fushe, punëtor arash, etj.
Pas çlirimit të vendit hyri në mardhënje pune shtetërore, fillimisht punëtor në Komitetin Ekzekutiv të rrethit e më vonë në spitalin civil Kukës. Me këtë rast ai u sistemua edhe me banim në qytetin e Kukësit.
Milica (Bebi) ka punuar si arkëtare në Ndërmarrjen e Artizanatit Kukës dhe më pas si sporteliste e arkës së Sigurimeve Shoqërore Kukës.

Nga martesa e tyre nuk patën asnjë fëmijë, por morën si të birësuar, nën kujdes, edukim e rritje, djalin me emrin Kujtim.

Motra e Selamit, Hanifja ose Dada e madhe ka qenë e martuar dhe ka patur një vajzë të quajtur Behije. Behija u martua në Shtiqën me Islam Murtatin e sot asnjëri prej tyre nuk jetojnë. Nuk kanë lenë prapa asnjë pasardhës.
Selami doli në pension në spitalin Kukës dhe u nda nga jeta më 22 dhjetor të vitit 1972.

Kur u bë regjistrimi i popullsisë, ai gabimisht u regjistrua me mbiemrin "Bilali", të cilin e mbajti deri në fund të jetës.

Këtë mbiemër trashëgon dhe djali i tij Kujtimi, i cili ka krijuar familje dhe jeton e punon në Kukës.

MILAIM RUSHIT FEJZALLARI

Milaimit, pasi u rrit, i takoi të martohet 3 herë. Një grua e mori nga fshati Topojan, me të cilën lindi 2 djem, Rushitin dhe Ibishin. Pasi i vdiq nëna e këtyre 2 djemve u martua rishtazi me një grua nga fshati Malqenë, Ujmisht (motrën e Baftjar Hoxhës), familje me zë për besë, burrëri dhe pasuri të madhe në bujqësi dhe blegtori. Milaimi nga natyra ishte proletar dhe demokrat dhe njeri shumë i lidhur me masat. Kjo martesë u bë kur Milaimi ishte 50 vjeç. Pas një viti i lindi një djalë, Rrahimi. Fati nuk i eci as Rrahimit, sepse në moshën 2 vjeç mbeti pa nënë e Milaimi pa grua. Milaimi në pamundësi tu shërbej këtyre jetimëve, u detyrua të martohet së treti me një grua nga Pista e Shëmrisë, sakate nga këmbët, por vetëm me kusht që dera e shtëpisë të mbetej hapur. Shpejt edhe kjo vdiq pa lënë asnjë fëmijë.



Tre djemtë e Milaim Rushit Fejzallarit - Rushiti, Ibishi dhe Rrahim Milaim Fejzallari

Vertetohet

KOMITETI VETERANEVE TE L.N.C.TE RRETHIT KUKES

K R Y E T A R I

Iljaz Çiku

Bazat e luftës NÇL në Kukës

luftës
imës:
triote
gjatë
ë një
it dhe
Hasan
braha,

181

Milaim Rushiti, Sheh Ramadani, Bislim Mata, Tahir Kama, Sheh Arifi, Dalip e Hasan Guri, Sali Lami, Bajram Brati, Hamdi Kola, Isuf B. Kërxhaliu, Rifat Spahiu, Osman Domi, Rexhep Bulica, Hashim Gashi, Riza Spahiu, Ali Selmani, Elmaz Serani, Jonuz Shehu, Ahmet Shehu, Liman Nuhia, Taip Hoxha, Taf Rexhep Rexhmati, Mehmet Selimi, Hazir Murati, Ram Sokoli, Lazim Sula, Mevlan Ismaili, Xhem Sinani, Kamber Avdia, Bejt Rustemi, Tahir Asllani, Ejup Shehu, Brahim Brahimi, Hajdar Sinamati etj. (Nxjerrë nga Kujtime të Rasim Gurit, f. 12, Tiranë 30.05.1963).

FOLE SHQIPONJASH.....Dilaver Bajraktar

BAZA TE LUFTES ANTIFASHISTE NACIONALCLIRIMTARE SHPALL ME VENDIM TE BYROSE SE KOMITETIT TE PARTISE SE RRETHIT KUKES Nr. 19/1 DATE 29 MARS 1969 (secret) .

34	KAMBER	AVDI	FEJZULLAHI	BICAJ
35	MILAIM	RUSHIT	FEJZULLAHI	BICAJ

180

Kujtime të veteranit Rasim Guri dhe pjesë nga libri "Fole Shqiponjash të Dilaver Bajraktari, ku vërtetohet se shtëpia e Kamber Avdi Fejzallarit dhe Milaim Rushit Fejzallarit kanë qenë baza të luftës Nacional – Çlimtare.

RUSHIT MILAIM FEJZALLARI

Rushit Milaim Fejzallari ka lindur në lagjen Canaj të fshatit Bicaj më 23 qershor 1921. Ai lindi nga martesa e Milaimit me një grua nga fshati Topojan, që quhej Hanife. Pas lindjes së vëllait tjetër Ibishit, nëna e tyre ndahet nga jeta dhe dy fëmijët mbetën jetim e Milaimi pa një njeri që të kujdesej për fëmijët dhe për punët e shtëpisë. Për këtë arsye ai u martua për së dyti me një grua nga fshati Yjmisht me të cilën i shtoj Rushitit dhe Ibishit një vëlla tjetër me emrin Rrahim.
Rushit Milaim Fejzallari ka qene jo vetëm një njeri me zgjuarsi natyrale, por është rritur në një familje me tradita dhe me shpirt të lirë. Babai tyre Milaimi e ndjente dhe përkrahte çdo lëvizje e frymë përparimtare të kohës e këtë e mbillte edhe në shpirtin e fëmijëve të tij.
Me gjithë sëmundjen që e ngacmonte dhe varfërinë që kishte pjesa më e madhe fshatit, Rushiti ka qenë i papërtuar për t'i shërbyer lëvizjes nacionalçlirimtare deri në fitore. Ai u rreshtua në radhët e Çetës së Lumës, batalionit partizan dhe Brigadës 24 Sulmuese. Rënia heroike e vëllait të tij Ibishit në përpjekje me forcat kuislinge nuk e bëri atë të hedh armët dhe të kthehet në familje, por i shtrëngoj ato më tepër duke shtuar disafish urrejtjen për pushtuesit dhe tradhtarët e vendit. Akti i babait Milaimit për tu rrjeshtur në çetë në vend të Ibishit nuk linte më shkak për asgjë, përkundër luftës pa mëshirë deri në çlirimin e plotë të vendit.
Pas çlirimit me përpjekjet e tij titanike, të vlerësuara dhe përkrahura, si dhe nisur nga heroizmi i vëllait të tij Ibishit, organizatat e Partisë e caktuan fillimisht si Sekretar i Rinisë në Qarkun Kukës dhe më pas në vitet 1946 - 1947 si z/sekretar të Partisë së rrethit Lumë me qendër Bicaj.

Rushiti në këtë periudhë u njoh Lenka Zoi Bakallin nga qyteti i Fierit, e cila ishte transferuar në Kukës dhe punonte me organizatën e gruas në Qarkun Lumë, me qendër në Bicaj. Ajo është strehuar për një kohë të gjatë tek shtëpia e Abedin Shehut në lagjen Canaj, Bicaj. Në dhjetor 1946 këtë njohje e kurorëzuan me martesë.
Lenka rridhte nga një familje e mesme qyteti. Familja e saj kishte një lokal të vogël në Fier në të cilin ishin të vetëpunësuar dhe përfitonin të ardhurat për jetesë.
Rushiti ishte me besim mysliman dhe Lenka ortodoks. Fillimisht kjo shërbeu si pengesë për mosdhënien e fjalës, por nuk u bë asnjëherë pengesë për martesë.

Dorën e Lenkës, Rushiti shkoj e kërkoj me Abedin Shehun nga Bicaj dhe një shok i Rushitit, Peço Fidhi. Paraqitja e tyre linte për të dëshiruar. Ata ishin të veshur bukur, me veshje të kohës, si intelektual. Kjo u largoj merakun se Rushiti ishte me origjinë malësor nga Kukësi e me një zhvillim jo bashkëkohor. Familja nga kjo njohje nuk pati fare luhatje në dhënien e dorës për martesë. Ata i pritën me një drekë të mirë, ku nuk mungonte asgjë dhe me të gjitha nderet që i takojnë mikut të shtëpisë.
Lenka kishte qenë partizane e Brigadës 11- Sulmuese së bashku me të dy motrat e saj, Athinanë dhe Kristinën. Vëllai i Lenkës, Jani Bakalli ishte partizan si intendent i Brigadës dhe në vitin 1943 ai bie dëshmorë. Nëna e tij Gonxhe, me rënien e djalit në luftë nisi partizane tre vajzat e saj. Një

rrugë në Fier edhe një shkollë në afërsi të saj sot mbajnë emrin "Jani Bakalli".
Lenkën dita e çlirimit të vendit e zuri në Pallatin e Brigadave. Ajo tregonte se aty e morëm njoftimin se më datë 29 nëntor u çlirua Shkodra dhe e gjithë Shqipëria.
Lenka ashtu si dhe Rushiti nuk e lëshuan pushkën deri në çlirimin e plotë të Atdheut. Ajo ka mbajtur gradën "kapiten i parë" e së bashku me Rushitin mbajnë medalje të luftës e të punës.
Në kohën që Rushiti ishte me punë në Bicaj, bashkë me Lenkën kanë banuar në shtëpinë e tyre në Canaj. Me largimin e Rushitit familjarisht në Tiranë, këtë shtëpi ia lanë në përdorim familjes së Bajram Isuf Nuhiallarit.

Rushiti me familjen e tij.

Lenka dhe Bajram Avdiu në përvjetor BrS, Shëmri, Kukës .

Rushit Milaim Fejzallari

Lenka (ulur përpara) me gratë në Shkodër

Lenka punoi e jetoi në Bicaj nga viti 1945 – 1948 me punë si Sekretare e Organizatës së gruas për Qarkun Lumë.
Ajo u lidh shumë ngushtë me Kukësin dhe veçanërisht me Bicajn. Njihte mirë çdo familje dhe punonte shumë me gratë e vajzat, si për luftën kundër analfabetizmit, ashtu dhe për zhvillimin e jetës në kushte e kondita të reja. Konsiderohej si "cuca e Bicajve" dhe të gjitha dyert i kishte të hapura.
Kishte një memorie të jashtëzakonshme e gjithmonë pyeste e interesohej për fshatin e burrit. Jo vetëm për njerëzit por edhe rrugët, tokat, ujin e pijshëm, livadhet dhe bjeshkët. Mbeteshe i mahnitur nga njohja e hollësishme dhe shumë pyetje të saja mbeteshin pa përgjigje, pasi bashkëbiseduesi nuk kishte njohuri të mjaftueshme për atë që i kërkohej.
Për efekt studimesh Rushiti është larguar familjarisht në Tiranë dhe ka punuar si ekonomist në Komitetin Shtetëror të Grumbullimeve, Drejtoria e Pyjeve, që përfshinte aparatin e Ministrisë së Bujqësisë e Pyjeve. Ndërkohë ka mbaruar arsimin e lartë pa shkëputje nga puna, Fakultetin Ekonomik (Dega Financë), duke u diplomuar në vitin 1962. Këtë detyrë e kreu deri në vitin 1966.

Në kuadër të "luftës kundër burokratizmit" që përfshiu sistemin e kohës, Rushiti transferohet me punë në Ministrinë e Tregtisë (Byroja e Çmimeve), ku punoi me përkushtim deri në fund të jetës së tij të shkurtër. Ai u nga nga jeta, familja dhe të afërmit më 19 prill 1970, në moshën 49 vjeç.

Fisi Fejzallar ka pësuar një tronditje me vdekjen e Rushitit, jo vetëm se ai ishte i ri, por ishte ndër njerëzit e zot të fisit. Kishte një zgjuarsi natyrale për tu lakmuar. Mbante lidhje dhe ndihmonte pa kursim të gjithë ata që i drejtoheshin. Shtëpia e tij ishte shtëpia e bicjanëve, të cilët i respektonte pa kufi.

Pas largimit nga Kukësi Lenka ka punuar si nëpunëse në Ndërmarrjen e shit-blerjes, Tiranë.

Pas vdekjes së Rushitit ajo pati ardhur disa herë në Kukës, si në përvjetorët e çlirimit, krijimit të Brigadave partizane ashtu dhe për raste familjare. Këto ishin ditë ç'malljeje me njerëzit, Kukësin dhe Bicajn e bicjanët e saj të dashur.

Lenka u nda nga familja dhe të gjithë ne më 25 janar 2012.

Lenka Zoi Fejzallari (Bakalli) deri në fund të jetës së saj nuk e dha veten se ishte nga Fieri. Ajo thoshte se jam nga Kukësi, nga Bicaj, e pati shprehur dëshirën që eshtrat e saj të pushonin në Bicaj.

Nga martesa dhe jeta e tyre lanë prapa tre fëmijë të nderuar, respektuar dhe të arsimuar: Spartakun, Xhuljetën dhe Gencin.

Spartak Rushit Fejzallari, lindur në Tiranë më 27 shkurt 1952. Ka mbaruar Fakultetin Gjeologji – Miniera. Ka punuar në Institutin e minierave dhe ka dhënë mësim në fakultetin Gjeologji – Miniera. Ka punuar për një periudhë në Kukës dhe ka qenë aktivizuar edhe me skuadrën e futbollit "Përparimi". Është martuar me Irenën dhe kanë fëmijë Gjergjin, i cili ka mbaruar fakultetin e Gjeologjisë dhe Erlindën, e cila ka mbaruar Fakultetin e Gjuhëve të huaja (spanjisht, rusisht, serbisht). Sot megjithëse gëzon pension është aktiv në specialitetin e tij dhe ndihmesa e tij kërkohet akoma.

Xhuljeta Rushit Fejzallari, lindur në Tiranë më 7 dhjetor 1953. Ka mbaruar Institutin e Lartë Bujqësor, Dega Ekonomi Agrare. Xhuli fillimisht ka punuar në Librazhd e pastaj në Ministrinë e Bujqësisë. Me ndërrimin e sistemit politik ajo ka shkuar në Itali, ku punon dhe jeton prej vitesh. Ajo ka mbetur e lidhur vazhdimisht me fisin Fejzallar, komunikon shpesh dhe interesohet për mbarëvajtjen e secilit prej nesh. Në këtë shkrim ka dhënë një kontribut të pakrahasueshëm me të dhënat e dërguara. Ajo bëri një punë të paparë për ta paraqitur Rushitin ashtu si e meritonte dhe Lenkën "grua zonjë".

Genci Rushit Fejzallari, lindur në Tiranë më 11 dhjetor 1966. Ka baruar Akademinë e Policisë dhe ka punuar në detyra të rëndësishme të Ministrisë së Rendit dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Njihet për punën e tij sistematike dhe për korrektesë. Shokët me të cilët punon më kanë folur fjalë shumë të mira dhe kanë konsideratë shumë të lartë. Është i martuar dhe ka djalin Denis që jeton në Itali dhe vazhdon shkollën e hotelerisë dhe dy fëmijët e tjerë në Tiranë, Sindin dhe Albin.

IBISH MILAIM FEJZALLARI



Ibish Fejzallari ishte djali i dytë i Milaimit. Kemi theksuar se Milaimi ishte një njeri përparimtar dhe kishte një shpirt patriotik. Këtë e reflektonte së pari në familjen e tij. Kjo duket mëse e qartë në momentin që dy djemtë e tij, Rushiti dhe Ibishi rrokën armët për t'iu bashkuar formacioneve çlirimtare. Këtë hap e ndërmorrën edhe pse gjendja ekonomike e familjes nuk ishte e mirë dhe familja e tyre më shumë se kurrë kishte nevojë për krah pune e të ardhura materiale.

Në moshën 19 vjeç, më korrik 1944, Ibishi dha jetën në përpjekje me forcat mercenare të komanduara nga Zyber Lita nga Fshati Ploshtan. Në kohën që bie në përpjekje ishte duke u kthyer nga Dibra, ku çeta partizane e Lumës kishte shkuar në ndihmë të çetës partizane të Dibrës së komanduar nga Haxhi Lleshi, pranë Fushë Aliaj. Ai në Bicaj po sillte postën partizane tek komanda e çetës. Aty bie në përpjekje me forcat e xhandarmërisë kuislingë, të cilat e njihnin veprimtarinë e tij. I bënë thirrje të dorëzohet, por ky u kundërpërgjigjet me zjarr. Duke qenë të pabarabartë në numër mbetet i vrarë në vendin e quajtur Lugjet e Epra në lagjen Canaj, Bicaj.

Heroizmi i Ibishit ka ngritur lart prestigjin e fisit Fejzollar, sepse ky akt është akt i përsëritur i Zyberit, në rastin e "Reformave të Tanzimatit". Në vendin ku ka rënë Ibishi ka qenë i ngritur një lapidar përkujtimor, ku nxënës shkollash dhe autoritete të pushtetit vendor e qendror bënin homazhe në kujtim të luftës çlirimtare dhe të tij si dëshmor i atdheut. Sot lapidari nuk ekziston dhe kujtimi i tij është venitur, ashtu si për të gjithë Dëshmorët e Atdheut. Është venitur dhe gjithnjë e më pak ata po përmenden, bile në ndonjë rast edhe akuzohen për qëndresën e tyre heroike.

Dita e tyre mendoj se nuk do të vonoj dhe ata do të mbeten përjetë të vlerësuar.
Nuredin Kërxhaliu, një bicjan i nderuar, shok e mik shtëpie me Rushitin, të vëllain e Ibishit, e ngrinte shumë lart figurën e Ibishit. Ai kishte qenë moshatar më Ibishin dhe tregonte se ai ishte ndër djemtë më të mirë të fshatit dhe dallohej në shumë veti nga të tjerët. Jo vetëm që ishte i zgjuar, por trim, besnik dhe i gjindshëm për këdo.
Fisit "Fejzallar" i ka mbetur peng vrasja e Ibishit. Ai u vra në mes të fshatit Bicaj, në lagjen Canaj, aty ku banonte dhe kryesonte paria e katundit. Ne vazhdimisht na ha meraku e bëjmë pyetjen : - A mundet të mos kenë ditur Paria e Bicajve se kuislingët po bëjnë përpjekje e po vrasin një djalë bicjan, djalë të katundit tyre, kushdo qoftë ai, nga njerëz që nuk janë të fshatit e të krahinës?! A mundet që ata t'i kenë mbyllur veshët e nuk kanë dëgjuar krismat e armëve vrastare?! A mundet që ata të kenë lejuar me vetëdije këtë luftë vëllavrasëse?! A kanë pasur ata mundësi të ndalojnë këtë gjakderdhje?!
Ne kemi pritur e presim vazhdimisht përgjigje për këto pyetje, por sa më shumë vonohen nga paria dhe nga ata që shkruajnë historinë e Bicajve, aq më shumë na shtohet bindja se në mes të kësaj ndodhie ka një marrëveshje të heshtur, një pranim i dakortësuar, ka pabesi, e ku ka pabesi ka tradhti.
Në bisedë me Ramiz Kërxhaliun mbi këtë ngjarje, ai u shpreh se vrasja e Ibishit është "Turpi i Bicajve". "Unë – thotë ai – mbaj mend, se isha 8 vjeç, se kur është vrarë Ibishi asnjë nuk ka protestuar apo kërkuar shkak, përveç Bajram Avdisë (Gjana), që në atë kohë ishte kryeplak i katunit".
Mos të guxoj kush të thotë se Ibishi u vra nga persona me ide antikomuniste "përparimtare", sepse ishte komunist. Ibishi, Rushiti, Bajrami e të gjithë Fejzallarët rrokën armët jo se ishin komunistë. Komunistë ata u bënë në luftë. Ata nuk rrokën armët me rujtë "Livadhet e Jovanit" dhe kullën e babës, por ata rrokën armët si çlirimtarë e fitimtarë. Ata u ngritën për të çliruar vendin nga pushtuesi okupator dhe të luftojnë për një Shqipëri të lirë, të shqiptarëve të lirë. Ata nuk kishin mbaruar shkolla filozofie, bile dhe shkrim e këndim një pjesë e mirë mësuan në mal me armën te koka. Ata ishin idealiste dhe e dinin vetëm se duhej

luftuar deri sa vendi të çlirohej, pavarësisht se mund ta paguanin këtë si çmim me jetën e tyre, si pati fatin e pagoi Ibishi.
Edhe pala që vrau Ibishin me shokë nuk është se e kuptonin antikomunizmin. Edhe ata ishin fshatarë të thjeshtë e të ndershëm, por kishin një ndryshim. Ata nuk kishin ideal, por kishin një synim : t'i shërbenin me besnikëri e qorrazi, ndoshta edhe me besë bajraktarit, kuestorit, apo kush i paguante a mund t'i kishte bërë thirrje për ta ndjekur. Ndoshta edhe ata nuk e dinin se këta "prijës", me të cilët mund të kishin lidhje fisi, gjaku apo miqësie, mund të ishin përkrahës e mbështetës të pushtuesit. Ata ishin besnik të fjalës së dhënë e besës së mbajtur, pavarësisht se në cilin mulli dërgonin ujë e cilin miell bluanin. Asnjëri prej tyre, mirëfilli, nuk do i merrte jetën këtij të riu pa mbrojtje. Asnjëri prej tyre nuk kishte arsye t'i merrte jetën këtij djaloshi, por lidhjet e mësipërme bënë që pushka e tyre ta merrte e ta bënte të pavdekshëm këtë të ri vdekatar.
Historia po shkruhet e do të shkruhet, por ajo duhet të shkruhet me paanësi, si thotë Haki Stërmilli te romani "Sikur të isha djalë", ...me duar të padridhna (duke mos t'u dridhur duart, duke mos u ndikuar nga asnjë rrethanë).

Pjesë nga libri "**Yje të pashuar**", pjesa 2-të, f.326

Luginës ku rendte i harbuar Drini, në bjeshkët e Lumës, jehonte krisma e mitralozit të djaloshit Ibish. Këndonte pushka partizane. I riu komunist Ibish Milaimi dhe shokët e çetës së Lumës luftojnë. Në çdo aksion këndon si bilbil e si gjinkallë mitralozi i Ibishit.
Në betejën e parë për çlirimin e Peshkopisë, në tetor 1943 Ibishi u dallua në luftime. Megjithëse i ri në moshë, ai qe ndër më të guximshmit, më trimat.
Ishte shumë modest, nuk donte ta mburrnin, nuk lavdërohej kurrë, bënte e pranonte shaka, mitralozin e ruante si sytë e ballit. Duke qenë i tillë shokët dhe e ngacmonin ndonjëherë. Kështu, një ditë, kur çetat partizane të Dibrës e të Lumës ishin vendosur në Gramë, iu afrua një shok dhe i tha : "Ti Ibish si shumë po e pastron dhe e ruan mitralozin, po shiko mos ta marrin ndonjë ditë nga dora". Atëherë Ibishi, pak i fyer nga kjo shaka e shokut të tij, por me buzëqeshje iu përgjigj : - Atë çfarë nxjerr prej gryke, natyrisht, do ta marrin armiqtë, por mitralozin, sa të jem gjallë unë, jo". Ibishi nuk e dorëzoi mitralozin sa qe gjallë.
Në aksionin që bëri çeta partizane më 13 Maj 1944 te Kulla e Lumës, Ibishi u dallua me mitralozin e tij dhe u gjend në pozicionin më të vështirë kundër nazistëve gjermanë. Në këtë aksion mbetën të vrarë 9 nazistë. Po kështu dhe në luftën që u bë në Fush Alije në fillim të korrikut 1944, Ibishi u dallua ndër shokët që luftuan trimërisht.
Në mëngjesin e 10 korrikut 1944 ai u rrethua nga forca të shumta të xhandarmërisë kuislingë të komanduara nga banditi Zyber Lita në afërsi të shtëpisë së Xhem Sinanit në Bicaj. I bënë thirrje të dorëzohej pasi ishte i rrethuar nga të gjitha anët. Si përgjigje morën një breshëri mitralozi. Luftonte një kundër qindra armiqve. U plagos rëndë që në pushkët e para, por u tregoj tradhtarëve se si vdesin duke luftuar partizanët, komunistët. Ibishi luftoi deri sa iu mbaruan fishekët, deri në pikën e fundit të gjakut dhe vetëm kur e lanë fuqitë fare, groposi dokumentet që kishte me vete. Në minutën e fundit të jetës mblodhi edhe njëherë forcat dhe thirri : "Rroftë Partia Komuniste Shqiptare".

Kështu ra i riu komunist, malësori i varfër Ibish Milaimi, një nga bijtë më të lavdishëm të Lumës.
Ditën e nesërme, më njëmbëdhjetë të korrikut, në vargun e çetës partizane vendi i Ibishit nuk kishte mbetur bosh. Një malësor 60 vjeçar, i veshur me tirq, kishte ngjeshur kollanin e fishekëve e me pushkë në krah ecte në njëshkolonën partizane. Ishte Milaimi, babai i Ibishit, që erdhi në çetë dhe zëvendësoj të birin ...

Kamber Avdia për Ibish Milaim Fejzallarin :

Dëshmorit Ibish Milaim Fejzallari

***

Nga një fis i thjeshtë Fejzallar
Linde, u rrite ti atdhetar
Ideali yt i ri proletar
U organizove në çeta partizanë.

***

Guximi yt për detyrën e shenjtë
Të luftës për liri e Atdhe
Korriku i vitit 1944
Takove befasisht tradhtarët.

***

Në Canaj te Lugjet e Epra
Ballistët të takuan befasisht
Në përpjekje e luftime të vranë
Por shpinën nuk ia ktheve armikut.

***

Heroizmi yt i dha nder fisit
Emri yt jeton përgjithmonë
Eshtrat tuaja radhitë me dëshmorë
Përkujtohen në çdo korrik me emrin tënd, Ibish.

***

Ideali yt që luftove u realizua nga të tjerët
Shqipëria u çlirua dhe gëzon jetën e lirë
Atdheu ynë i dashur zhvillon kulturë, industri moderne.

Pensionist Kamber Avdia
Kukës, më 1 Maj 1977

RRAHIM MILAIM FEJZALLARI

Rrahim Milaim Fajzallari ka lindur në lagjen Canaj të katundit Bicaj më 15 Mars të vitit 1934. Ai ishte fëmija i tretë nga martesa e dytë e Milaimit me Fatimen, bijën e fshatit Resk, Ujmisht, motrën e Baftjar Hoxhës.

Si e kemi theksuar më sipër, Milaimi pasi u rrit i takoj të martohet 3 herë. Një grua e mori nga fshati Topojan, me të cilën lindi 2 djem, Rushitin dhe Ibishin. Pasi i vdiq nëna e këtyre 2 djemve u martua rishtazi me atë që u bë dhe nëna e Rrahimit. Kjo martesë u bë kur Milaimi ishte 50 vjeç. Pas një viti i lindi djali Rrahim.

Ai që i vogël qëlloi i pafat, sepse në moshën 6 muajsh i vdes nëna Fatime duke e lënë jetim dhe pa përkujdesje e përkrahje.

Në këto kushte Milaimi u martua së treti, si kemi theksuar me një grua nga Pista e Shëmrisë, por ajo duke qenë me të meta fizike nuk ishte e aftë t'i shërbente vetes e jo më fëmijës së vogël, si ishte Rrahimi 6 muajsh. Shpejt edhe kjo vdiq pa lënë asnjë fëmijë.

Nisur nga kjo situatë Milaimi e dërgoi djalin për përkujdesje tek dajat e tij në Ujmisht, tek familja e Baftjar Hoxhës. Për fatin e mirë të Rrahimit gruaja e dajës së tij Hasirja kishte fëmijën e saj Ganiun 7-8 muajsh dhe me qumështin e gjirit të saj i ka ushqyer të dy vogëlushët, duke u bërë një nënë e dytë për Rrahimin. Ai e ka quajtur gjithë jetën e tij "nënë" Hasiren dhe e ka respektuar pa masë, kurse Ganiun e ka quajtur jo djalë daje por vëlla, ndryshe nga të katër djemtë e tjerë të dajës së tij.

Rrahimi mori tek dajat një edukatë dhe kulturë për t'u pasur zili për fëmijërinë e kohës. Familja e Baftjar Hoxhës ishte një familje me zë dhe me emër shumë të mirë e të njohur jo vetëm në Ujmisht por edhe në Bicaj, krahinën e Lumës, Dibër, Shkodër, Durrës e deri në Vlorë. Ishte familje e madhe me 5 djem e 3 vajza e me shumë nipër e mbesa. Kjo familje ka jetuar e bashkuar dhe e pandarë deri vonë. Deri në vitin 1983 kjo familje numëronte mbi 47 persona që jetonin të gjithë bashkë. Aktualisht sot nga kjo familje e madhe janë zhvilluar 14 familje të tjera me rreth 80 veta, që jetojnë në Ujmisht tre familje, Tiranë dhjetë familje dhe në Durrës një familje. Familja ku u rrit dhe u edukua Rrahimi ka qenë e lidhur ngushtë me lëvizjen nacionalçlirimtare e ka pritur e përcjellur partizanë. Edhe pas çlirimit nga kjo familje ka pasur persona të arsimuar e të kualifikuar, që kanë shërbyer me nder e dinjitet në sektorët e ngarkuar. Vetë Baftjari ka qenë për shumë vite n/kryetar i Këshillit Popullor të fshatit dhe n/kryetar i Kooperativës Bujqësore Ujmisht.

Milaimi nga natyra ishte proletar, demokrat dhe njeri shumë i lidhur me masat. Ai ka ushtruar një ndikim të fuqishëm në edukimin e tre djemve të tij. Jo vetëm e përkrahu personalisht lëvizjen nacionalçlirimtare, por dy djemtë e tij të parë i rreshtoj në radhët e çetës partizane të Lumës dhe kur djali i dytë Ibishi ra dëshmor ai zuri vendin e tij si partizan dhe çlirimtar.

Me këtë frymë patriotike e në këto kushte u rrit dhe u burrërua djali Rrahim.

Me të mbaruar shkollën 7 vjeçare ju dha e drejta të ndjekur shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi e pas mbarimit të saj vazhdoi Shkollën Ushtarake "Skënderbej", duke u titulluar oficer aktiv.

Me mbarimin e luftës vëllai i tij Rushiti u shkëput nga radhët e forcave partizane dhe punoj në Kukës si drejtues Rinie e më pas si zv/sekretar i Partisë së Qarkut Lumë me qendër në Bicaj. Këtu mori me vete Rrahimin dhe jetuan bashkë. Ai jo vetëm që ishte më i madh në moshë, por kishte një pjekuri për t'u admiruar. E rriti dhe edukoi Rrahimin si prind shembullor dhe i dha drejtimin e duhur në jetë. Me familjen e Rushitit dhe të kunatës së tij Lenkës, Rrahimi jetoi deri sa krijoi familjen e tij. Rushiti dhe Lenka i kanë qenë gjithmonë mirënjohës familjes së Baftjar Hoxhës për edukimin e rritjen e Rrahimit. Ata e thërrisnin daja Baftjar, si e kishte dhe e quante Rrahimi, ashtu si Rrahimi e quante daja Adem, dajën e Rushitit, Adem Onuzin në fshatin Nangë. Të dy vëllezërit tanimë nuk ndahen kurrë më, përjashto kohën e ndarjes së parakohshme nga jeta të Rushitit. Kjo ishte për Rrahimin humbja më e madhe e provuar deri në atë kohë dhe boshllëku më i madh i krijuar në jetën e tij, familjes së tij dhe të Rushitit.

Në vitin 1960 Rrahimi u martua dhe krijoj familje me Vitore Rexhep Kapllanin nga qyteti i Vlorës. Të parët e kësaj familje vinin nga Kanina.

Nëna e Vitores, Lekoja, ka qenë pjesëmarrëse gjatë luftës në njësitin gueril të qytetit Vlorë dhe babai i saj Rexhepi, një ndër futbollistët e parë

të viteve 30-të. Ajo kishte dy vëllezër, Haxhiun dhe Qemalin dhe tre motra, dy të martuara në Vlorë dhe njëra në Ujmisht me djalin e dajës së Rrahimit, Aqifin.

Rrahimi dhe Vitorja lindën dy djem të mrekullueshëm, Mondin dhe Nardin. Ata jo

vetëm i rritën por edhe i edukuan me traditat e zakonet e tyre. Të aftë jo vetëm të njohin fisin dhe të afërmit e tyre, por dhe t'i respektojnë e t'u bëjnë nderet që u takojnë në rrugë e në shtëpi. Mondi punon si radiolog dhe Nardi prej vitesh jeton e punon në Itali.

Rrahimi gjatë gjithë karrierës së tij ushtarake ka shërbyer në repartet e garnizonet ushtarake të Tiranës në detyra të ndryshme, duke bërë karrierë nga hallka të togës, kompanisë, batalionit dhe detyra të rëndësishme në Brigadë.

Ai është dalluar për punë plot pasion e përkushtim. Ka qenë gjithmonë i ndershëm dhe i sakrificës, i dashur me kolegët dhe vartësit dhe i nderuar nga eprorët.

Ishte anëtar i PPSH dhe i tillë mbeti deri në fund të jetës së tij.

Edhe pasi u shkëput nga karriera ushtarake Rrahimi i kujtonte me mall e dashuri shokët e kolegët dhe kalonte kohë e aktivitete me ata.

Pushimet verore dhe lejet zakonisht i kalonte në Kukës, Bicaj dhe Ujmisht. Këtu ai ndjehej si në shtëpinë e tij dhe pritej mirë kudo ku shkonte, me shumë dashuri e bujari. Në mimikën e Rrahimit dalloje vetëm buzëqeshje e mirësi. Nga natyra jepte më i madh në moshë dhe të gjithë e thërrisnim "lalë". Ai ishte shumë i lidhur me fisin "Fejzallar" dhe mbante marëdhënje të ngushta dhe të përhershme. Sa herë vinte në Kukës rrinte me Kamberin, Isufin, Asllanin, Fuatin dhe të gjithë pjesëtarët e fisit. Ai donte t'i takonte dhe të qëndronte me të gjithë pa përjashtim. Ai shkonte dhe në fshatin Vilë, në familjen e Sinan Hasës, gruaja e të cilit, Tana ishte tezja e Rrahimit. Kishte një lidhje të veçantë e të ngushtë me njerëzit e tij.

Rrahimi me familjen e tij

Ai ishte dhe mbetet i papërsëritshëm. Nuk mbahet ndonjëherë mend që në raste gëzimesh e fatkeqësish në Kukës të mos ishte prezent Rrahimi. Pavarësisht kohës dhe anës ekonomike ai mundohej të ishte kurdoherë i pranishëm mes nesh. Ka qenë dhe mbetet "hallka e zinxhirit" që na bashkonte në fisin Fejzallar. Ishte nderi dhe krenaria e jonë. Ai ishte patjetër krushku i parë në fis. Ka qenë krushk i parë jo vetëm në Buzmadhë në dasmën time, por në mbarë dasmat e fisit. Ishte si "ylli sabahut". Fjala e ëmbël dhe muhabeti plot humor e tolerancë i jepte vendin që i takonte në çdo odë kuksiane.

La Rrahim në gëzimet e Fejzallarëve

Çdo vit më 9 shtator, ditën e krijimit të Çetës së Lumës (Festa e Bicajve), Rrahimi, Rushiti, Lenka e Bajrami do të ishin prezent në këtë eveniment historik. Përveç aktiviteteve të planifikuar ata do të ishin vizitorë të

përhershëm të vendit ku pushonte vëllai i tyre dëshmor Ibish Milaim Fejzallari në Kukës dhe të lapidarit të tij në Bicaj. Rrahimi dhe Vitorja ishin shumë të lumtur që kishin një nip të dashur, Endrin, djalin e Leonardit, një pasardhës të denjë të familjes, që e duan të gjithë pa masë. Edhe Endri e donte dhe e respektonte së tepërmi gjyshin Rrahim, ashtu si e do dhe respekton nga larg nënën Vitore e xhaxhi Mondin.

Për një periudhë relativisht të gjatë Rrahimi ka vuajtur nga sëmundja e diabetit dhe sëmundje të tjera të moshës, por ai asnjëherë nuk u ankua dhe nuk u shkëput nga evenimentet e fisit "Fejzallar", në të mira e në fatkeqësi. Ai si gjithmonë ruante humorin e tij të hollë dhe mbante me muhabet "odën e burrave", duke gëzuar respektin e të gjithëve dhe duke qenë në qendër të vëmendjes.

Ai u nda nga familja dhe njerëzit e tij të dashur më 23 Mars 2014 duke lënë në pikëllim të thellë Vitoren, Endrin, Mondin, Nardin, Spartakun, Xhulin, Gencin e të gjithë Fejzallarët kudo që ndodheshin. Ai u kujtua me respekt dhe u përcoll për në banesën e fundit nga shokët e miqtë nga Tirana, Kukësi e Vlora. Pati kudo miq e dashamirë të shumtë, që nuk do ta harrojnë kurrë.

10 ditë para se të ndahej nga jeta i bëra një vizitë të shkurtër në shtëpi, nisur nga gjendja e rënduar shëndetësore. Mes të tjerave në bisedë i thashë : - La Rrahim, ne të dy akoma e kemi "gjakun e trashë", por tek fëmijët tanë ka filluar të hollohet. – Mos u mërzit Lalë se kjo nuk po ndodh vetëm tek ne, por në mbarë familjet e fiset. Fëmijët po harrojnë nga largësia edhe familjet e tyre e jo më farefisin". Edhe ai e vuante gjithmonë "distancën" që krijohej brenda fisit nga pasardhësit tanë, fenomen që nuk po arrijmë ta ndalojmë.

(Një ndihmë të madhe për shkrimin e mësipërm për Rrahimin dha me kujtimet e tij zoti Aqif Hoxha).

MUSLI DIN FEJZOLLARI

Muslia, pas vdekjes së babait, Dinit, u martua me Sulltanën e Cakës nga Fshati Malqenë, Ujmisht. Muslia me Tanën lindi djalin Dullë. Dulla u martua me një vajzë të fisit të "Shehut të Kollovozit", motra e Muharrem Nelës, që ka banuar në Kukës.

Dullës në moshën 43 vjeç lindi një vajzë, por në vjeshtën e vitit 1924, në moshën 45 vjeç u nda vetë nga jeta, duke lënë gruan në një gjendje të mjerë ekonomike e me një vajzë të vogël dhe nënën plakë në moshën 60 vjeçe. Në këto kushte gruaja e tij la fëmijën e vogël dhe nënën e Dullës dhe u martua në fshatin Topojan.

Nëna e Dullës e mbetur vetëm e pa përkrahje ju mvesh për jetesë Avdi Bajramit. Vajza e vogël vdiq në moshën 3 vjeçe, kurse nëna e Dullës vdiq në prehrin e djalit të Avdisë, Kamberit në Prizren me 3 gusht 1946 në moshën 82 vjeçe, pa lënë ky degëzim i fisit Fejzallar asnjë trashëgimtar nga prapa.

Nëna e Dullës me djalin e Kamberit, Bashkimin. Prizren 1946

KESHILLI POPULLOR I QYTETIT
Seksijoni Mbrendshem Statistika
Nr. 116 me 3-VIII 1946 viti
PRIZREN

LEJE – VORRIMI

Mbasi u plotsue afati ligjuar, lejohet vorumi i te ndyerit—res

rejonit II – rruga 84 Nr. 17

ГРАДСКИ НАРОДНИ ОДБОР
Отсек Унутрашњи Статистички Одељак
Бр ..... од ..... 194 ... год.
ПРИЗРЕН

Погребни-Лист

Пошто је испуњен законски рок, дозвољава се погреб покојног—цу.

реон ..... ул. ..... Бр. .....

Службеник Статистичког одељка:
Nëpunës i gjendjes civile:

Leje varrimi e Nënës së Dullës, varrosur në Prizren më 3 Gusht 1946 nga familja e Kamber Avdisë.

NË VEND TË MBYLLJES

Meraku mbetet merak deri në vdekje. Meraku im ka qenë dhe mbetet që Fejzallarët ta njohin, ta duan dhe të qëndrojnë pranë njëri tjetrit, si dikur kur ishim pak e sot që jemi më shumë. Kam dashur e dua që të jemi krenar e dinjitoz, ashtu siç jemi, kur të themi se jemi Fejzallar. Kjo të trashëgohet për jetë e mot, brez pas brezi. Nëse këto shënime i shërbejnë sadopak këtij qëllimi do jem shumë i kënaqur, jo për vete, por për fëmijët tanë. Për ata që ne do të lëmë pas, për dinjitetin e tyre. Jeta nuk është film ... skenat e të cilit mund t'i xhirosh sa herë të duash. Edhe njerëzit e historia e fisit nuk mund të përsëriten, sado të trashëgohen virtytet dhe zakonet e njëri tjetrit.
Kam në dorë një libër me poezi të Ali Podrimës. Më mbeti në mendje një varg :

" babai im ndjesë pastë shaloi ujkun
djali im vajti të mbyllë vrimën e miut n'kullë "

... ndoshta brezat nuk ndryshojnë kaq shumë, si thotë Aliu në poezinë e tij dhe fëmijët tanë nuk janë aq pak kurajozë e dinjitozë në krahasim me të parët, por koha që kalon bën të veten, ajo të bën më madhështor dhe më të vëmendshëm për brezat, ajo të lartëson, ajo t'i bën të veçanta edhe ato cilësi që sot për të tjerët duken normale. Unë besoj se kemi pasardhës Fejzallar të denjë dhe duhet të jemi krenar për ata dhe vendin që zënë në punë e shoqëri.

Shpresoj se ky material do të lexohet nga anëtarët e nderuar fisit tim. Të mbetet edhe njëherë vetëm si vështrim i imi për fisin, për faktin se vështrimi i tyre mund të jetë pasqyrë e një pamje tjetër me më shumë jetë, më bindëse e më të besueshme. Unë jam munduar të vë në dijeni dhe kam kërkuar informacion nga të gjithë Fejzallarët, në mënyrë që shënimet të dalin të plota e bindëse, të jenë objektive dhe të paraqesin realisht personat e përshkruar. Jam i hapur dhe i kënaqur nëse ky material do të "fishkullohet pa mëshirë" dhe do të rregullohet nga çdo deformim i paqëllimshëm. Po ashtu jam i hapur për shtesa e përshkrime

të tjera edhe për ata persona që i njohin dhe kanë mbresa për bashkëmoshatarët e tyre Fejzallar.

Në fund ky material të shërbej jo vetëm si njohje, por edhe si thirrje. Si thirrje të bashkohemi njëherë rreth veti, të bëhemi bashkë, të njohim, të shohim e vështrojmë në sy njëri tjetrin dhe të shprehim krenarinë tonë që na e lanë brezat. Kur dhe kush do e marrë nisiativën e këtij takimi të përbashkuar: Luani, Spartaku, Yllka, Nardi, Afrimi, Xhuli, Shkëlqimi, Genci, Mira, Xeni, unë apo të gjithë bashkë. Të shohim .... e të shpresojmë.

BIBLIOGRAFI

- Shefqet Hoxha – Luma në luftërat për liri.
- "Yje të pashuar" - Pjesa 2-të, f.326
- Akademia e Shkencave, *Gjeografi Fizike e Shqipërisë.* vëllimi i parë, Tiranë, 1990
- Robert Elsie "Fiset Shqiptare" Artini, Prishtinë 2017
- Këshilli i Qarkut Kukës "Strategji e zhvillimit të Qarkut Kukës 2012-2016" Kukës, 2012
- RASP, Komuna Bicaj, QIZHDK "Plani i zhvillimit i komunës Bicaj", Tetor 2012
- Dr.Blerta Avdia – Vlerësimi dhe menaxhimi resuseve natyrore dhe njerzore të krahinave Lumë - (Kosovë) për zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.
- Materialet e Sesionit Jubilar organizuar me rastin e 60 vjetorit të lindjes së Profesor Bajram Abdiut dhe diskutimet. Materiale të daktilografuara. Marrë nga studiuesi Isa Halilaj.
- Korrespondenca e Z. Qamil Hoxha me Prof. Bajram Abdiun
- Kujtimet e Mësuesit të Merituar Shuaip Halili. (Dorëshkrim, viti 2002).
- Kujtimet e Z. Aqif Hoxha për Rrahim Milaim Fejzallarin (Dorëshkrim, viti 2017).